

1 E mërkurë, 1 shtator 2021

2 [Konferencë përgatitore për gjykim]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit nuk marrin pjesë]

5 --- Fillon në orën 10.00

6 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mirëdita. Mirëserdhët të
7 gjithëve.

8 Zonja fotografe, mund të filloni.

9 Zonja sekretare, mund të paraqitni lëndën.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës. Kjo
11 është lënda me numër KSC-BC-2020-07, Prokurori kundër Hysni
12 Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

13 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] U lutem palëve që të
14 prezantohen, duke filluar nga Zyra e Prokurorit të
15 Specializuar.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës, unë
17 jam Matthew Halling, ndihmësprokuror; bashkë me mua kemi
18 zëvendësprokurorin e specializuar Alex Whiting; Prokuroren
19 Valeria Bolici; ndihmësprokurorin Pace; dhe menaxheren e
20 lëndës Line Pedersen; si dhe stazhieren Francesca Girardi.
21 Faleminderit.

22 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Tani i kthehem Mbrojtjes, z.
23 REES.

24 Z. REES: [Nuk ka përkthim].

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Z. Cadman, ju

1 lutem.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar z. Gjykatës.
3 Jam Toby Cadman, përfaqësoj z. Haradinaj. Bashkë me mua
4 ndodhen z. Carl Buckley, bashkavokat.

5 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. I kthehem Zyrës
6 Administrative.

7 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Jam
8 Ralph Roche, së bashku me znj. Fidelma Donlon.

9 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Vë re se të pandehurit kanë
10 hequr dorë nga të qenit të pranishëm këtu. Për hir të
11 procesverbalit, unë jam Charles Smith, kryegjykatës i këtij
12 Trupi Gjykses, së bashku me mua kolegë janë gjykatësit
13 Christoph Barthe, Guenal Mettraux dhe Fergal Gaynor.

14 Përpara se të fillojmë, dua të rikujtoj se ky Grup
15 Gjykses është caktuar për këtë çështje gjyqësore me kalimin e
16 dosjes gjyqësore nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 16
17 korrik. Në pajtim me rregullin 117, me marrjen e dosjes
18 gjyqësore Trupi Gjykses duhet të zhvillojë një konferencë
19 përgatitore për gjykimin së bashku me palët. Për këtë qëllim,
20 më 21 korrik, ky Grup Gjykses nxori urdhër përmes të cilit
21 kërkonte parashtrime me shkrim për disa çështje të caktuara,
22 caktonte datën për këtë konferencë përgatitore dhe përcaktonte
23 rendin e ditës për këtë seancë.

24 Sa i takon sot, orari do të jetë i tillë: në orën 11:00
25 do të bëjmë një pushim, do të rifillojmë në orën 11:30 deri në

1 orën 01:00 përafërsisht. Pastaj do të bëjmë pushimin e drekës
2 dhe do të rikthehemi në seancë rreth orës 14:30 dhe do ta
3 mbyllim seancën sot në orën 16:00 dhe nëse është nevoja do të
4 vazhdojmë dhe nesër.

5 Paraprakisht dua t'ju informoj se orari, duke filluar që
6 nesër dhe për ditët e tjera të këtij gjykimi, do të jetë si
7 vijon: seanca e parë 09:30 deri në 11:00; seanca e dytë, nga
8 ora 11:30 deri në orën 12:00; seanca e tretë nga ora 14:30
9 deri në orën 16:00 dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme, nëse
10 është nevoja, mund të ketë një seancë të fundit nga ora 16:30
11 deri në përfundim. Pra nesër, do të fillojmë në orën 09:30 dhe
12 jo në orën 10:00.

13 Dëshiroj që t'u rikujtoj të gjithëve se duhen respektuar
14 disa rregulla të caktuara gjatë gjithë kohës në mënyrë që të
15 kemi një procesverbal të saktë të punimeve në seancë. Ju
16 lutem, që të ndizni gjithmonë mikrofonin. Duhet të mbani
17 parasysh edhe nevojën për përkthim, proces i cili krijon një
18 farë vonese ndonjëherë. Nëse jeni brenda sallës së gjyqit,
19 duhet që të kërkonit lejen për të folur duke u ngritur në
20 këmbë. Nëse jeni jashtë sallës së gjyqit, pra me videolidhje
21 mjafton të ngrini dorën.

22 Ajo që do themi gjatë seancës do të zbardhet në kohë
23 reale dhe do të reflektohen në një transkript i cili do të
24 vihet në dispozicion të palëve dhe publikut pas kësaj seance.
25 Ju rikujtoj palëve që të na njoftojnë paraprakisht që, nëse

1 ndonjë informacion është konfidencial në parashtrimet e tyre
2 të ardhshme duhet të na informojnë për këtë, në mënyrë që të
3 kalojmë në seancë private apo të mbyllur.

4 Duhet të fillojmë sot me disa pyetje të cilat kanë lindur
5 nga parashtrimet me shkrim që i kemi marrë. Do të vijojmë
6 pastaj të diskutojmë për çështjet që i kemi përcaktuar për
7 këtë seancë. Kolegët e mi mund të bëjnë pyetje. Ju lutem,
8 gjatë parashtrimeve tuaj të mos përsërisni veten apo
9 parashtrimet e kolegëve të tjerë, qofshin këto me shkrim apo
10 gojarisht. Ju siguroj se i kemi lexuar të gjitha.

11 Ju lutem, mbani parasysh udhëzimet e Trupit Gjykses që
12 parashtrimi i bërë gojarisht të jetë jo më shumë se pesë
13 minuta për çështje dhe të jetë konciz dhe të fokusoheni te
14 argumentet tuaja.

15 Do të fillojmë me masat mbrojtëse që ka kërkuar ZPS-ja.

16 Tani ja jap fjalën kolegut, gjykatësit Barthe.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Besoj se
18 dëgjohem. Faleminderit gjykatësi Smith. Siç është udhëzuar në
19 urdhrin e 21 korrikut të Trupit Gjykses, ZPS-ja ka dorëzuar më
20 23 gusht një kërkesë për masa mbrojtëse për dy dëshmitarë.

21 Duke pasur parasysh se kjo është kërkesa e parë që i
22 paraqitet këtij Trupi Gjykses në lidhje me masat mbrojtëse,
23 dëshirojmë që të bëjmë disa pyetje specifike sa i takon
24 standardit që do të zbatohet dhe rrjedhojat që do të kenë
25 masat mbrojtëse.

1 PY. ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses që të autorizojë dy
2 masa mbrojtëse për dy dëshmitarë të saj; së pari, caktimin e
3 pseudonimeve gjatë të gjithë procedurave publike dhe, së dyti,
4 fshirjen e emrave të dëshmitarëve dhe të informacioneve
5 identifikuese të tyre nga dokumentacioni publik i Gjykatës.

6 ZPS-ja parashtro se këto dy masa janë në përputhje me të
7 drejtat e të akuzuarve dhe vëren se të akuzuarit i dinë tashmë
8 identitetet e dëshmitarëve dhe do të njihen me dëshminë e tyre
9 të plotë në sallë. ZPS-ja, gjithashtu, parashtro se këto masa
10 mbrojtëse janë të nevojshme për të siguruar sigurinë e dy
11 dëshmitarëve dhe të persona me të cilët ata kanë të bëjnë si
12 edhe integritetin e hetimeve të tanishme dhe të ardhshme. ZPS-
13 ja vëren se masat e kërkuara kanë të bëjnë vetëm me mbrojtjen
14 e identifikimit të tyre kundrejt publikut të gjerë. Me fjalë
15 të tjera, dy dëshmitarët e identifikueshëm me pseudonim do të
16 shihen dhe do të dëgjohen nga publiku gjatë dhënies së
17 dëshmisë së tyre në sallë.

18 Mbrojtja e Haradinajt përgjigjet se masat e kërkuar
19 përbejnë anonimitet dhe për pasojë kjo do të thotë se z.
20 Haradinaj i hiqet e drejta për t'u përballur me akuzuesin e
21 vet, çka e vendos në një disavantazh të konsiderueshëm që
22 përbën shkelje të parimit të barazisë midis palëve. Kjo
23 Mbrojtje, gjithashtu, parashtro se nuk ka dëshmi të cilat do
24 të tregojnë se ndonjë punonjës i ZPS-së ka nevojë për
25 mbrojtje.

1 Mbroytja e Gucatit ka bërë të ditur se dëshiron që të
2 përgjigjet gojarisht gjatë kësaj konference.

3 Z. Rees, fjala është për ju.

4 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Jam
5 në dijeni se janë bërë parashtrimet të plota me shkrim në emër
6 të z. Haradinaj. I mbështes këto parashtrime dhe do të
7 mbështes të gjitha parashtrimet që do të bëjë në formë
8 plotësuese sot z. Cadman.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

10 Z. Cadman dëshironi të shtoni diçka në këtë moment.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës. Ne e kemi
12 përshkruar qëndrimin tonë në parashtrimet tona me shkrim dhe
13 jam i vetëdijshëm për udhëzimin për të mos i përsëritur për
14 këtë.

15 Ajo që ne kemi përshkruar ka të bëjë me çështjen e
16 anonimitetit. Ne e kuptojmë se identiteti i këtyre dy
17 dëshmitarëve është i ditur për ne. Ka sigurisht aspekte të
18 dëshmive të tyre që kanë të bëjnë me dëshmitarë të tjerë të
19 cilët nuk janë të ditur për ne dhe ne nuk e kemi mundësinë për
20 të bërë kundërpjetje. Çështja, sigurisht, ka të bëjë nëse të
21 gjithë dëshmitarët profesionistë, siç janë këta të dy, kanë
22 apo jo të drejtë për anonimitet.

23 Ne parashtrojmë se nuk ka bazë të përshtatshme sipas
24 rregullores për miratimin e këtyre masa mbrojtëse siç kërkojnë
25 nga ZPS-ja. Unë nuk do doja të përsërisja edhe një herë

1 parashtrimet që kemi bërë me shkrim, por mund të shpjegoja
2 diçka që nuk do të ishte e qartë apo që kërkon sqarim më tej.
3 Por ky është qëndrimi që mbajmë ne sipas kornizës rregullatore
4 sa i takon dhënies apo parashikimit të masave mbrojtëse të
5 tilla për të gjithë dëshmitarët profesionistë nga Zyra e
6 Prokurorit të Specializuar.

7 Por dua që të theksoj edhe diçka, se ne e pranojmë se
8 këta nuk janë dëshmitarë anonimë në kuptimin e ngushtë të
9 fjalës, në kuptimin që avokati e di identitetin e tyre dhe do
10 të jetë në gjendje që t’u bëjë kundërpjetje në bazë të kësaj.
11 Por mund të ketë aspekte të caktuara të dëshmisë së tyre që
12 kanë të bëjnë me dëshmitarë anonimë që na vendos neve në
13 disavantazh.

14 GYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

15 Dua t’ia jap edhe një herë fjalën z. Rees.

16 Z. REES: [Përkthim] Për të qenë të qartë, a jeni dakord
17 edhe me atë çfarë tha avokati i z. Haradinaj, se e pranoni që
18 jeni në dijeni të identiteteve të të dy dëshmitarëve?

19 Z. REES: [Përkthim] Jam në dijeni të identiteteve të dy
20 dëshmitarëve por, gjithsesi, e mbështes plotësisht
21 parashtrimin e bërë gojarisht nga z. Cadman tani.

22 GYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

23 Tani ia jap fjalën Prokurorisë nëse dëshirojnë të shtojnë
24 diçka.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Shkurtimisht, i nderuar Gjykatës.

1 Këta nuk janë anonimë në kuptimin e kësaj fjale. Mbrojtja
2 është në dijeni të tyre. Çështja "Kostovski", që është cituar
3 nga Mbrojtja, është një rast komplet tjetër. Dëshmia e
4 dëshmitarëve nuk dëgjohej nga Mbrojtja në atë kohë kur jepej
5 në sallën e gjyqit. Në rastin tonë nuk do të jetë kështu.

6 Mbase mund të ketë elemente të personave të panjohur të
7 cilat do të diskutohen në dëshminë e këtyre dëshmitarëve në
8 sallë, por ata persona nuk janë pjesë e objektit të masës
9 mbrojtëse për të cilën ne kërkojmë. Masat mbrojtëse kanë të
10 bëjnë vetëm me këto dy dëshmitarë në fjalë dhe nuk janë anonim
11 dhe këta dëshmitarë nuk janë anonim. Faleminderit.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. prokuror.

13 Pyetja tjetër është po kështu në lidhje me Prokurorinë.
14 Në kërkesën tuaj z. prokuror, ju keni përmendur ndër të tjera
15 nenin 23 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe rregullin 80
16 të Rregullores së Procedurës dhe Provave, sipas së cilës:
17 "Masat mbrojtëse mund të urdhërohen vetëm për sigurinë,
18 mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë
19 e dëshmitarëve dhe të persona të tjerë të cilët rrezikohen për
20 shkak të dëshmisë që japin dëshmitarët me kusht që masa të
21 tilla të mos bien ndesh me të drejtat e të akuzuarve".

22 I lutem Prokurorisë që të shpjegojnë pse jeni të mendimit
23 që këto kushte janë përmbushur në lidhje me këta dy dëshmitarë
24 dhe do të doja që të pyesja sesi siguria, mirëqenia
25 psikologjike apo fizike, dinjiteti apo privatësia e këtyre

1 dëshmitarëve do të cenohej nëse nuk redaktoheshin emrat e
2 tyre. Nëse mendoni se është e nevojshme të kalojmë në seancë
3 private apo të mbyllur përpara se të jepni përgjigje, ju lutem
4 na informoni. Keni fjalën.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
6 Do përpiqem të përgjigjem në atë mënyrë që të qëndrojmë në
7 seancë të hapur.

8 Lidhur me këtë kërkesë, këta dëshmitarë kryejnë
9 aktivitete, që do të thotë se nëse do të njiheshin emrat e
10 tyre do të ishte më e vështirë që ata t'i kryenin këto
11 aktivitete përfshirë këtu dhe mbrojtjen e tyre, pra, sigurinë
12 e tyre. Prandaj bëhet fjalë që t'u jepet mundësi këtyre
13 dëshmitarëve që ta kryejnë punën e tyre me siguri të plotë.

14 Pra, ne e kemi thënë në kërkesën tonë që ata ndërveprojnë
15 me persona të tjerë, me dëshmitarë të tjerë në çështje të
16 tjera gjyqësore dhe për shkak të kësaj, çdo gjë që do ta
17 lidhte aktivitetin e tyre me emrat e tyre do të kishte një
18 efekt domino edhe tek dëshmitarët e tjerë. Ajo që ne kërkojmë
19 është ajo që flitet tek Udhëzuesi i Punës për dosjet dhe
20 parashtrimet e protokolluara, sa i takon mbrojtjes së stafit
21 të Prokurorisë ku ato duhen përmendur me titullin dhe
22 pozicionin dhe jo me emrin.

23 Dhe është e rëndësishme që të mos përmenden emrat e tyre
24 në dokumentacionin publik të Gjykatës, për arsyet që unë
25 përmenda dhe kjo nuk i cenon të drejtat e të akuzuarve duke

1 qenë se këto masa mbrojtëse nuk cenojnë mundësinë e tyre për
2 t'i marrë në pyetje këta dëshmitarë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. prokuror.

4 Në vijim të kësaj, pak më parë, por edhe në paragrafin 4
5 të kërkesës suaj z. prokuror, ju pretendoni dhe këtu po citoj
6 nga kërkesa juaj:

7 "Që dy dëshmitarët të përmenden vetëm me pseudonim është
8 e nevojshme që këta të kryejnë punën e tyre duke mbrojtur në
9 të njëjtën kohë sigurinë e tyre, sigurinë e dëshmitarëve dhe
10 të personave të tjerë dhe pacenueshmërinë e hetimeve të
11 tanishme dhe të ardhshme".

12 Lidhur me këtë, do të doja të dija, nëse ju kur thoni
13 "punë" e keni fjalën për punën e ZPS-së në përgjithësi apo
14 punën e dy dëshmitarëve në veçanti dhe pacenueshmëria e
15 hetimeve të tanishme dhe të ardhshme mbrohen në veçanti nga
16 neni 23(1) dhe rregulli 80(1) dhe nëse po, pra, nëse përgjigja
17 është po, pse?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Arsyeja përse përgjigja është po,
19 është se pacenueshmëria e hetimeve në këtë kontekst është e
20 lidhur me sigurinë e personave në fjalë. Nëse punonjësit tanë
21 nuk janë të sigurtë kur ushtrojnë aktivitet në terren, kjo
22 cenon dhe hetimet tona dhe pacenueshmërinë e hetimeve tona.

23 Prandaj dhe unë do thosha që pengimi i hetimeve nuk është
24 në rregullën 80 dhe kjo do të thotë, që nuk do konsideroj,
25 pra, kjo nuk qëndron si argument. Për mendimin tonë, mënyra

1 sesi është formuluar rregulli 80 ka të bëjë me pacenueshmërinë
2 e hetimeve, me integritetin e tyre dhe nëse kjo cenohet
3 atëherë hyn në lojë edhe ky rregull.

4 Pra, janë të gjitha të lidhura me njëra-tjetrën nuk është
5 një faktor që qëndron më vete që po s'u përmend shprehimisht
6 në rregull, atëherë nuk zbatohet ai rregull. Janë të gjitha të
7 ndërlidhura.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit z. prokuror.

9 Z. Cadman.

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Për t'ju përgjigjur shkurtimisht
11 argumenteve që bëri Prokuroria.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Cadman, do keni mundësinë
13 që t'u përgjigjeni të gjithave pasi të bëjmë ne pyetjet. Do ju
14 lutesha, që të prisnit sa të bëjmë edhe disa pyetje të tjera,
15 po edhe disa minuta të tjera. Faleminderit.

16 Z. prokuror, për të vijuar dua që t'i rikthehem
17 paragrafit 4 të kërkesës suaj për masa mbrojtëse, ku thoni dhe
18 argumentoni se "domosdoshmëria e mbrojtjes së identitetit të
19 punonjësve të ZPS-së pranohet shprehimisht në skemën ligjore
20 të Dhomave të Specializuara. Në këtë kuadër ju përmendni ndër
21 të tjera edhe nenin 33 të Udhëzuesit të Punës së Zyrës
22 Administrative për dosjet dhe parashtimet e protokolluara që
23 kërkon se punonjësit e ZPS-së do të përmenden vetëm përmes
24 titujve funksional me përjashtim të rasteve kur është
25 domosdoshmërisht e nevojshme.

1 Pra, nëse kjo është e saktë, kjo do të thotë se të paktën
2 teorikisht të gjithë punonjësit e ZPS-së mund të përmenden
3 vetëm përmes titujve funksional dhe/ose kanë të drejtë për t'u
4 caktuar pseudonimi gjatë procedurave në proces pavarësisht nga
5 roli procedural apo funksioni i tyre i brendshëm apo funksioni
6 i tyre i brendshëm. Ku do ta vinit kufirin sa i takon kësaj?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Kufiri është aty ku e ka vendosur
8 Udhëzuesi i Punës, i nderuar Gjykatës. Është një rregull e
9 përgjithshme, pra, është në rregullat aty që këta punonjës do
10 përmenden me titujt funksional. Ka një përjashtim kur është
11 rreptësisht e domosdoshme nëse ka një rast kur p.sh., një
12 punonjës i ZPS-së ka një rol shumë të rëndësishëm për një
13 procedurë, atëherë, është në dorë të Trupit Gjykses që ta
14 shpallë këtë rast si rreptësisht të domosdoshëm për të
15 zbuluar emrin e këtij punonjësi.

16 Në rastin tonë nuk ndodhemi në një situatë të tillë. Ne,
17 në këtë rast, nuk po kërkojmë një masë çliruese. Ne thjesht po
18 e citojmë udhëzuesin e punës për ta ilustruar se nuk ka arsye
19 pse të përmenden me emër punonjësit e ZPS-së në këtë
20 procedurë. Kjo është e lidhur dhe me rregullin 80 të
21 Rregullores.

22 Pra, ne nuk do thoshim kurrë që ky është një rregull
23 absolut që duhet të zbatohet në çdo rast. Por ka një logjikë
24 mbi të cilën mbështeten këto rregulla. Ka një logjikë edhe në
25 rastin tonë. Nuk kemi ndonjë domosdoshmëri të jashtëzakonshme

1 të identifikuar dhe nga Mbrojtja sidomos duke pasur parasysh
2 që nuk kemi të bëjmë me anonimitet.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
4 prokuror.

5 Tani pyetja ime e fundit për Prokurorinë. Në
6 poshtëshënimin numër 7 të kërkesës suaj, ju keni cituar
7 jurisprudencën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare që janë
8 vendimet në proceset kundër "Dominik Ongwen, Jean-Pierre Bemba
9 Gombo dhe të tjerë dhe Germain Katanga e të tjerë". A mund të
10 shpjegoni ju lutem, përse dhe deri ku, argumentimet juridike
11 në ato vendime do të ishin të zbatueshme dhe në rastin tonë?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

13 Gjykata Penale Ndërkombëtare ka kuadrin e vet për masat
14 mbrojtëse, në veçanti, rregulli 81 i Rregullores së Gjykatës
15 Penale Ndërkombëtare. Sigurisht ky kuadër është shumë i
16 ngjashëm me rregullin 80 të tonin. Ne s'po themi që rregullat
17 e tyre janë të zbatueshme për ne, por gjykatësit në rastin e
18 Gjykatës Penale Ndërkombëtare kanë vënë re situata, pra, kanë
19 shqyrtuar situata të ngjashme dhe kanë miratuar masat
20 mbrojtëse në gjykatë për hetuesit e Prokurorisë.

21 Në këto raste identitetet e këtyre hetuesve ishin të
22 ditura për Mbrojtjen gjatë dhënies së dëshmisë së tyre dhe nuk
23 kishte asnjë problem sa i takon bërjes së kundërpvetjeve nga
24 Mbrojtja. Nuk ishte pra, një nivel i ulët i masave mbrojtëse
25 që janë miratuar dhe ne kërkojmë që të ndjekim një rrugë të

1 ngjashme.

2 Po të krahasojmë mocionin tonë për përmbledhje të
3 rregullit 95 për këta dëshmitarë, ne po kërkojmë më pak
4 mbrojtje seç kërkonim më përpara. Pra, po përpigemi që të
5 vendosim në drejtpeshim zhvillimin në publik të procesit me
6 nevojat për masa mbrojtëse dhe ne mendojmë që kjo nuk cenon të
7 zhvilluarit në publik të këtij procesi gjyqësor, siç është
8 shpjeguar nga ne dhe nga vendimet e Gjykatës Penale
9 Ndërkombëtare.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Kaq kisha pyetje për Prokurorinë. Tani do t'i kthehem
12 Mbrojtjes. Njësoj si në rastin e Mbrojtjes, ashtu edhe ju, do
13 të keni mundësi që të shpreheni, pra, si z. Cadman edhe z.
14 Rees lidhur me argumentet e paraqitura nga Prokuroria.

15 Pyetja ime që kam për Mbrojtjen, është kjo, Z. Cadman, po
16 filloj nga ju meqenëse ju keni parashtruar me shkrim. Në
17 parashtrimet tuaja për konferencën përgatitore për gjykim
18 pretendoni se masat e kërkuara nga ZPS-ja nuk mund të
19 justifikohen sipas rregullores së kësaj gjykate dhe gjithashtu
20 ato, gjithsesi nuk përputhen me të drejtat e të akuzuarit dhe
21 me të drejtën e tij për seancë publike, për gjykim publik
22 përfshirë edhe të drejtën për t'u përballur me ata që e
23 akuzojnë. Këtë e keni thënë në paragrafin 11 të parashtrimit
24 tuaj.

25 Gjithashtu, ju në mënyrë të përsëritur u referoheni

1 dëshmitarëve të ZPS-së si dëshmitarë anonim;, një fakt i cili
2 ju pengon juve në mënyrë efektive që t'u bëni kundërpyetje në
3 bazë të identitetit të tyre. Paragrafi 18 i parashtimit tuaj.

4 Duke pasur parasysh që si emrat, ashtu edhe formimi
5 profesional i këtyre dy dëshmitarëve ju është bërë i ditur, si
6 juve ashtu e dhe klientit tuaj, po kështu edhe avokatit tjetër
7 dhe të akuzuarit tjetër, në këtë rast, i referohem shtojcës 2
8 të parashtimit të dosjes përgatitore të ZPS-së, Lista e
9 dëshmitarëve dhe e provave materiale është lista e rregullit
10 109(c) është dokumenti F181/A2 dhe se duke pasur parasysh
11 faktin që këta dëshmitarë do të shihen dhe do të dëgjohen si
12 nga të akuzuarit dhe nga avokatët, edhe nga publiku. A
13 vazhdoni të mendoni se këto masa gjithsesi do të ishin në
14 kundërshtim me të drejtat e të akuzuarve dhe se do ta pengonin
15 Mbrojtjen që t'u bënte kundër pyetje në mënyrë efektive atyre.

16 Në rastin tuaj ju citoni në paragrafin 15 dhe në
17 poshtëshënimin 10, çështjen "Kostovski kundër Holandës" ku
18 GJEDNJ-ja konstatonte një shkelje të nenit 6(1) dhe 3(d) të
19 KEDNJ-së për shkak se i pandehuri në atë rast u shpall fajtor
20 për vjedhje nën kërcënimin e armës në bazë të, pra, në një
21 shkallë të, më falni, në një shkallë vendimtare, - kërkoj
22 ndjesë -, mbështetur në deklaratat e dy dëshmitarëve anonim të
23 cilët as gjatë gjyimit, as gjatë fazës së hetimit nuk ishin
24 intervistuar në prani të të akuzuarit dhe të avokatit të tij.
25 Pra, a mendoni se do të ishte ky rasti, që nuk është, pra, ky

1 rast në kërkesën e ZPS-së.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Pikë së pari, e pranojmë që, siç u
3 tha më përpara, nuk është pikë për pikë e njëjta situatë si në
4 çështjen "Kostovski". Sigurisht, anonimiteti mund të jetë një
5 koncept më i gjerë jo vetëm të mosditurit e emrave të këtyre
6 individëve.

7 Ajo që ZPS-ja ka përmendur është se ata mbështeten në
8 parimet e përgjithshme të Udhëzuesit të Punës. Qëndrimi ynë
9 është që Udhëzuesi i Punës është thjeshtë udhëzues. Pra, nuk
10 ka fuqinë e ligjit, fuqinë e kornizës ligjore të këtij
11 institucioni.

12 Mbrojtja nuk e ka pranuar kurrë se duhet që të ketë një
13 rregull të përgjithshëm që do të çonte në mospërmendjen e
14 emrave të çdo punonjësi të Prokurorisë. E kjo ka qenë një
15 shqetësim që ne e kemi paraqitur edhe më përpara. Sipas
16 mendimit tonë, Udhëzuesi i Punës nuk përputhet me parimet e
17 përgjithshme të zbatueshme.

18 Çështja në këtë rast ka të bëjë me faktin që emrat e
19 këtyre dy individëve do të anonimizohen, pra, do të fshihen
20 nga dokumentacioni publik i Gjykatës për këtë procedurë.

21 Siç e ka thënë Prokuroria, ato fillimisht kishin kërkuar
22 edhe dy forma të tjera përveç mospërmendjes së emrave, ndërsa
23 tani ato po kërkojnë vetëm fshirjen e emrave të tyre.

24 Pyetja që ngremë ne është: pse është e nevojshme kjo? Ajo
25 që ka përmendur Prokuroria është se këta janë individ të cilët

1 kanë kryer intervista me dëshmitarë dhe po vijnë që të kryejnë
2 intervista me dëshmitarë. Këta nuk janë individë të cilët janë
3 të ditur. Duhet mbajtur parasysh kjo gjë lidhur me faktin nëse
4 identitetet e tyre njihen si punonjës të ZPS-së dhe do të
5 vijojnë që të dihen që punojnë me dëshmitarë. Pse ekziston kjo
6 nevojë e domosdoshme për t'i fshirë emrat e tyre nga
7 dokumentacioni.

8 Edhe njëherë, unë nuk dua të përsëris ato që kemi bërë në
9 parashtrimet e tona me shkrim. Qëndrimi ynë është, që nuk
10 është rreptësishtë i domosdoshëm. Prokuroria nuk ka
11 identifikuar përse është rreptësishtë e domosdoshme. Çfarë
12 rreziku do t'u kanosej këtyre profesionistëve nëse emrat e
13 tyre do të bëheshin publik gjatë kësaj procedure dhe fakti që
14 do të vijonin punën e tyre dhe kontaktet me dëshmitarët?

15 Pra, edhe njëherë, pyetja që ne ngremë është: Pse është
16 rreptësishtë e domosdoshme heqja e emrave të tyre nga
17 dokumentacioni publik? Pra, nuk bëhet fjalë për mostregimin e
18 emrave të individëve nga palët, sigurisht, ka kufizime që na
19 vendosen ne për të bërë kundërpjetje individëve nëse nuk dinë
20 identitetet dhe ne pyetjet i bëjmë vetëm në bazë të
21 identitetit të tyre.

22 Këtë i kërkojmë Trupit Gjykses që të mbajë parasysh kur
23 të marrë një vendim lidhur me këtë kërkesë të ZPS-së. Pra,
24 nëse kjo kërkesë është apo jo rreptësishtë e domosdoshme. Ne
25 themi që nuk është.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

2 Z. Rees, nuk e di nëse doni të thoni ndonjë gjë lidhur me
3 këtë.

4 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, do të bëjë një
5 parashtrim shumë të shkurtër. Bëhet fjalë për parimin, pra
6 është çështje parimore. Pika nisëse është se ky gjykim do të
7 jetë një gjykim publik dhe publiku ka të drejtë që të ndjekë
8 atë. Pra, me fjalë të tjera, ka interes të publikut për
9 ndjekjen e këtij procesi dhe ata duhet të dinë se kush janë
10 dëshmitarët dhe të ndjekin provat materiale. Domethënë në
11 përjashtim të rasteve kur ka arsye shumë të forta për ta
12 ndryshuar këtë pikë nisëse të procesit gjyqësor situata duhet
13 të jetë ajo të cilën unë e përshkrova pak më parë.

14 Të nderuar, në qoftë se juve i kërkon ZPS-së që të
15 vijojë me kërkesën e saj, kjo është çështja juaj, megjithatë
16 do të doja të thoja që përgjigja ime është që ne duhet të kemi
17 mundësi, në mënyrë të drejtpërdrejtë, t'i bëjmë pyetje
18 dëshmitarëve. Ky është parimi i drejtë, ky është parimi i
19 përgjithshëm. Dhe ne themi që ZPS-ja nuk e ka përmbushur
20 kriterin e rreptë për të ndërhyrë me këtë pikë nisëse sepse,
21 siç e thamë, këto dëshmitarë janë shumë të rëndësishëm në
22 kuptimin që publiku duhet të ketë të drejtë të ndjekë procesin
23 gjyqësor.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

25 Nuk e di nëse z. prokuror doni që të përgjigjeni?

1 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, besoj që ne
2 sot e thamë, i thamë të gjitha parashtrimet, i kemi dhënë me
3 shkrim i dhamë edhe parashtrimet me gojë sot. Kështu që, nuk
4 kemi asnjë gjë tjetër për të shtuar me përjashtim të rasteve
5 që ju mund të keni ndonjë pyetje për ne.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. prokuror.
7 Këto ishin pyetjet që kisha për ju.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë faleminderit, z.
9 Smith.

10 Në qoftë se më lejoni, do të doja që të shkojmë më tej me
11 parashtrimet e prokurorëve që nxjerrja e emrave të
12 dëshmitarëve mund të krijojë problem për sa i takon ose mund
13 të krijojë një rrezik sa i takon sigurisë së tyre ose të
14 individëve të tjerë me të cilët ata ndërveprojnë. Kam disa
15 pyetje.

16 Pra, kur flisni për mundësinë e thërritjes së këtyre
17 personave si dëshmitarë besoj se ju i keni informuar ata për
18 arsyen se ata do të thërriten si dëshmitarë pa aplikimin e
19 masave mbrojtëse dhe donim të dinim nëse ka qenë ky rasti apo
20 jo?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar, është e vërtetë, që të
22 gjithë dëshmitarët me të cilët ndërvepron ZPS-ja, e dinë që
23 ZPS-ja ka të drejtë që mund të kërkojë masa mbrojtëse po
24 pastaj është e drejtë e Trupit Gjykses për të vendosur në
25 qoftë se këto masa do të zbatohen apo jo.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mos u ulni z. Halling
2 sepse kam disa pyetje për juve lidhur me këtë. Atëherë,
3 faleminderit për përgjigjen dhe në qoftë se është kjo
4 përgjigja juaj dhe jam i lumtur me konfirmimin tuaj për këtë
5 drejtim, kjo do të thotë që kjo sugjeron që ju i keni kërkuar
6 këtyre personave që të përgatisin deklaratat për procesin
7 gjyqësor dhe ata e kuptojnë, domethënë, që nuk është e
8 domosdoshme që masat që ju i keni kërkuar për ta, pra, masat
9 mbrojtëse nuk është se do të jepen me patjetër për ta. Nuk
10 është kështu?

11 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kjo është
12 mënyra sesi funksionon me të gjithë dëshmitarët tanë. Ne duhet
13 të marrim deklaratat, ne duhet t'i nxjerrim ata dhe nuk varet
14 nga ne në qoftë se neve sigurojmë mbrojtjen apo jo. Ne mund të
15 kërkojmë masa mbrojtëse dhe të japim justifikime që ne
16 mendojmë që janë të arsyeshme për këtë gjë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, mbase nuk është e
18 nevojshme për ta thënë se kështu rezulton, se është çështja
19 por, kjo prezumon që juve keni marrë vendim që t'i thërrisni
20 këto persona si dëshmitar edhe në qoftë se nuk miratohen nga
21 Trupi Gjykses masat mbrojtëse për ta. A është e saktë kjo?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, e saktë është. Por ky është
23 një rrezik të cilin neve e kalojmë me të gjithë dëshmitarët.
24 Edhe dëshmitarë të cilët kanë situata shumë të vështira
25 sigurimi, që kanë persona të familjes që janë vrarë, pra, edhe

1 këta janë persona, masat mbrojtëse për të cilët duhet që të
2 miratohen nga Trupi Gjykues. Pra, ky është një risk me të
3 cilin neve përballemi gjatë gjithë kohës, por ne bëjmë të
4 pamundurën në mënyrë që të jemi sa më të arsyetuar sa i takon
5 arsyes për dhënien e masave mbrojtëse.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

7 Dua t'ju pyes specifikisht për diçka. Në paragrafin 3 të
8 parashtrimeve tuaja juve i referoheni rrezikut ndaj të
9 tjerëve, faktit që emrat apo tipare të tjera identifikuese për
10 ta mund të krijojnë një lidhje efektive me këtë organizatë që
11 mund t'i vendos; njerëzit në një rrezik në momentin kur ata
12 ndërveprojnë me ta. Pra, një të njëjtën kohë, siç e thatë juve
13 me të drejtë, juve nuk po kërkon nxjerrjen e paraqitjes së
14 tyre fizike.

15 Unë dua të di në qoftë se nxjerrja e tipareve fizike, e
16 fizikut të tyre mbase mund të ketë të njëjtin efekt asociues
17 me kush janë ata, pra, me cilët janë këta persona apo me
18 funksionet e tyre edhe ndërkohë që ju na kërkon që të mos
19 nxjerrim emrat e tyre por lejoni që fytyrat e tyre p.sh., të
20 shfaqen në ekran. A mund ta shtjelloni pak këtë pozicion, ju
21 lutem?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Pra, i nderuar Gjykatës, juve i
23 referoheni një pjese të parashtrimit tonë që është
24 konfidencial, megjithatë unë do të mundohem që të jap një
25 përgjigje në seancë të hapur.

1 Ka një lidhje ekstra që lidhet me emrin e personave të
2 ZPS-së dhe aktivitetet e tyre në terren. Pra, dhe kjo jo
3 domosdoshmërisht, mund të krijohet nga paraqitja e zërit apo e
4 fytyrës. Pra, kemi një rrezik të mëtejshëm në qoftë se do të
5 nxirret emri i personave dhe ku mund të shkruhet p.sh., emri i
6 këtyre në dokumentet apo p.sh., kjo mund të ketë ndikim edhe
7 sa i takon udhëtimeve apo dërgimin me mision nga ZPS-ja. Ky
8 është risku, kjo është pjesa e riskut që ne po mundohemi që të
9 eliminohet.

10 Në qoftë se Trupi Gjykses arrin në përfundimin që kjo nuk
11 është pjesë ose nuk është e arsyetuar, atëherë, është gjykimi
12 juaj. Megjithatë ne jemi munduar nga ana jonë, pra, ZPS-ja
13 është munduar që të kërkojë minimumin e masave mbrojtëse në
14 mënyrë që mund të krijojë një filtër të ulët të mbrojtjes për
15 ta.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po sugjeroj që juve të
17 kërkoni më tepër, le të themi, masa mbrojtëse po thjeshtë po
18 mundohet që të kuptoj arsyetimin tuaj.

19 Pra, ju thoni, pra, fakti që do paraqitet fytyra dhe zëri
20 dhe a nuk mendoni se njerëzve ndoshta ju intereson më shumë se
21 çfarë pamje kanë apo të dallojnë fytyrën e tyre më shumë sesa
22 emrat e tyre? Në parashtimet tuaja ju thoni që pasaporta e
23 tyre mund të kalojë në duar të ndryshme për arsye të misionëve
24 të tyre por, a nuk është rasti që, në qoftë se p.sh., fytyrat
25 e tyre do të shfaqen në ekran a nuk i ekspozon njësoj njerëzit

1 fakti që këta dëshmitarë do të jenë në mënyrë të
2 drejtpërdrejtë të pashëm për publikun?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po ekziston edhe një rrezik edhe
4 në këtë aspekt. Pra p.sh., në qoftë se dikush më bënë një
5 fotografi, në qoftë se më bën një fotografi sot në mëngjes
6 edhe e merr këtë fotografi time dhe duan të gjejnë emrin tim,
7 domethënë, si mund të gjesh lidhje ndërmjet fotografisë edhe
8 emrit? Nuk mund ta futësh dot fotografinë në një kërkim në
9 Google për të bërë le të themi lidhjen e figurës me emrin.

10 Pra, është shumë herë më e thjeshtë për të identifikuar
11 se kush jam unë, ku jetoj, çfarë bëj unë, përfshirë edhe
12 fotografi të miat në qoftë se unë kam emrin. Pra, emri në
13 vetvete është elementi që krijon një nivel risku që justifikon
14 masat mbrojtëse.

15 Mbase dikush mund të ketë mundësi që të bëjë lidhje të
16 llojit që ju përshkruat vetëm nga fotografia, por sipas
17 vlerësimit tonë ky është një risk i cili është i menaxhueshëm,
18 por risku që lidhet me zbulimin e emrit nuk është i
19 menaxhueshëm.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Domethënë, kjo është kjo
21 pjesa ligjore e mendjes tuaj që do të doja të shkoja pak më
22 tej. Ka të bëjë me zbatimin e testit që ju po na ftoni që të
23 pëmbushim ne.

24 Në qoftë se e kuptojmë siç duhet, baza e parashtimit
25 tuaj është se, nxjerrja e identiteteve të dëshmitarëve të

1 propozuar do të krijojnë gjasa të rrezikut të shtuar të
2 personave për të cilët flitet.

3 Ajo çfarë do të doja të dija prej jush është në qoftë se
4 ju jeni në dijeni të një precedenti ligjor, në veçanti nga
5 Kosova, pra, një precedenti specifik ligjor që do të kishte
6 dhënë masa mbrojtëse të cilat ju kërkoni që t'ju japim ne.
7 Duke marrë parasysh, faktikisht, një oficer policie ose një
8 prokuror i cili vepron në emër të palëve dhe për zbatimin e
9 masave mbrojtëse ndaj tyre. Në qoftë se jeni në dijeni të
10 masave të tilla mbrojtëse të një rasti ose një jurisprudence
11 të zbatueshme në Kosovë që është e krahasueshme me rastin në
12 fjalë do ta vlerësonim shumë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne nuk kemi
14 ndonjë çështje nga Kosova për shkak të modelit që juve sapo
15 përkthuat. Ndërkohë ka çështje të EDNJ-së të cilat janë
16 përmendur në parashtrimet tona ku Gjykata nuk ka gjetur
17 shkelje për zbatimin e masave mbrojtëse për persona të cilët
18 janë në detyrë dhe këto janë çështje të cilat mund të merren
19 parasysh.

20 Pra, nuk ka kufizime kushtetuese ose ligjore të lidhura
21 me të drejtat e njeriut për zbatimin e masave mbrojtëse të
22 cilat ne po kërkojmë për dy dëshmitarët në fjalë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Kemi të
24 bëjmë me një çështje ligjore dhe faktike. Është e rëndësishme
25 që ne të shikojmë pak kuadrin mbi të cilin funksionojmë. Ne

1 bëmë një ushtrim për të parë çështjet nga Kosova në TPNJ, pra
2 çështja "Limaj dhe Haradinaj", në mënyrë që mund të
3 përcaktonim, të përpiqeshim të përcaktonim precedentin i cili
4 mund të ishte i zbatueshëm për çështje në fjalë dhe në fakt, e
5 patëm të pamundur që të gjenim çështje të tilla.

6 Duket që precedentët në të dyja rastet pra, na tregojnë
7 që dëshmitarët të cilët kanë shërbyer në të shkuarën e tyre,
8 pra, apo që kanë dalë, le të themi, para publikut me emrin e
9 tyre të bërë publik, domethënë, dhe nuk e di në qoftë se ky
10 është prezumimi dhe kuptimi i saktë i juaji?

11 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, këtë kuptojmë
12 dhe ne. Megjithatë hetuesit në çështjen e TPNJ-së nuk
13 përsërisin aktorët në Kosovë siç bëjnë hetuesit ose hetimet e
14 ZPS-së. Dhe jo vetëm kaq, por hetuesit apo stafi i ZPS-së ka
15 shkuar shumë herë më shpesh dhe i duhet të shkojë shumë herë
16 më shpesh në Kosovë sesa homologët e tyre në TPNJ.

17 Pra, mënyra sesi është bërë vlerësimi duhet të jetë i
18 individualizuar dhe të duhet që të shikohet në kuadrin e
19 rreziqeve që ekzistojnë tani. Ne kemi një poshtëshënim në
20 çështjen "Thaçi" ku identifikohet klima e frikësimit të
21 dëshmitarëve në Kosovë dhe cila është situata apo niveli i
22 riskut në Kosovë aktualisht. Pra, ne kërkojmë që të bëhet
23 vlerësimi mbi meritat individuale, pra, të shikohet se çfarë
24 po bëjnë këta persona identifikisht edhe këto persona, pra,
25 këto individë aktualisht edhe kontekstin në fjalë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po më detyron që të bëjë
2 një pyetje shtesë që, në fakt, janë pjesë e punës së z.
3 Barthe.

4 Pra, sa i takon Udhëzuesit të Punës, sa i takon
5 parashtrimeve që keni bërë me shkrim po, gjithashtu edhe,
6 parashtrimet gojore këtu përpara Gjykatës, pra, siç e dimë,
7 sigurisht, domethënë Udhëzuesi i Punës nuk është që rregullon
8 marrjen në pyetje të dëshmitarëve apo jo?

9 Z. HALLING: [Përkthim] E saktë. Ne nuk i kërkojmë Trupit
10 Gjykues që të bëjë vendimin, të marrë vendimin sa i takon
11 masave mbrojtëse mbështetur në udhëzuesin e punës. Ne duam që
12 vendimi të merret mbështetur në rregullin 80 dhe mënyra si
13 interpretohet rregulli 80, pra, i referohet pjesëve të tjera
14 më të gjera të skemës stereotipike.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por Udhëzuesi i Punës, në
16 fakt, i referohet punës administrative të Gjykatës jo
17 vendimmarrjes?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Po e saktë, i nderuar Gjykatës.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe po ashtu, në mënyrë të
20 tillë që Udhëzuesi i Punës mund të merret parasysh atëherë do
21 të duhet që të bëhet lidhja e tij me bazën ligjore, me
22 kornizën ligjore dhe duhet gjithashtu të merret që të merret
23 parasysh edhe e drejta e Mbrojtjes për të pasur procedura
24 publike. Nuk është kështu?

25 Z. HALLING: [Përkthim] E saktë, i nderuar Gjykatës. Ne po

1 përdorim Udhëzuesin e Punës në mënyrë që të bëjmë lidhjen e
2 saj me rregullin 80. Është vendosur në ZPS që në nivelin e
3 parashtrimeve protokolluara është më mirë që të mos
4 identifikohen njerëzit me emrat e tyre, pra, e kam fjalën për
5 ata që punojnë për ZPS-në.

6 Ne shohim këtu dhe në pjesë të tjera të skemës ligjore,
7 ne nuk po themi që Trupi Gjykses duhet të mbështetet tek
8 Udhëzuesi i Punës por thjeshtë po themi mënyrën e funksionimit
9 edhe udhëzimet që jepen në të.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për
11 qartësimin.

12 Tani më lejoni t'i drejtohem Mbrojtjes. Z. Cadman i pari.
13 Ju keni bërë një parashtrim me shkrim dhe sot, gjithashtu e
14 thatë në parashtrimin tuaj gojor, që juve pretendoni mbase
15 paragjykimin, aq mund të rezultoi si rezultat i dhënies apo
16 miratimit të masave mbrojtëse nga Trupi Gjykses.

17 Duam që të thoni specifikisht se cili është ky
18 paragjykim? Sepse, siç e tha, z. Rees me të drejtë emrat e
19 individëve, deklaratat e tyre, deklaratat e të nëntëve ju janë
20 dhënë juve. Kështu që ju lutem, a mund të na ndihmoni, a mund
21 të na thoni specifikisht se çfarë nuk do keni mundësi që të
22 bëni ose në çfarë mënyre do të jetë paragjykuese për juve në
23 qoftë se lejohen masat mbrojtëse për këta dy dëshmitarë? Do të
24 donim që na e thonit këtë gjë specifikisht.

25 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ajo çfarë kemi

1 përshkruar dhe çfarë kemi thënë deri tani, domethënë, kemi dy
2 pjesë të argumentit. Pra, së pari proceduarat në parim duhet
3 të jenë publike dhe besoj këtë çështje e kemi bërë shumë të
4 qartë. Çështja tjetër që kemi ngritur është që nuk kemi të
5 bëjmë vetëm thjeshtë me njohjen e identitetit, e kam fjalën,
6 që jo vetëm Mbrojtja duhet të dijë identitetin e dëshmitarëve,
7 por ekzistojnë dhe aspekte të caktuar. Pra, të gjitha aspektet
8 e dëshmitarëve, e identitetit të dëshmitarëve duhet të jenë
9 objekt i kundërpyetjeve.

10 Duhet të bëjmë pyetje për këta dëshmitarë mbështetur mbi
11 identitetin e tyre dhe çfarë funksionesh kanë por...

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem, më lejoni t'ju
13 ndaloj për një moment. Ju do ta keni mundësinë që ta bëni këtë
14 gjë deri në masën që nuk zbulohet, nuk nxirret identiteti i
15 tyre. Të paktën kështu e kuptoj unë mënyrën sesi e kërkojnë
16 masat mbrojtëse Prokuroria, domethënë Prokuroria nuk është se
17 ju mohon juve këtë mundësi. E kundërta është e vërtetë.

18 Apo sugjeroni juve që identiteti specifik i këtyre
19 personave një ose dy personave është në rrezik në
20 kundërpyetjen tuaj të mundshme apo po thoni diçka tjetër?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatë, këto janë të
22 vetmit dëshmitar që janë thirrur nga Prokuroria. Ne nuk është
23 se do të kemi dëshmitarë të tjerë që do të kemi mundësi që t'i
24 marrim në kundërpyetje. Prokuroria nuk po thërret asnjë
25 dëshmitar tjetër mbi të cilin ata nuk kërkojnë masa mbrojtëse.

1 Sigurisht, që ka çështje dhe mbase Gjykata duhet ta
2 shikojë këtë në kornizën e gjithë kësaj lënde. Ne kemi
3 përcaktuar disa kufizime të cilat i janë kërkuar Mbrojtjes por
4 ndërkohë siç e thashë këto janë të dy dëshmitarët e vetëm të
5 ZPS-së, po ne i dimë identitetet e tyre por nga ana tjetër
6 juve i mohoni të pandehurve të drejtën për t'u përballur. Ju
7 po i mohoni të drejtën publikut për të pasur procedura
8 publike.

9 Dhe ka kufizime specifike lidhur me atë çfarë ne mund të
10 bëjmë kundërpyetje për këta dëshmitarë në qoftë se identitetet
11 e tyre nuk do të nxirren. Nuk jam në pozitë për t'ju thënë
12 qoftë se ka kufizime specifike, në qoftë se nuk nxirret
13 identiteti i këtyre persona. Megjithatë është absolutisht e
14 qartë që provat që parashtrohen ose mënyra sesi do të
15 vlerësohen provat, ato do të vlerësohen përmes këtyre
16 dëshmitarëve identitetit të tyre dhe mënyrës sesi do t'i
17 paraqesin ata.

18 Për ne është absolutisht shumë e vështirë në këtë fazë që
19 të mund të parashikojmë çdo rrethanë të mundshme e cila do të
20 na çojë neve në pengimin e bërjes siç duhet të kundërpyetjeve.
21 Mendoj, çështja që duhet të diskutohet është më tepër në qoftë
22 se ekziston nevoja, pra, është e domosdoshme për dhënien e
23 masave mbrojtëse dhe në qoftë se ZPS-ja, pra, është e
24 artikuluar dhe bindëse mjaftueshëm sa i takon shkaqeve që
25 kërkojnë mosnxjerrjen e identitetit të tyre.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, duke prezumuar që
2 mund të ngrihen rrethana ku juve do t'u duhet të bëni një
3 pyetje për secilin prej këtyre dëshmitarëve që do të nxirrnin
4 masat, në qoftë se do të lejoheshin, do të miratoheshin masat
5 e kërkuara nga Prokuroria, a do të ishte zgjidhje për juve që
6 ne të kërkonim një seancë me dyer të mbyllura ku ju mund të
7 bënit pyetjet dhe të mund të vinim mënjanë seancat e hapura.
8 Domethënë, specifikisht, po mundohem të di se cilat janë
9 paragjykimet që mund t'ju krijojë kjo
10 në qoftë se ju nuk do të keni mundësi që t'i drejtoheni përmes
11 identitetin të tyre dëshmitarëve në fjalë. Pra, a nuk do të
12 ishte zgjidhja kjo që ju t'i kërkonit seancës së gjyqësorit,
13 t'i kërkonit Trupit Gjykses që të kalonte me seancë me dyer të
14 mbyllura në qoftë se kishit nevojë që t'i drejtoheshit
15 personit me identitetin e tij?

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, kjo është një zgjidhje. Dhe
17 këtë mbase mund ta shqyrtoj Trupi Gjykses në një fazë,
18 megjithatë, ne parashikojmë rrezikun në kuptimin e gjithë
19 procesit gjyqësor dhe faktit që seanca nuk është e aksesueshme
20 për publikun gjatë të gjithë kohës. Pra, sa i takon bërjes së
21 pyetjeve për këta dy persona, pra, mendojmë që mund të arrijmë
22 në rrezikun që i gjithë procesi i kundërmarrjes në pyetje i
23 këtyre persona mund të kalojë pastaj në seancë me dyer të
24 mbyllura. Ky është rreziku që lidhet me këtë pjesë të
25 procesit.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Rees, kam dy pika, në
2 qoftë se më lejoni.

3 Sa i takon pikës specifike, pyetjes specifike që bëtë për
4 z. Cadman, përkatësisht efektin mbi Mbrojtjen dhe përgatitjen
5 e Mbrojtjes në qoftë se autorizohen masat mbrojtëse dhe
6 dëshmitarët mund të referohen vetëm përmes pseudonimit, më
7 lejoni t'ju them që kjo ka një efekt, një efekt që shkon
8 përtej procesit të marrjes kryesisht në pyetje që ka të bëjë,
9 në fakt, me kundërpvetjet.

10 Ne aktualisht jemi në hetime. Pra, ne po vazhdojmë që të
11 përgatitemi për gjykim, përfshirë këtu edhe të folurit në
12 mënyrë të vazhdueshme me dëshmitarët e Mbrojtjes. Sjellja e
13 ZPS-së, e oficerëve të ZPS-së në këtë çështje që mendoj që
14 është dhënë në detaje dhe është e qartë në dosjen e Procedurës
15 Paraprake dhe në fakt, kjo për neve është një çështje
16 shqetësuese dhe miratimi i masave mbrojtëse për dy persona,
17 njëri prej të cilëve ka qenë i përfshirë në kontrollin aktiv
18 të OVL-UÇK-së në shtator të vitit që shkoi, mendojmë që një
19 gjë e tillë do të pengonte mundësinë tonë për ta hetuar siç
20 duhet këtë çështje.

21 Do të pengonte p.sh., mundësinë tonë për të hetuar në
22 qoftë se ka shqetësime specifike sa i takon besueshmërisë së
23 këtij dëshmitari që mund të dalë nga të folurit me dëshmitarë
24 potencialë të Mbrojtjes, sepse ky person pastaj, në qoftë se
25 do të miratohet kërkesa e ZPS-së, do të duhet që t'i

1 drejtohem i vetëm me pseudonime. Kjo është pika e parë.

2 Ndërkohë kemi një tjetër pikë, pikën e dytë që do të doja
3 që të ngrija që del nga parashtrimet e bëra nga z. Halling. Ai
4 ju referua një parashtrimi të protokolluar në çështjen "Thaçi
5 dhe të tjerët" që përshkruan, siç tha ai, mjedisin siç ai
6 ekziston aktualisht në Kosovë në lidhje me dëshmitarët.

7 Në qoftë se, kjo është diçka mbi të cilën besohet nga
8 ZPS-ja dhe, në qoftë se kjo zbatohet për këtë procedurë,
9 atëherë i takon që i njëjti parashtrim do të duhet të bëhet në
10 emër të z. Gucati dhe z. Haradinaj, sepse unë personalisht nuk
11 e kam parë këtë parashtrim të protokolluar. Unë nuk e kam fare
12 idenë se çfarë thuhet në të. Kështu që, kjo qasje e ZPS-së
13 singerisht është simptomatike që duke iu referuar materialeve
14 ose duke u mbështetur në materiale të cilat nuk janë nxjerrë
15 për palët.

16 Mbase ZPS-ja mund të na ndihmojë për të na thënë nëse ata
17 mbështeten apo jo në këtë parashtrim të protokolluar dhe në
18 qoftë se ata mbështeten në të për çështje të kësaj procedure
19 apo jo dhe pastaj, mund të vazhdojmë me shtjellimet në varësi
20 të përgjigjes që do të marrim nga ZPS-ja.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

22 Nuk e di nëse ZPS-ja ka ndonjë përgjigje për pyetjet e
23 ngritura nga Mbrojtja. Atëherë, besoj se të gjithë e kemi
24 tejkaluar këtë afatin pesë minutash që përcaktuar në fillim.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Lidhur me atë çfarë

1 tha z. Rees, do të doja të thosha që çështjes së cilës ne ju
2 referuam, jepet në poshtëshënimin 4 të kërkesës. Dhe këto janë
3 dokumente të hapura. Kështu që nuk është e nevojshme që të
4 bëjmë parashtrime specifike për Mbrojtjen.

5 Pra, nuk ka ndalim në qoftë se miratohet kërkesa për të
6 përdorur emrat e dëshmitarëve tanë për hetimet e Mbrojtjes. As
7 nuk po kërkojmë ne që çdo gjë të diskutohet në seancë të
8 mbyllur. Ndërkohë ne kërkojmë që diskutimi, në fakt, në
9 seancat private të jetë sa më i kufizuar të jetë e mundur dhe
10 më pas të vijojmë, pra, ideja është që mundësisht ne të mos të
11 kalojmë fare në seancë me dyer të mbyllura.

12 Pra, kjo është diçka shumë diskrete që po e kërkojmë dhe
13 ky është pozicioni ynë dhe përgjigjja jonë që kishim për
14 Mbrojtjen.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Këto janë
16 pyetjet e mia.

17 Kam përshtypjet që z. Cadman do të flasë. Z. Cadman është
18 ngritur në këmbë.

19 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Cadman fjala për juve.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Më lejoni të bëj ca komente.
21 Sigurisht, që nuk është kuptimi im që mbështetur në aplikimin,
22 në kërkesën që ka bërë prokurori që, le të themi, identiteti i
23 dëshmitarëve të jetë i fshehur për dëshmitarët tanë.

24 Pra, ka aspekte të cilat ne duhet t'i bëjmë ose ka
25 aspekte që duhet t'i trajtojmë lidhur me këto dy dëshmitarë

1 dhe ka elementë që do duhet që t'i formulojmë apo t'i
2 trajtojmë me dëshmitarët tanë.

3 Pra, fakti që nxjerrja e identitetit të këtyre dy
4 dëshmitarëve të ZPS-së mund t'i bëhet, pra, mund të jetë diçka
5 e cila bëhet për, le të themi, dëshmitarët tanë atëherë e
6 gjithë kjo në vetvete rrezikon arsyen apo nuk është se
7 justifikon pozicionin e ZPS-së që kërkon nxjerrjen apo që
8 kërkon anonimitetin e këtyre dy personave.

9 Unë personalisht do ju kërkoja që palët të mund ta
10 flisnin këtë ndërmjet njëri-tjetrit sepse duket sikur ka
11 paqartësi apo keqkuptim ndërmjet jush lidhur me nivelin e
12 mbrojtjes që kërkohet për këta dy dëshmitarë.

13 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Atëherë vazhdojmë me ZPS-në.

14 Z. Gaynor dëshiron të bëjë ca pyetje lidhur me
15 përkufizimin e një dëshmitari.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Përpara se të kaloj tek kjo
17 temë, do të doja të bëja një pyetje për Prokurorinë lidhur me
18 Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Juve thatë që ka
19 disa vendime të GJEDNJ-së, të cilat kanë konstatuar që nuk ka
20 shkelje të nenit 6 të konventës në rastin kur oficerët e
21 policisë nuk janë identifikuar gjatë proceseve gjyqësore.

22 Dua t'ju pyes, në qoftë se juve pranoni, që ka shpesh një
23 dallim ndërmjet nivelit shtetëror kur flitet për dëshminë e
24 oficerëve në publik dhe dëshmime për aktivitetet sekrete dhe
25 të oficerëve të policisë të cilët nuk janë në aktivitete të

1 tilla. A mendoni që ka një dallim ndërmjet të dyve, të dy
2 situatave?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, kjo ka një
4 dallim këtu dhe sigurisht, që ne do ta cekim këtë temë pak më
5 vonë gjatë procedurave të sotme. Megjithatë sa i takon
6 Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut çështja, për të
7 cilën ne e kishim fjalën, është çështja që jepet në
8 poshtëshënimin 15 të kërkesave për provat e dhëna
9 drejtpërdrejtë për juve.

10 Pra, sigurisht, që ka një dallim në jurisprudencën e
11 GJEDNJ-së edhe ne jemi tek aspekti jo sekret, le të themi, i
12 analizës që bëtë juve.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shumë mirë. Atëherë, siç
14 udhëzohet në urdhrin e datës 21 korrik të panelit, ZPS-ja ka
15 parashtruar më datë 23 gusht parashtrimet në lidhje me këtë
16 përkufizim. Domethënë, kemi një listë të përkufizimit të
17 dëshmitarëve.

18 Kam një pyetje që ka të bëjë me elementin e statusit. Në
19 paragrafin 4 të parashtrimeve të ZPS-së parashikohet apo
20 thuhet që asnjë nga gjashtë krimet të cilat janë pjesë e
21 Aktpadisë për këtë çështje nuk kanë elementin e statusit që
22 sjellja e të akuzuarit duhet të lidhet me dikë që është
23 dëshmitar. Megjithatë është shpagimi, i cili është pika 4 e
24 Aktpadisë në nenin 388(1) të Kodit Penal të Kosovës, mund të
25 kryhet vetëm kundër një personi i cili e ka synimin kryesor që

1 të bëjë kërcënim për ofrimin e informacionit të vërtetë lidhur
2 me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale ndaj
3 policisë, një hetuesi të autorizuar, një prokurori ose një
4 gjyqtari.

5 ZPS-ja vëren në paragrafin 5, që në parashtrimet në
6 paragrafin 54, është bërë e qartë që kërcënimi sipas nenit
7 388(1) lidhet vetëm me një person i cili jep informacion për
8 Task Forcën e Posaçme Hetimore dhe/ose ZPS-në rreth çdo krimi
9 ose veprë penale që bien në juridiksionin e Dhomave të
10 Specializuara.

11 Ngjashëm, kërcënimi në nenin 387 të Kodit Penal lidhet jo
12 me çdo person, siç duket, sikurse sugjeron ZPS-ja në
13 paragrafin 5 të parashtrimeve të veta, por duket sikur lidhet,
14 siç tha Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në paragrafin 58 të
15 vendimit për konfirmimin ndaj çdo personi që bën ose që ka
16 gjasa për të bërë një deklaratë ose për të dhënë informacion
17 për një polic, një prokuror ose një gjyqtar.

18 Pra, persona të tillë duket sikur bien nën përkufizimin e
19 dëshmitarit të përshkruar nga ZPS-ja në paragrafin 3 të
20 parashtrimeve të gushtit, më 23 gusht. Tani pyetja ime për
21 ZPS-në është: A i qëndroni ende pozitës që pika 3 dhe 4 e
22 Aktakuzës në këtë çështje nuk ka elementin e statusit që
23 sjellja e të akuzuarit duhet të lidhet me dikë që është
24 viktimë?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Atëherë,

1 ne do të duam që të sjellim në vëmendjen tuaj poshtëshënimin
2 numër 8.

3 Atëherë Kodi Penal i Kosovës po bën një dallim sa i takon
4 këtyre krimeve që kanë të bëjnë me vepra penale kundër
5 administrimit të drejtësisë dhe ata përdorin termin
6 "dëshmitar" në disa prej këtyre krimeve dhe në disa prej tyre
7 jo. Ndërkohë që kur flasim për kërcënimin, flasim për persona
8 që bëjmë gjëra të caktuara dhe të cilët kërcënohen për këtë
9 arsye, por ndërkohë nuk përdoret fjala "dëshmitar".

10 Fakti që, fjala "dëshmitar" përdoret për gjëra në vende
11 të tjera, pra, ne është e rëndësishme që të përcaktojmë
12 përkufizimin e dëshmitarit dhe dikush, pra, mund t'i japë
13 informacion p.sh., Zyrës së Prokurorisë p.sh., që mund të jetë
14 një informator anonim dhe në fakt, ky nuk është pjesë e
15 elementit juridik të krimit.

16 Megjithatë, më lejoni të them, që ne e pranojmë faktin që
17 dëshmitarët janë ata njerëz të cilët do të kërcënohen dhe
18 zakonisht, do të jenë dëshmitarë siç i njohim ne në termin
19 klasik, pra, që do të jenë element i këtyre apo subjekt i
20 këtyre kërcënimeve.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

22 Mbrojtjes do t'i jepet mundësia të përgjigjet por, tani,
23 ndoshta është momenti për të bërë pushimin. Do t'ia lë
24 vendimin gjykatësit kryesues.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Rees, vazhdoni në qoftë se

1 nuk do të merrni shumë kohë.

2 Z. REES: [Përkthim] Po, do ta them shkurtimisht.

3 Shpjegimi që ka dhënë ZPS-ja, për atë se çfarë ajo mendon
4 se është "dëshmitar" apo si e interpreton termin "dëshmitar"
5 apo "dëshmitar i mundshëm potencial", dua të theksoj, se ne
6 gjatë këtij gjykimi do t'i shikojmë me hollësi elementët e çdo
7 shkeljeje që pretendohet, por thjesht, kërkoj nga ZPS-ja që të
8 na shpjegojnë se çfarë kanë parasysh me qasjen e tyre.

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë për këtë pikë do të flas kur të
10 diskutojmë elementet e krimeve.

11 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Atëherë ju faleminderit. Do
12 të bëjmë pushim për 30 minuta.

13 --- Pauza fillon në orën 11.07

14 --- Seanca rifillon në orën 11.36

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë!

16 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] E kam të qartë se është dita
17 e parë dhe nuk dini se çfarë të pritni nga ne, po ju lutem që
18 të jeni në sallën e gjyqit në kohën që e kemi caktuar.

19 Tani do të kalojmë tek pika e radhës nga rendi i ditës që
20 janë mocionet për paraqitjen e provave drejtpërdrejt Trupit
21 Gjykues d.m.th. jo nëpërmjet dëshmitarëve.

22 Fjalën në lidhje me këtë pikë ia jap kolegut tim
23 Gjykatësit Mettraux.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
25 Smith.

1 Në urdhrin e 21 korrikut të këtij viti ne ftuam ZPS-në që
2 të shqyrtonte mundësinë e dorëzimit të një mocioni për
3 dorëzimin e provave drejtpërdrejt Trupit Gjykses para datës 8
4 shtator dhe aty u përmendën 3 kategori të provave materiale të
5 propozuara, përkatësisht shënimet zyrtare të ZPS-së, artikujt
6 nga gazetatat në lidhje me të cilat autori nuk do të thërritet
7 për të dhënë dëshmi dhe postimet në Facebook që i atribuohen
8 të akuzuarve.

9 Ky hap u mor në mënyrë që të sigurohemi se të dy palët,
10 Mbrojtja dhe Prokuroria që të kenë një pasqyrë të qartë se
11 çfarë provash do të pranojë Trupi Gjykses apo nuk do të
12 pranojë Trupi Gjykses në mënyrë që t'i shmangemi çdo dëmtimi
13 që mund t'ju bëhet palëve apo procedurave.

14 Dje morëm një kërkesë nga Prokuroria për paraqitjen e
15 provave drejtpërdrejt Trupit Gjykses në lidhje me njëqind
16 prova materiale dhe do të filloj me disa pyetje për
17 Prokurorinë dhe pastaj do t'i drejtohem mbrojtjes.

18 Z. Halling në qoftë se ju do të përgjigjeni përsëri në
19 lidhje me këtë temë. Pyetja e parë ka të bëjë përsëri me masat
20 mbrojtëse. A keni ndërmend që të kërkon pranimin e këtyre
21 provave materiale të propozuara si diçka tjetër, pra jo si
22 prova publike materiale?

23 Z. HALLING: Po, i nderuar Gjykatës e kemi ndërmend ta
24 bëjmë këtë.

25 Pjesa e madhe e provave materiale janë klasifikuar nga

1 mënyra se si do të paraqiten ato prova. Shënimet zyrtare të
2 ZPS-së ku dokumentohen aktivitetet hetuese të paktën kanë
3 shënimin "konfidencial".

4 Ne e kemi parasysh se Trupi Gjykses e ka kompetencën që
5 të bëjë klasifikimin e provave ashtu sikur që e gjykon të
6 përshtatshme.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, faleminderit,
8 atëherë duket të them që t'i bëni gati parashtrimet me shkrim
9 në lidhje me këtë aspekt në mënyrë që ne të mund të marrim
10 vendimin e duhur në lidhje me pranueshmërinë e provave dhe me
11 miratimin apo mosmiratimin e masave që i kërkon për provat
12 materiale në fjalë.

13 Pyetja e dytë ka të bëjë me një pjesë të parashtrimit
14 tuaj, paragrafin 26 që lidhet me atë se çfarë thotë Mbrojtja
15 përkatësisht përdorimi joekskluziv i faqes të Facebook-ut.
16 Sipas Mbrojtjes kjo është më shumë çështje e peshës së asaj
17 prove dhe jo e pranueshmërisë. A i kemi kuptuar drejt këto
18 parashtrime të ZPS-së?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i keni kuptuar drejt i nderuar
20 Gjykatës. Për sa i përket pranueshmërisë ne kemi përcaktuar që
21 këto prova *prima facie* të kenë vlerë provuese. Në fund të
22 gjykimit mund të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm apo diçka
23 tjetër që lidhet me peshën e provës dhe që mund të gjykohet
24 ndryshe. Por në qoftë se pyetja e pranueshmërisë nuk duhet të
25 vihet fare në shqyrtim sepse bëhet fjalë për pranueshmëri

1 *prima facie* të materialeve pra të postimeve në Facebook edhe
2 gjykatësit në fund mund të marrin vendim në qoftë se ato
3 materiale kanë vlerë provuese ose jo.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ta testojmë këtë pohim që
5 e bëni ju. Të themi se ne do ta pranojmë qëndrimin e
6 Mbrojtjes, se faqet e Facebook-ut nuk kanë qenë të përdorura
7 ekskluzivisht prej tyre apo me dijeninë e tyre. Atëherë sipas
8 jush çfarë është relevanca, rëndësia e një materiali të tillë?
9 Sikurse thatë edhe ju kriteri i pranueshmërisë nuk është
10 ekzaktësisht identik me atë të provave të tjera.

11 Sa për të argumentuar pra, në qoftë se ne do ta pranojmë
12 parashtrimin e Mbrojtjes në lidhje me këtë pikë, atëherë sipas
13 jush, çfarë është rëndësia e një materiali të tillë për tezën
14 e prokurorisë?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Ashtu si e kuptoj unë pyetjen tuaj
16 i nderuar Gjykatës, n.q.s. Mbrojtja apo fakti që paraqet
17 Mbrojtja pranohet nga gjykatës se këto postime nuk janë
18 shkruar nga të akuzuarit, nuk ka në procesverbal asnjë provë
19 që këta, të akuzuarit i kanë fshirë ato postime apo nuk ju
20 kanë dhënë të drejtë të tjerëve që t'i shkruajnë ato.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju ndërpres këtu.
22 Ndoshta nuk isha i qartë. Të supozojmë se ju nuk jeni në
23 pozitë të vërtetoni faktet që i keni paraqitur, të themi se ju
24 nuk jeni në pozitë të vërtetoni se të akuzuarit kanë qenë në
25 dijeni për këto aktivitete që janë bërë nga faqet e tyre në

1 Facebook, atëherë në rrethana të tilla cila do të ishte

2 rëndësia e materialit për çështjen e Prokurorisë?

3 Z. HALLING: [Përkthim] N.q.s. përcaktohet se ekziston

4 dyshim i arsyeshëm që këto postime në Facebook nuk mund t'i

5 atribuohen të akuzuarve, atëherë hamendësoj se gjykatësit nuk

6 do të mund plotësisht të mbështeten në postimet e tilla si

7 prova.

8 Por duhet të paraqiten edhe prova rrethanore. Të

9 supozojmë ka një postim në Facebook që nuk i takon një personi

10 apo për të cilin një person nuk është përgjegjës dhe ka prova

11 të shumta të tjera që tregojnë se faktikisht ai postim është

12 shkruar në këtë rast nga z. Gucati apo nga z. Haradinaj apo me

13 lejen e tyre.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit z.

15 Halling, nuk do t'ju lodh shumë. Kam një pyetje të dytë në

16 lidhje me këtë mocion të Prokurorisë. Atë ju që e keni

17 ndryshuar emrin, e keni ndryshuar prapë nga "shënime zyrtare

18 të ZPS-së" në "shënime kontaktesh". Më ra në sy ky ndryshim i

19 terminologjisë por mua më intereson më shumë substanca apo

20 thelbi i këtyre dokumenteve. Në parashtimet tuaja, në

21 paragrafin 27, në lidhje me mocionin për paraqitjen e provave

22 drejtpërdrejt Trupit Gjykses ju thoni se këto dokumente lidhen

23 me dëshmitarët dhe ju pastaj thoni në vazhdim se në këto

24 shënime ka të dhëna në lidhje me atë se çfarë u kanë thënë

25 dëshmitarët zyrtarëve të zyrës së Prokurorisë dhe më tej ka

1 gjithashtu edhe pohime se këto shënime zyrtare nuk janë marrë
2 për qëllime të procedurave ligjore. Tani dua ta qartësoj këtë
3 pohim që e keni bërë.

4 Në paragrafin 27 të mocionit tuaj, ju thoni se këto
5 shënime janë rezultat i një nisme që kishte për qëllim të
6 siguronte mirëqenien dhe sigurinë e këtyre individëve. Tani të
7 supozojmë se personat me të cilët keni kontaktuar kanë
8 shprehur shqetësimet e tyre lidhur me sigurinë. Një nga hapat
9 që do të merrte në atë rast zyra juaj do të ishte kërkimi i
10 masave mbrojtëse në lidhje me një apo më shumë persona të
11 tillë në mënyrë që të trajtohet rreziku që del nga këto
12 rrethana. Atëherë, a është supozim i drejtë ky i imi se këto
13 janë pikërisht hapat që mund të merren nga zyra juaj?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Po, për rastet ku mbulohen këta
15 njerëz atëherë do të jenë kërkesat sipas rregullës 80. Sikurse
16 e kemi shpjeguar në mocionin tonë, këta dëshmitarë në rastin
17 Gucati dhe Haradinaj janë të ndryshëm. Kam parasysh shënimin
18 tuaj i nderuar Gjykatës, ne në këtë rast nuk do të kishim
19 kërkuar masa mbrojtëse në këtë lëndë sepse vetë klasifikimi
20 fillestar i provave për mendimin tonë mjafton.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë desha të theksoj diçka
22 tjetër. Faktikisht n.q.s. hetuesit apo prokurorët tuaj
23 thërrasin persona për të dhënë dëshmi të cilët ju informojnë
24 se e ndiejnë veten të rrezikuar apo kanë prova konkrete në
25 këtë drejtim, një nga hapat që ju do të merrnit në këtë rast

1 është kërkimi i masave mbrojtëse nga gjykata për këta
2 dëshmitarë. Pyetja ime është kjo: A është kjo e saktë në
3 kontekstin e procedurave ligjore?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Deklarata e dëshmitarit nuk është
5 marrë në kontekst të procedurave ligjore. Në qoftë se
6 përkufizimi që sugjerohet në pyetje përfshinte edhe procedurat
7 ligjore atëherë nuk do të ishte e mundur që të kontrollohej
8 mirëqenia apo siguria e dëshmitarit pa e marrë deklaratën prej
9 atij dëshmitari dhe kjo do të kishte ndikim si në masat
10 mbrojtëse ashtu edhe në nxjerrjen e materialeve provuese sepse
11 ne e kemi detyrimin e nxjerrjeve të deklaratave të të gjithë
12 dëshmitarëve tanë. Njerëzit që ngrenë çështjen e sigurisë
13 sipas mendimit tonë janë pjesë e procedurave ligjore.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj se aspekti i
15 ndjeshëm i parashtrimeve tua është *stricto sensu* në qoftë se
16 qëllimi është për t'u bërë një vlerësim i rrezikut, që është e
17 mundshme, pasojat e një veprimi të tillë do të ishin
18 potencialisht procedura ligjore.

19 Do tua lë që këtë aspekt ta shqyrtoni edhe më tej. Në
20 paragrafin 32 të mocionit tuaj ju thoni: "këto materiale janë
21 tregues provues se sjellja dhe veprimet e të akuzuarve ishin
22 frikësuese apo hakmarrëse në kuptim të këtyre krimeve". Këtyre
23 krimeve bëhet fjalë faktikisht për krimet që iu ngarkohen dy
24 të akuzuarve. Tani mesa i kam kuptuar këto parashtrime në
25 fjalët e tua dhe në parashtrimin tuaj, informacioni që

1 mblidhej nga këta individë -- ju nga ky informacion faktikisht
2 ndërgjegjësoheni për krimet e mundshme apo kryerjen e mundshme
3 të krimeve brenda juridiksionit tuaj. A është ky presupozim i
4 saktë?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se shikoni vendimin e
6 Gjykatësit të procedurës paraprake sipas të cilit miratohet
7 mosnxjerrja e materialeve të këtilla, masat kompensuese që u
8 urdhëruan ishin që këto shënime zyrtare t'i jepen Mbrojtjes.
9 Pra, në atë pikë të procedurës, ne nuk planifikonim përdorimin
10 e tyre në procedura sepse pjesa më e madhe e tyre iu nxorën
11 Mbrojtjes si rezultat i vendimit të Gjykatësit të procedurës
12 paraprake. Mirëpo karakteri i shënimeve zyrtare nuk kishte të
13 bënte me qëllimin e procedurave ligjore, ishte për qëllimin e
14 identifikuar në kërkesë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po e çoj pak në një nivel
16 tjetër pyetjen. Supozojmë se bëni një gjë për një qëllim të
17 caktuar dhe ju mblidhni informacion në lidhje me atë gjë dhe
18 gjatë kësaj informoheni për kryerje të mundshme të një krimi
19 që është brenda kompetencave dhe juridiksionit të kësaj
20 gjykate. Këto janë në thelb parashtimet tuaja.

21 Tani në atë fazë, a kërkojmë diçka që mund të
22 kualifikohet si procedurë ligjore apo vazhdoni të pohoni se
23 duhet të kthehemi mbrapa dhe ta zëmë atë si një qëllim
24 fillestar që e keni pasur gjatë marrjes së atyre shënimeve?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Ne parashtrojmë se duhet të bëhet

1 një vlerësim i përgjithshëm për të marrë një vendim në këtë
2 drejtim. Se çfarë janë procedura ligjore është një term,
3 nocion më vete në këtë kontekst. Rregulli 153 dhe 155 bazohen
4 në rregulloret e tribunalëve ndërkombëtarë. Kemi raste të
5 shumta nga jurisprudenca ku janë pranuar shënime zyrtare si
6 prova materiale drejtpërdrejt përmes Trupit Gjykses dhe këto
7 janë pranuar në kontekst më diskrecional dhe ne argumentojmë
8 këtu pikërisht atë aspekt më diskrecional brenda kuptimit të
9 rregullës 153 deri në 155.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam pyetje dhe për
11 Mbrojtjen në qoftë se nuk keni asgjë kundër.

12 Prej ju z. Cadman kërkoj një sqarim në lidhje me diçka që
13 nuk është plotësisht e qartë të paktën për mua nga
14 parashtrimet që keni bërë me shkrim. Pyetja ime është si
15 vijon: Në parashtrimet tua ju flisni për një mocion që në
16 atë kohë ishte i mundshëm i Mbrojtjes për paraqitjen e provave
17 drejtpërdrejt përmes Trupit Gjykses dhe ju e kundërshtoni
18 kategorikisht paraqitjen e mocioneve të tilla.

19 Nga ju dua të di n.q.s. qëndrimi juaj sipas ligjit është
20 se ky Trup Gjykses nuk lejohet të nxjerrë vendim apo thoni
21 diçka tjetër se gjatë ushtrimit të kompetencave tona nuk duhet
22 të pranojmë provat që i paraqiten drejtpërdrejt Trupit Gjykses
23 jo përmes dëshmitarëve. E kam kuptuar drejt parashtrimin tuaj.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

25 Qëndrimi i juaj i dytë që paraqitet, ne nuk themi që

1 Trupi Gjykses nuk ka të drejtë të nxjerrë vendime mbi mocione
2 të tilla, por se duhet të ushtrojë kompetencat e veta në
3 mënyrë të kufizuar për mocionet e tilla. Ne, duke mbajtur
4 parasysh të drejtën për t'iu përgjigjur këtyre mocioneve
5 brenda 10 ditëve, në ato parashtrime ne kemi thënë se
6 paraqitja e provave drejtpërdrejt përmes Trupit Gjykses nuk
7 duhet të përdoret si mënyrë për të anashkaluar procedurat e
8 rregullta të paraqitjes së provave.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit z. Cadman.
10 Qëndroni në këmbë nëse mundeni. Kam edhe disa pyetje.

11 Padyshim që mundeni edhe të përgjigjeni me shkrim dhe
12 mund të përgjigjeni edhe gojarisht tani. Keni thënë më parë
13 dhe tani ndoshta e keni ndryshuar qëndrimin duke marrë
14 parasysh parashtrimet e Prokurorisë që i keni bërë para. Ju
15 keni sugjeruar që shqyrtimi i një kërkesë të tillë,
16 domosdoshmërisht dhe pashmangërisht do të shkaktonte një
17 paragjykim.

18 Pyetja ime përsëri është: A duhet kjo të shqyrtohet në
19 kontekstin e këtyre paragjykimeve apo dëmtimeve që i paraqitni
20 dhe për cilin paragjykim apo dëmtim e keni konkretisht fjalën?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar gjykatës, ne jemi dakord
22 me ju lidhur me qëndrimin që parashikohet duke mos ditur në
23 fakt me saktësi parametrat e kërkesës që do të paraqitet në
24 këtë pikë.

25 Kjo është e gjitha që mund të them, në momentin që do të

1 marrim kërkesën, faktikisht kërkesën, - më falni - e kemi
2 marrë, e kemi marrë dje, por duhet që ta shqyrtojmë atë dhe
3 pastaj do të paraqesim qëndrimin tonë.

4 Qëndrimi që ne kemi bërë, që kemi mbajtur deri tani është
5 që materiali ka shqetësime shumë reale lidhur me sasinë e
6 materialit që do të përfshihet dhe me mundësinë që do të na
7 jepet, më saktë që nuk do ta kemi për të kundërshtuar
8 autenticitetin e këtij materiali, mungesën e zinxhirit të
9 kujdestarisë të mbajtjes pra të këtyre provave.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sigurisht ne e presim
11 elokuencën nga ju z. Cadman po për t'ju qetësuar, ju thatë në
12 këtë moment është që shqetësimi më i madh nga sa duhej, por
13 sigurisht nëse do të duhet që të mbështesnim kërkesën e
14 Prokurorisë në tërësi të paktën për një pjesë të materialit,
15 që Prokuroria pra po përpiqet që ta paraqesë në këtë mënyrë,
16 sigurisht ne do të trajtojmë çdo provë veçmas që do të
17 propozohet. Pra, nëse janë këto shqetësimet tua që janë
18 legjitime lidhur me një provë të veçantë që propozohet, duhet
19 që të përmendej në parashtrimet tua elokuente dhe sigurisht
20 që do t'i jepet mundësia dhe z. Rees që të dëgjohet për këtë.

21 Z. Rees, fjala është për ju.

22 MR. REES: [Përkthim] Unë nuk garantoj një elokuencë të
23 barasvlershme por unë do të bëj çmos. Duke pasur parasysh
24 gjatësinë e këtyre shtojcave, ne do të përgjigjemi në momentin
25 e duhur.

1 Hë për hë ne mbështesim nxjerrjen e një vendimi sa i
2 takon pranueshmërisë së kërkesës së Prokurorisë në thelb
3 përpara se të hapet paraqitja e provave nga prokuroria. Ne
4 mbështesim edhe argumentet e shprehura gojarisht për këtë
5 çështje por kur të kemi mundësinë që të reflektojmë me hollësi
6 për këtë kërkesë do t'i përgjigjemi me shkrim Trupit Gjykues
7 përpara se t'i shprehim më të zgjeruara gojarisht.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, këto ishin
9 pyetjet e mia. Fjala konciz është po aq e rëndësishme sa edhe
10 angazhimi i z. Cadman për parashtrimet e veta, po kështu edhe
11 si për z. Rees.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Kalojmë tani në parashtrimet
13 me shkrim që ka kërkuar Mbrojtja. Pika e parë që duhet të
14 trajtojmë këtu ka të bëjë me parashtrimet e Mbrojtjes lidhur
15 me shtytjen apo inkurajimin. Përpara kësaj do të jap një
16 urdhër gojarisht. Trupi Gjykues vëren vendimin që ka nxjerrë
17 paneli i Gjykatës së Apelit i datës 29 korrik 2021, ku
18 konstaton se Mbrojtja është privuar, më falni, nga hapi i parë
19 i Rregullës 102(3) që është mundësia për të informuar për
20 materialin që ka në zotërim ZPS-ja lidhur me procesin përmes
21 materialit që pretendohet të jetë konfidencial që ka mbërritur
22 në mjediset e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së,
23 dhe që Gjykatësi i procedurës paraprahe ka gabuar në
24 konstatimin e vet për këtë çështje dhe se ZPS-ja duhet ta
25 kishte përfshirë këtë material që ka në zotërim që bën pjesë

1 në objektin e kërkesave b deri c të Gucatit sipas Njoftimit
2 102(3).

3 Në bazë të këtij vendimi, Trupi Gjykses: Urdhëron ZPS-në
4 që të dorëzojë një listë të përditësuar të Rregullës 102(3)
5 brenda datës 6 shtator 2021; Urdhëron Mbrojtjen që t'i bëjë
6 ditur ZPS-së brenda datës 9 shtator 2021 apo edhe më herët, se
7 cilat pika të kësaj liste të njoftimit të përditësuar të
8 hollësishëm ato kërkojnë që të kenë akses përmes nxjerrjes apo
9 konsultimit; Urdhëron ZPS-në që t'i drejtohet Trupit Gjykses
10 brenda datës 15 shtator 2021, për arsyet, nëse kanë të tilla
11 që kundërshtojnë materialitetin e provave apo të kërkesave për
12 mosnxjerrje; Urdhëron Mbrojtjen që të përgjigjet nëse dëshiron
13 brenda datës 20 shtator dhe urdhëron ZPS-në që t'i nxjerrë
14 Mbrojtjes materialin e kërkuar brenda datës 15 shtator. Këtu
15 mbyllet urdhri i dhënë gojarisht. Tani ia jap fjalën kolegut,
16 Gjykatësit Gaynor, për të bërë disa pyetje për këtë temë.

17 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund ta marr
18 fjalën përpara këtyre pyetjeve? Për sa i takon urdhrin të
19 dhënë gojarisht, ZPS-ja është e qëndrimit se përditësimi i
20 njoftimit sipas rregullës 102(3) në mënyrën sesi e përshkruani
21 ju, do të kërkonte nxjerrjen e informacioneve që janë në
22 objektin e masave mbrojtëse. Në fakt është në objektin, - më
23 falni -, e dosjes informuese për këtë çështje që t'i dorëzohet
24 një kërkesë Dhomës, konfidenciale dhe ex parte për këtë qëllim
25 me kohë të mjaftueshme për të vendosur për këtë lidhur nëse, a

1 do të veprohet kështu apo jo.

2 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do ta ndryshojmë urdhrin e
3 dhënë gojarisht ose sot më vonë ose nesër për t'ju dhënë një
4 përgjigje ndaj kërkesës tuaj.

5 Fjala për kolegun tim Gjykatësin Gaynor.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit i nderuar
7 Kryetar.

8 Në urdhrin e datës 21 korrik, Trupi Gjykses ka udhëzuar
9 Mbrojtjen që të dorëzojë parashtime të tjera shtesë lidhur me
10 temën e shtytjes për kryerje të krimit. ZPS-ja është urdhëruar
11 që të japë përgjigje gojarisht gjatë kësaj seance. Fjala është
12 për Prokurorinë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Është qëndrimi i Prokurorisë se
14 nuk ka një bazë ligjore apo faktike që të përdoret nga
15 Mbrojtja për shtytje apo inkurajim për kryerje të krimit.
16 Çështjet gjyqësore të cilat i ka përmendur Mbrojtja kërkojnë
17 dy elementë për të konstatuar shtytjen, që janë: së pari,
18 është një person zyrtar i cili vepron; e dyta që ky veprim
19 duhet të ushtrojë presion mbi personin që të kryejë një
20 veprim, që ta nxisë pra që të kryejë një vepër penale.
21 Mbrojtja nuk jep prova që do të çonin në një konstatim të
22 tillë. Atë që thotë Mbrojtja është vetëm një çështje e
23 Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që citohet në
24 paragrafin 17 në parashtimet e Mbrojtjes së Gucatit. Këtu
25 s'kemi të bëjmë me operacion të infiltëruar. Çështje të tjera

1 si "Ramanauskas" kanë të bëjnë me kryerjen e punës policore me
2 operacionet e infilttruara.

3 Nuk ka prova se kemi pasur një veprim të tillë zyrtar në
4 rastin që kemi ne. Pra, nuk ka prova se një zyrtar i ZPS-së ka
5 qenë i përfshirë në dorëzimin e paketave që janë objekt i
6 kësaj çështjeje gjyqësore. Të akuzuarit e kanë pranuar se
7 ata i kanë marrë këto paketa, por nuk e dinë se kush i ka
8 dorëzuar ato. Nuk ka pasur mundësi që një zyrtar, që një
9 person zyrtar të ketë ndërvepruar me të akuzuarit apo të ketë
10 pasur mundësi që t'i nxisin apo t'i shtyjnë këta që të kryejnë
11 këto krime.

12 Në fakt provat tona tregojnë të kundërtën, ZPS-ja nxori,
13 pra kërkoi nxjerrjen e një urdhri gjyqësor pas datës 7 shtator
14 2020, nxjerrjen e dokumenteve atëherë dhe materialet u
15 sekuestruan në datën 8 shtator. E njëjta gjë edhe me paketat e
16 tjera. Të akuzuarit nuk kanë thënë kurrë se i ka shtyrë dikush
17 apo i ka inkurajuar dikush që të kryejnë këtë vepër penale.
18 Ata mbështeten vetëm tek pretendimi lidhur me hetimin e ZPS-së
19 dhe në teori të rreme dhe të fantazuara lidhur me fabrikimin e
20 krimeve kundër të akuzuarve për provat. Në të kundërt tregojnë
21 se të akuzuarit i kanë kryer këto krime në mënyrë të
22 përsëritur dhe me entuziazëm. Ata e kishin mundësinë që të na
23 e kthenin materialin e ZPS-së përpara dhe të mos ia jepnin
24 shtypit, mediave.

25 Ata u informuan përmes urdhrave gjyqësorë që të mos bënin

1 këto shkelje, ata vijuan që t'i bëjnë këto shkelje. Ata ia
2 nxorën mediave në çdo rast të mundur. Ata e mirëpritën
3 dorëzimin e këtyre paketave. Ata premtuan që të publikojnë
4 edhe materiale të tjera. Ata donin të destabilizonin Dhomat e
5 Specializuara të Kosovës dhe shfrytëzuan të gjitha rastet e
6 mundshme. Pra, nuk janë ndikuar nga, për të mos thënë dhe as
7 nuk janë shtyrë nga askush.

8 Mbrotjtja nuk mund që të vërtetojë mbi *pragun prima facie*
9 që të justifikojë nxjerrjen e këtyre çështjeve. Mbrotjtja nuk
10 mund ta ndryshojë objektin e këtij gjykimi në themel të tij.
11 Për ta mbyllur ZPS-ja thotë se synon që të dorëzojë një mocion
12 për të kundërshtuar dëshmitarët e mbrotjtjes dhe një pjesë të
13 dëshmisë të dëshmitarit të Mbrotjtjes që nuk kanë lidhje me
14 gjykimin, kjo përfshin edhe dëshmi lidhur me mangësitë e
15 pretenduara në hetimin e ZPS-së apo presion të pretenduar
16 politik nga EULEX-i lidhur me Dhomat e Specializuara.

17 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Tani kam pyetje
18 për Mbrotjtjen. Mbrotjtja ka përshkruar në dosjen paraprake
19 faktorë të ndryshëm në mbështetje të argumentit që do të ishte
20 e arsyeshme që Trupi Gjykses të deduktonte ekzistencën e një
21 përpjekjeje të bërë me dashje për t'i shtyrë të akuzuarit për
22 të kryer krimin.

23 A pranoni së pari z. Rees, që mbrotjtja e mban barrën e
24 provës për konstatimin në *prima facie*, sa i takon shtytjes apo
25 inkurajimit për të bërë krimin?

1 Z. REES: [Përkthim] Jo, i nderuar z. Gjykatës.

2 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Cadman?

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Bashkërisht të dyja ekipet e
4 Mbrojtjes jemi shprehur për qëndrimin tonë që nuk e pranojmë
5 këtë.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Rees, në parashtimin e
7 datës 27 gusht ju keni përshkruar, ju i jeni referuar
8 jurisprudencës së GJEDNJ-së në lidhje me evidencën për
9 shtytjen e krimit, ku në këtë rast inkurajimi vjen nga një
10 agjent i shtetit apo nga një palë private që ka vepruar me
11 urdhër apo udhëzime të agjentit të shtetit. Pyetja që kam unë
12 është kjo: Ju a e konsideroni inkurajimin nga një person i
13 tillë që nuk vepron nën udhëzimet apo në kontrollin e një
14 agjenti shtetëror që të përbëjë shtytje për kryerje të krimit?

15 Z. REES: [Përkthim] Ne kemi thënë se pranojmë që një
16 pjesë thelbësore e inkurajimit nga policia, nëse do të thoshim
17 kështu, është që të konstatohet përfshirja e një agjencie
18 hetimore. A do mund të jetë kjo drejtpërdrejt apo jo përmes
19 një zyrtari të veçantë, a përfshin kjo apo jo aprovimin e
20 dhënë nga nivele drejtuese të kësaj agjencie hetimore, kjo
21 është tjetër gjë. Por dua që të vijë nga një farë agjencie
22 faktikisht hetimore, siç është Prokuroria.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit! Në mënyrë
24 analoge a mendoni se inkurajimi apo shtytja për kryerje të
25 krimit nga ana e një personi që nuk vepron nën udhëzimet e

1 ZPS-së përbën shtytje apo inkurajim për kryerje të krimit?

2 Z. REES: [Përkthim] Unë do ta shprehja këtë me rezerva
3 duke thënë edhe njëherë të njëjtin argument, që nuk do të
4 kërkonte le të themi, asnjë pjesë të jurisprudencës që ne kemi
5 parë nga GJEDNJ-ja, për shembull ku autoriteti i një
6 organizate në tërësi, përfaqësuar nga një anëtar i lartë i
7 kësaj organizate do të duhej që të vërtetohet që a ka luajtur
8 apo jo rol në këtë inkurajim. Mjafton që për shembull të
9 vërtetohet që një agjent, një punonjës i ZPS-së ka vepruar pa
10 zbatuar urdhrat, pra në kundërshtim me urdhrat, pra pa e ditur
11 drejtuesit e tjerë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund t'ju pyes a keni
13 ndonjë jurisprudence konkrete nga GJEDNJ-ja për të mbështetur
14 këtë që thoni?

15 Z. REES: [Përkthim] Po. I jam referuar "Ramanauskas".
16 Mund t'ju asistoj më tej duke identifikuar autoritetin
17 përkatës për këtë sugjerim, por përcaktohet më tej në
18 jurisprudencën e Gjykatës Evropiane.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Që një agjent ka vepruar në
20 kundërshtim me urdhrat apo jo në zbatim të urdhreve?

21 Z. REES: [Përkthim] Po, mjafton që të vërtetohet kjo gjë.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Trupi Gjykses do ju lutej që
23 të na jepnit numrin e jurisprudencës.

24 Z. REES: [Përkthim] Patjetër.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua që të pyes të dyja

1 ekipet e Mbrojtjes. A keni juve ndonjë provë që sugjeron që
2 ndonjë ish-anëtar i ZPS-së apo ndonjë palë private që ka
3 vepruar nën udhëzimet apo në kontrollin e ZPS-së ia ka
4 dorëzuar materialin përkatës Organizatës së Veteranëve?

5 Z. REES: [Përkthim] Po, ne themi se ka prova, provat i
6 jepen në formë të përmbledhur në paragrafin 20(c) të
7 parashtimit tonë të datës 27 gusht, 2021. Janë prova
8 rrethanore, të cilat, gjithsesi janë prova. Sigurisht duhet
9 bërë dallimi midis provës së drejtpërdrejtë dhe provave
10 rrethanore, është një provë që ne synojmë ta përdorim. Në
11 paragrafin 20(c) e tutje ne themi që mund të deduktohet se
12 duhet të ketë pasur përfshirje të një zyrtari të ZPS-së në
13 procesin, përmes të cilit janë dorëzuar këto paketa
14 Organizatës zyrtare të Luftës së UÇK-së?

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Z. Cadman,
16 keni gjë për të thënë?

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë dëshiroj të mbështes qëndrimin
18 e shprehur nga z. Rees pa dashur që të shprehim të gjitha
19 provat tona që tani, por sigurisht ne do të përdorim prova siç
20 i përshkroi z. Rees. Si sa i takon provave rrethanore ashtu
21 edhe deduktive që mund të bëhen, të cilat kanë çuar në
22 mosfunksionim siç duhet të Zyrës së Prokurorit të Specializuar
23 që mund të çojnë në përfundimin se duhet të ketë pasur
24 përfshirje nga ana e Zyrës së Prokurorit të Specializuar,
25 qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi dhe do të përdorim prova

1 për këtë.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Kam dy pyetje
3 për ZPS-në. I kemi lexuar me shumë kujdes parashtimet tuaja.
4 A është qëndrimi juaj që nuk keni asnjë informacion në
5 zotërim, i cili do të ishte me rëndësi për argumentin se
6 ndonjë anëtar i tanishëm apo i mëparshëm i ZPS-së apo ndonjë
7 palë private që ka vepruar nën udhëzimet apo në kontrollin e
8 ZPS-së ta ketë dorëzuar materialin në fjalë në Organizatën e
9 Veteranëve?

10 Z. HALLING: [Përkthim] E saktë. Edhe më parë e kemi bërë
11 këtë parashtim. Po të kishte prova për këtë, nuk do të kishte
12 nevojë që të përzgjidhej nga Mbrojtja sipas rregullës 102(3)
13 sepse do të ishte objekt i rregullës 103 sipas mendimit tënd
14 kjo do të ishte një provë shfajësuese. Pra, jo vetëm që nuk ka
15 një provë të tillë, por edhe nuk e kemi, -- se po ta kishim,
16 do ta kishim nxjerrë, - më falni.

17 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Gjykatësi Mettraux ka pyetje.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit! Z. Rees, unë
19 mendoj që i jeni përgjigjur kësaj pyetjeje, por do jua bëj
20 gjithsesi. Po njësoj si në rastin e mbrojtjes së z. Haradinaj,
21 a e pranoni edhe ju se identiteti i zyrtarit nga Task-Forca
22 apo nga ZPS-ja, të cilit sipas ekipeve të Mbrojtjes ka marrë
23 pjesë në shtytjen e pretenduar për kryerjen e krimit apo
24 inkurajimin, pra është i paditur?

25 Ta them ndryshe, ju nuk jeni në dijeni të identitetit të

1 këtij personi, nuk dini se kush mund të jetë ky person që
2 pretendoni se është, a e kam kuptuar saktë?

3 Z. REES: [Përkthim] Në bazë të informacioneve që kemi
4 tani dhe këtu dua të falënderoj Trupin Gjykses për urdhrin e
5 dhënë gojarisht më përpara, është që Prokuroria nuk ka
6 respektuar detyrimet e nxjerrjes.

7 Etapa e parë e procesit...

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem t'ju ndërpres, ta
9 lëmë mënjane procesin e nxjerrjes së materialeve për një çast.
10 Dua t'i kthehem pyetjes time dhe nuk e di nëse mund t'ju bëj
11 të dyja pyetjet njëkohësisht. Pra, ju nuk po propozoni që të
12 identifikoni ndonjë individ të caktuar në kuadër të provave
13 tuaja siç i kupton Trupi Gjykses, ju kërkoni që Trupi Gjykses
14 të deduktojë, pra të nxjerrë, të bëjë një deduktim në bazë të
15 paragrafit, më falni 20 (c), që ju e përmendët pak më përpara,
16 do të mund të bëjë një deduktim se ka ndodhur shtytje për
17 kryerje të krimit apo të paktën se Prokuroria nuk ka arritur
18 që të dëshmojë se ka qenë e arsyeshme.

19 Z. REES: [Përkthim] Identiteti i personave që kanë bërë
20 dorëzimin e këtyre paketave nuk është i ditur.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, personi sipas
22 versionit që ju ia dhatë kolegut tim Gjykatësit Gaynor do të
23 ishte që prova juaj, argumentimi juaj do të ishte i tërthortë
24 për shtytje për kryerje të krimit. Pra, me fjalë të tjera ju
25 nuk propozoni identifikimin e këtij personi.

1 Z. REES: [Përkthim] Nuk propozojmë se nuk mundemi, nuk e
2 dimë, nuk e njohim, prandaj edhe e kemi kërkuar nxjerrjen e
3 materialit, i cili është i rëndësishëm dhe që duhet të ishte
4 pjesë e listës së njoftimit të rregullës 102(3). Kur ta marrim
5 këtë njoftim të ndryshuar të rregullës 102(3), atëherë do të
6 bëjmë kërkesa për nxjerrjen e materialit, siç të jenë të
7 përshtatshme. Por edhe njëherë e përsëris, unë nuk mendoj se
8 jurisprudenca e GJEDNJ-së kërkon identifikimin e zyrtarit apo
9 oficerit të përfshirë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk është ky sugjerimi.
11 Tani kam një sërë pikash për të cilat kërkoj sqarim nga ju z.
12 Cadman. Kam lexuar parashtimet tuaja, kështu që nuk është
13 nevoja që të përsërisni ato që keni shkruar aty. Ka një sërë
14 çështjesh që ngrihen aty ose mbase nuk kanë qenë të qarta, por
15 në paragrafin 30 të parashtimit tuaj, ju sugjeroni se Trupi
16 Gjykses ju kërkon që të justifikoni pretendimin që ju ngrini
17 për shtytje në kryerje të krimit.

18 Në fakt nuk ka qenë ky synimi im, nuk është ajo që ju
19 kemi kërkuar. Ne ju kemi kërkuar edhe ajo që ju kërkojmë tani
20 është diçka disi ndryshe. Ka të bëjë me bazën ligjore në të
21 cilën ju mbështeteni sa i takon pretendimit për shtytje në
22 kryerje të krimit. Thjesht dua që t'u sqaroj se çfarë kërkohet
23 nga ju. Në disa juridiksione ne jemi në dijeni se nuk ekziston
24 nacioni i pistës së mbrojtjes së shtytjes të kryerje të
25 krimit, në disa juridiksione të tjera ekziston. Pastaj ka edhe

1 disa juridiksione kombëtare, kur mund të përbënte për
2 shembull, arsye për përjashtim të provave apo se mund të ishte
3 një faktor zbutës siç është rasti i Zvicrës, fjala bie.

4 Nëse do të konstatohej se ka ndodhur vërtet shtytja për
5 kryerje të krimit. Ajo që dua të di në mënyrë specifike nga ju
6 është se cila është baza ligjore?

7 Ky Trup Gjykses, pra ne si Trup Gjykses, ku ta kërkojmë
8 bazën ligjore, të cilën ju na kërkon neve të mbështetemi që
9 t'ju lejojmë juve të përdorni pistën e mbrojtjes të shtytjes
10 së kryerjes së krimit?

11 Përpara se të përgjigjeni mund t'ju tërheq vëmendjen për
12 nenin 12 të ligjit, ku thuhet se ligji që zbatohet për këtë
13 procedurë është e drejta materiale që është e drejta penale e
14 brendshme e Kosovës, për aq sa shprehimisht është e zbatueshme
15 në këtë juridiksion apo e drejta zakonore ndërkombëtare.

16 Prandaj, pyetja që kam për ju është, ku duhet ta kërkojë
17 ky Trup Gjykses nocionin e shtytjes në kryerje të veprës
18 penale dhe që do të ishte dhe e zbatueshme për këtë procedurë?

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Është e qartë që unë e paskam
20 keqkuptuar pyetjen e bërë fillimisht, siç del qartë edhe nga
21 përgjigjja jonë në paragrafin 30, por ne kështu e kishim
22 kuptuar urdhrin tuaj, siç e bëri të qartë. I nderuar Gjykatës,
23 ka një sërë juridiksionesh të ndryshme, ku Mbrojtja mund të
24 përdorë disa pista të ndryshme, mund të jetë për shembull
25 abuzimi i procesit apo tek pavlefshmëria e procesit sikurse u

1 tha mund të përdoret edhe si faktor zbutës apo përjashtim të
2 provave.

3 Vështirësia që ne kemi këtu është se ne nuk kemi një
4 kornizë të qartë ligjore për këtë institucion. Unë ende nuk e
5 kam të qartë d.m.th. nëse zbatohen apo jo përkatësisht të
6 gjitha ligjet penale të Republikës së Kosovës. Ajo që ne kemi
7 shprehur është që duhet që Gjykata duhet që të konstatojë se
8 deri ku mund të përdoret pista mbrojtëse që ne mund të
9 paraqesim dhe cilat mund të jenë masat, rrugët ligjore që
10 duhet të ndjekim. Ne ende nuk kemi thënë se cila do të ishte
11 kjo rrugë ligjore që do të ndjekim, por është gjithsesi kjo
12 pistë e mbrojtjes që ne kërkojmë ta përdorim, njihet nga
13 juriprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

14 Por sigurisht ne ende nuk e kemi shprehur hë për hë sepse
15 do ta ngremë si çështje gjatë procesit të gjyimit, për të
16 parë pastaj nëse ne do të jemi në gjendje që të përmbushim
17 barrën tonë apo dhe Prokuroria do të jetë në gjendje që të
18 përmbushë barrën e vet. Por hë për hë, ne ende nuk kemi
19 shpjeguar se cila do të jetë rruga që do të ndjekim.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më duket se nuk na
21 përmendët ende bazën ligjore. Ju lutem të mendoni këtë aspekt
22 sepse sigurisht që duhet të ketë një bazë ligjore diku. Dhe
23 mbase mund të mbani parasysh edhe argumentet e kolegut tuaj z.
24 Rees, për të parë nëse ato përputhen apo jo me qëndrimin tuaj
25 sepse unë, ne i shikojmë disi të ndryshme qëndrimet tua.

1 Por gjithsesi unë sot ose në një moment tjetër që do të
2 vendosni ju vetë për të bërë parashtrime, do t'ju bëj pyetje
3 edhe lidhur me elementet e pistës së propozuar të Mbrojtjes të
4 shtytjes në kryerje të krimit me qëllim që të sigurojmë që ky
5 Trup Gjykues ta ketë të qartë nëse do të kishte apo jo një
6 bazë ligjore tek e cila do të mbështetej dhe e cila do të
7 ishin elementet e kësaj piste të mbrojtjes, sepse janë këta
8 elemente që ndryshojnë shumë nga një juridiksion te tjetri.

9 Dhe në Paragrafin 34 të parashtrimeve tua, ju jepni një
10 përgjigje të tillë që kriteret dhe kushtet që janë të
11 zbatueshme për një pistë të tillë mbrojtjeje në kuadrin ligjor
12 të Gjykatës së Specializuar janë pikërisht ato të cilët janë
13 të zbatueshme në një kontekst të brendshëm ku pista e shtytjes
14 në kryerje të krimit njihet si një pistë legjitime, prandaj
15 duhet të pranohet edhe nga Dhomat e Specializuara.

16 Z. Cadman, unë ende nuk e kam të qartë se cila është
17 baza ligjore, të cilat ju pretendoni se e rregullon argumentin
18 e shtytjes. Unë nuk dua t'ju vë në vështirësi tani, por nëse
19 dëshironi që të na e thoni tani, ju lutem na e thoni tani, por
20 nëse doni që ta mendoni më vonë edhe këtë do ta mirëkuptonim.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Duke qenë se më keni dhënë kohë që
22 të përgjigjem plotësisht, unë do ta shfrytëzoj këtë mundësi.
23 Unë mund ta bëj më vonë, sot ose nesër do të përgjigjem në atë
24 moment.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, mund t'jua japim këtë

1 kohë Z. Cadman, për të vendosur se cili është qëndrimi juaj
2 strategjik. Thjesht duhet ta keni të qartë që Trupi Gjykses
3 duhet asistuar përmes përcaktimit të bazës ligjore në të cilën
4 mbështetet argumenti juaj, në mënyrë që të shqyrtojmë këtë
5 pjesë të provave tuaja.

6 Z. Rees dua t'ju jap mundësinë që të komentoni për
7 çfarëdolloj gjëje që u tha tani. Por kam edhe unë një pyetje
8 që e kam për të dyja ekipet e Mbrojtjes. Siç e kam kuptuar unë
9 të paktën është sugjerimi se e ashtuquajtura pistë e
10 mbrojtjes, e shtytjes apo inkurajimit për kryerje të veprës
11 penale, pavarësisht nga termi që përdoret do të kishte lidhje
12 të paktën për këtë Trup Gjykses nëse do të përmbusheshin një
13 ose më shumë prej kriterëve të krimeve për të cilat akuzohet
14 klienti juaj dhe klienti i z. Cadman. A është ky supozimi i
15 saktë ligjor?

16 Z. REES: [Përkthim] Po, z. Gucati ka ngritur argumente
17 mbrojtëse të rëndësishme lidhur me secilën prej akuzave. Ai
18 mbështetet në paraqitjen e argumentit të inkurajimit nëse
19 Trupi Gjykses vendos kundër tij për secilën prej këtyre
20 akuzave.

21 Nëse do të ishte me dobi parashtrimi ynë, është se pista
22 e inkurajimit do të ishte një çështje e cila duhet gjykuar
23 gjatë gjyimit. Provat janë për shembull të njëjtat, pra,
24 lidhur edhe me Prokurorinë. Për shembull nuk do të ishte e
25 dobishme që të mbanim gjykim përpara gjyimit, për sa i takon

1 çështjes së inkurajimit për kryerje të krimit. Sigurisht kjo
2 është një gjë e cila duhet trajtuar gjatë procesit gjyqësor
3 dhe të trajtohet në përfundim të tij.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees. A e
5 kuptoj këtë që dhe z. Cadman ka të njëjtin qëndrim në emër të
6 z. Haradinaj?

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë në fakt kam edhe
9 një pyetje të fundit për juve z. Haradinaj. Juve u shprehët që
10 synoni që të parashtrooni një kërkesë për të kërkuar heqjen e
11 dëshmitarëve të ndryshëm të cilët juve mendoni që do të
12 dëshmojnë sa i takon çështjeve shqetësuese për neve.

13 A mendoni që keni një afat kohor sa i takon dorëzimit të
14 parashtimit të kësaj kërkesë? Dhe sërish nuk dua t'ju vë në
15 pozitë të vështirë n.q.s. kërkon kohë për të pasur një
16 pozicion më të qartë, mund ta bëni këtë gjë.

17 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës n.q.s. ne do të
18 vendosim përfundimisht që do të bëjmë parashtimin,
19 parashtimi, kërkesa do të depozitohet nga mesi i shtatorit.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë kemi
21 thuhetse 25 minuta për të përfunduar me seancën e paradites. Do
22 të vazhdojmë me çështjen tjetër dhe do të marrim pushimin
23 sipas kohës që kemi përcaktuar në fillim të seancës. Tema e
24 radhës ka të bëjë me dëshmitarët e mundshëm të Mbrojtjes. Edhe
25 për këtë do të doja t'i jepja fjalën kolegut tim, Gjykatësit

1 Gaynor, i cili ka disa pyetje dhe disa çështje për të ngritur
2 lidhur me këtë pikë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Në urdhrin e
4 21 korrikut, Trupi Gjykses udhëzoi që secili prej skuadrave të
5 Mbrojtjeve të parashtrohte deri më 27 gusht, 2021 një
6 përmbledhje të fakteve ose rrethanave në lidhje me secilin
7 prej dëshmitarëve që do të dëshmojnë, në veçanti lidhur me
8 faktet specifike dhe rrethanat të cilat konsiderohen si me
9 interes publik nga të dyja ekipet e Mbrojtjes. Tani dua së
10 pari t'i jap fjalën ZPS-së që të japë përgjigjen e saj lidhur
11 me këtë çështje.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit të nderuar. Siç e
13 përmendëm edhe lidhur me çështjen e mëparshme, Mbrojtja kërkon
14 që të nxirren shumë prova materiale të cilat nuk kanë të bëjnë
15 domosdoshmërisht me këtë çështje. Kështu që ne kemi si qëllim,
16 pra, synojmë që të mund të bëjmë një kërkesë për heqjen e
17 këtyre dëshmitarëve ose provave. Pra, një pjesë e mirë e
18 pretendimeve të Mbrojtjes ka të bëjë me shtytjen për kryerjen
19 e veprës penale, apo nxitjen, edhe së pari do të duhet që të
20 shikohen elementët dhe e rëndësishme është për të theksuar që
21 nuk jemi në një situatë shtytjeje. Nuk është se është një
22 çështje e cila ka të bëjë me procesin e rregullt dhe të drejtë
23 juridik dhe pasjen e provave për përjashtimin e ZPS-së, por
24 është një çështje n.q.s. provat duhet që të nxirren gjatë
25 gjykimit në merita, pra në themel dhe n.q.s. ka elementë

1 kolateralë. Pra pozicioni ynë është që çështja e shtytjes apo
2 nxitjes për kryerjen e veprës penale nuk ka të bëjë me thelbin
3 apo me meritat e këtij gjykimi.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më lini të ndërpres për një
5 moment, pra nuk është se po trajtojmë çështjen e nxitjes apo
6 shtytjes për kryerjen e veprës penale, por po flasim për
7 interesin publik. Një pjesë e mirë e elementëve, të cilët janë
8 përmendur nga ekipet e Mbrojtjes, pra lidhur me ta do të doja
9 t'ju thoja n.q.s. keni ndonjë përgjigje, të cilat lidhen
10 posaçërisht me interesin publik, kjo është pyetja.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë çështje specifike që
12 ngritët ju i nderuar Gjykatës, atëherë duhet të shohim se cili
13 është përkufizimi i interesit publik.

14 Kuptimi ynë është që interesi publik shkon në të njëjtat
15 linja dhe mundohet që të ekspozojë çështje politike të
16 institucionit ose të informatorëve apo le të themi personave
17 të cilët japin informacione, por, megjithatë mendoj që
18 interesi publik nuk është justifikim i mjaftueshëm lidhur me
19 këtë pikë edhe këtë synojmë që ta parashtrojmë në aplikimin
20 apo kërkesën tonë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më lejoni t'i drejtohem
22 ekipeve të Mbrojtjes. A mendon Mbrojtja që të vepruarit në
23 interes të publikut, siç është parashtruar prej jush, është
24 një mbrojtje materiale për secilën prej akuzave, të cilat kanë
25 të bëjnë me aktakuzën specifike në këtë çështje, duke marrë

1 parasysh kufizimet për lirinë e shprehjes të parashikuar në
2 nenin 10, paragrafi 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e
3 Njeriut, dhe n.q.s. përgjigjja është po, a mund të na thoni
4 specifikisht se për çfarë akuzash bëhet fjalë specifikisht dhe
5 ku cenohet interesi i publikut? Do të filloj së pari me z.
6 Cadman.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Shumë thjesht, e thënë me pak
8 fjalë, "po". Ne si mbrojtje, synojmë që të përdorim prova për
9 ta demonstruar këtë gjë, pra përmes thirrjes së dëshmitarëve,
10 fakteve, ekspertëve, ne mendojmë d.m.th. që ky është një
11 element i interesit publik që duhet të mbrohet.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit! Z. Rees, fjala
13 për juve.

14 Z. REES: [Përkthim] Jemi dakord me pozicionin e mbrojtjes
15 së z. Haradinaj. Pavarësisht n.q.s. karakterizohet si mbrojtje
16 materiale ose n.q.s. përshkruhet si pjesë e procesit për
17 analizimin n.q.s. prokuroria ka provuar përtej dyshimit të
18 arsyeshëm elementët e secilës prej veprave, ne mendojmë se një
19 qasje e tillë përbën pengesë për lirinë e shprehjes dhe
20 interesit publik, që mëshirohen në dispozitat ligjore
21 përkatëse.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të na ndihmoni z.
23 Rees me ndonjë citim të ligjit kosovar apo të jurisprudencës
24 të GJEDNJ-së ose të TPNJ-së apo të jurisprudencave të
25 gjykatave të tjera, të cilat lidhen me punën tonë dhe që

1 mbështetin argumentin që interesi publik është një element i
2 vlefshëm i mbrojtjes, sa i takon çështjes së ngritur.

3 Z. REES: [Përkthim] Siç e kam thënë edhe në parashtrimin
4 edhe në dosjen paraprake, pra kjo parashikohet në nenin 22 të
5 Kushtetutës së Kosovës, nenin 19 të Deklaratës Universale për
6 të Drejtat e Njeriut, po ashtu edhe nenin 19 të Konventës
7 Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile, nenin 10 të
8 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 41 të
9 Kushtetutës dhe nenin 42, po ashtu.

10 Këto vepra penale janë specifike sipas Kodit Penal të
11 Kosovës dhe nuk është se ka ndonjë jurisprudencë e cila ofron
12 ndonjë ndihmë reale të vërtetë për Trupin Gjykses sa i takon
13 interpretimit të tyre. Pra siç del e qartë nga konfirmimi i
14 aktakuzës nga Gjykatësi i procedurës paraprake në të cilën ai
15 në fakt përdor citime shumë të kufizuara për tu mbështetur në
16 vendim-marrjen e tij. Ne e ftojmë Trupin Gjykses që të shohë
17 në detaje veprat penale vetë dhe që Trupi Gjykses të arrijë në
18 interpretimin e vet për fushëveprimin e këtyre veprave penale,
19 dhe si pjesë e këtij ushtrimi, ne mendojmë që Trupi Gjykses do
20 të duhet të shikojë të drejtat kushtetuese që i ofrohen z.
21 Gucati, sa i takon lirisë së shprehjes.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Rees.

23 Z. Cadman, do t'ju ftoja në qoftë se mundeni që të
24 identifikoni jurisprudencën specifike në lidhje me çështjen
25 apo dispozita të së drejtës së brendshme të cilat kanë të

1 bëjnë me elementin e interesit publik.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, siç e tha dhe
3 z. Rees, nuk është se ka ndonjë jurisprudencë specifike të
4 tribunalëve ndërkombëtarë ose tribunalëve *ad hoc*, në të cilët
5 ceket kjo temë. Në fakt kjo është hera e parë që ngrihet një
6 çështje e tillë në procedura të kësaj natyre. Sigurisht që ka
7 shembuj, ku interesat e publikut argumentohen në mënyrë të
8 suksesshme në arenën e ligjit shtetëror.

9 Sigurisht që qëllimi i thirrjes së dëshmitarëve, të cilët
10 ne kemi përmendur dhe që janë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të
11 institucioneve të drejtësisë mbështetet në kuadrin ligjor
12 evropian, dhe kjo është arsyeja sepse ne mendojmë që këto janë
13 elementë të cilët duhet të gjykohen gjatë procesit gjyqësor.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa i takon dëshmitarëve
15 ekspertë, kur parashikoni se do të keni mundësi që të
16 parashtroni listën e plotë të dëshmitarëve të tillë në pajtim
17 me Rregullën 4(9).

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk e di n.q.s. mund të më lejoni
19 një moment për t'u konsultuar i nderuar. Parashikojmë që të
20 kemi mundësi, që në katër javët në vijim të kemi mundësi që të
21 mund të japim një listë të tillë shteruese.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

23 Tani le të kalojmë te dëshmitarët të cilët janë listuar
24 nga të dyja ekipet e Mbrojtjes. Pra këta janë dëshmitarë
25 fakti, të cilët do të dëshmojnë n.q.s. i akuzuari ka punuar në

1 interes të publikut ose mund të cilësohen si sinjalizues të
2 drejtësisë. A jeni në gjendje që të na bëni me dije neve si
3 Trup Gjykses, se cilat janë ato fakte specifike mbështetur në
4 të cilën dëshmitarët mund të dëshmojnë, dhe të cilat lidhen
5 specifikisht me aktakuzën dhe pikat e ngritura në aktakuzën e
6 konfirmuar për të dyshuarit, për të akuzuarit.

7 Z. Cadman, fjala për ju.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar, ne në parashtrimet tona
9 me shkrim, kemi përshkruar se cilët janë dëshmitarët, të cilët
10 neve planifikojmë që të thërrasim në proces gjyqësor. Ne kemi
11 përshkruar detajet dhe neve do të duhet të bëjmë nxjerrjet
12 tona dhe nuk e mendojmë që ky është obligimi ynë për momentin.

13 Ne kemi identifikuar disa dëshmitarë fakti dhe dëshmitarë
14 të cilët mund të flasin për interesin publik në çështje të
15 nxjerrjes. Listat përbëhen nga persona, të cilët janë të
16 punësuar nga Shoqatat e Veteranëve të Luftës në atë kohë,
17 gazetarë dhe persona të tjerë, të cilët kanë pasur përvojë me
18 sistemin e EULEX-it. Pra, këta janë persona të cilët neve
19 mendojmë që janë në interes të publikut dhe që parashtrohen
20 nga mbrojtja.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Rees, a keni ndonjë gjë
22 për të shtuar sa i takon faktit që këta dëshmitarë do të
23 dëshmojnë dhe që lidhen me akuzat, që janë pjesë e kësaj
24 çështjeje?

25 Z. Rees, fjala për ju.

1 Z. REES: [Përkthim] Sigurisht që ne kemi parashtruar një
2 dosje paraprake të gjatë dhe të hollësishme ku parashikohen
3 çështjet e faktit mbi të cilat ne do të mbështetemi kur flasim
4 për çështje të interesit publik. Kjo është mënyra sesi ne e
5 kemi përkufizuar apo e kemi përshkruar këtë element.

6 Siç e kemi identifikuar edhe në dosjen për procedurë
7 paraprake, pra dosjen e Mbrojtjes, ne i jemi referuar të
8 drejtës së të akuzuarit për lirinë e shprehjes. Ne i jemi
9 referuar gjithashtu Kushtetutës së Republikës së Kosovës, se
10 si Kushtetutë moderne, të hapur dhe liberale edhe gjithashtu
11 edhe si kundërshtim i viteve sekrete autoritare dhe represive,
12 të cilat i ka kaluar Kosova, përfshirë këtu edhe nën regjimin
13 komunist të Kosovës.

14 Sipas Nenit 2(3) të Kodit Penal të Kosovës, pra
15 përkufizimi i veprës penale duhet që të ndërtohet
16 në mënyrë të rreptë. Interpretimi me analogji nuk duhet të
17 lejohet dhe po ashtu është e rëndësishme që të respektohen të
18 drejtat kushtetuese për të akuzuarin dhe kur gjërat të jenë të
19 nevojshme, të domosdoshme dhe në pajtim me ligjin. Dhe po
20 ashtu nenet 22, 40, 41, 42 të Kushtetutës po ashtu konfirmojnë
21 të drejtat e të akuzuarit sa i takon lirisë së shprehjes.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju lutem z. Rees, a mund të
23 na thoni specifikisht se cilat janë ato elementë faktikë që
24 mund të jenë me voli, mund të jenë me dobi për këtë Trup
25 Gjykses duke marrë parasysh akuzat në aktakuzën e konfirmuar.

1 Z. REES: [Përkthim] Pra kjo është diçka të cilën ne e
2 kemi përshkruar në parashtrimet e mëparshme edhe gjithashtu
3 edhe në dosjen e çështjes paraprake. Pra duhet që të kuptohet
4 që kjo është në mbrojtje të interesit publik. Dhe ne e ngremë
5 çështjen e interesit publik, sepse kjo është një çështje e
6 rëndësishme për Trupin Gjykses.

7 Unë nuk e kategorizoj se përshkruaj atë si mbrojtje
8 materiale, por do të jetë e rëndësishme për Trupin Gjykses kur
9 vlerësohet fushëveprimi i veprave penale dhe ne nuk po merremi
10 specifikisht me veprat e tjera të cilat janë trajtuar nga
11 gjykatat ndërkombëtare dhe nga tribunalët ndërkombëtarë, sepse
12 këto janë vepra të cilat duhet që të shikohen në kuadrin e
13 kornizës kosovare dhe janë të drejta të cilat mbrohen në
14 kuadrin e Kushtetutës së Kosovës dhe instrumenteve të tjera të
15 cilët parashikohen si pjesë e kushtetutës. Interpretimi i
16 këtyre veprave penale mund të bëhet vetëm me referencë tek të
17 drejta të tjera, të cilat janë të garantuara nga Kushtetuta.

18 Sa i takon fakteve ne kemi thënë në dosjen paraprake,
19 kemi përmendur faktin se përmbajtja e deklaratave të
20 njoftimeve për shtyp, të cilat janë përmendur si dhe qëllimi i
21 deklaratave për shtyp ka qenë që të bëhen publike
22 bashkëpunimet ndërmjet ZPS-së dhe autoriteteve serbe. Pra në
23 thelb kjo është një çështje e cila ka të bëjë drejtpërdrejt me
24 interesin publik. Domethënë ky është një fakt i cili ka të
25 bëjë me interesin publik dhe besojmë që ne e kemi bërë këtë të

1 qartë në dosjen paraprake duke u përgjigjur paragraf pas
2 paragrafi parashtrimeve të Prokurorisë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit z. Rees, do t'i
4 kthehem kësaj çështjeje pak më vonë, megjithatë, për
5 momentin, pra çështja e bashkëpunimit që juve përshkruat ose
6 siç u shprehët lidhur me bashkëpunimin e ZPS-së me autoritetet
7 serbe, po kjo është një çështje e cila ndoshta do të trajtohet
8 pak më vonë.

9 Pra nuk e di në qoftë se ZPS-ja do t'i përgjigjet ndonjë
10 prej gjërave që juve sapo ngritët në parashtrimin tuaj gojor.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj që pozicioni ynë për këtë
12 çështje është i qartë. Në qoftë se nuk keni ndonjë pyetje
13 specifike të nderuar, ne nuk kemi ndonjë parashtrim specifik
14 për të dhënë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Unë nuk kam pyetje të tjera,
16 faleminderit. Fjala për kryesuesin e seancës.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit zoti Kryetar.
18 Do të bëj një përshkrim të shkurtër sa i takon kuadrit ligjor,
19 ose pyetjeve le të themi për kuadrin ligjor. Z. Cadman ti nuk
20 është se ju drejtuat ndonjë baze ligjore specifike, ku Trupi
21 Gjykses do të duhet të mbështetet për të gjetur atë çfarë
22 referohet si shtytje për kryerjen e veprës penale ose nxitje
23 për vepra penale. Ndërkohë, që Mbrojtja tjetër d.m.th. u
24 përgjigj specifikisht duke iu referuar kuadrit ligjor, për
25 shembull Kushtetutës së Kosovës, për shembull, specifikisht

1 nenit 22, po gjithashtu edhe neneve të Konventës Evropiane për
2 të Drejtat e Njeriut.

3 Për arsye argumentimi duke prezumuar që z. Rees ka dhënë
4 bazën ligjore, e cila ka të bëjë me mbrojtjen e interesit të
5 publikut, personalisht do të isha i interesuar të di atë çfarë
6 përbën përkufizimin e këtij nocioni në masën që do të duhet që
7 të përdorim këtë përkufizim për të vlerësuar masën që ju
8 kërkoni që të vendoset dhe të gjykohet nga Trupi Gjykses.

9 Pra, pasi kemi bërë kërkime, besoj, të konsiderueshme
10 lidhur me këtë pikë, ne mund të identifikojmë një përkufizim
11 të interesit publik mbi regjimin aktual kosovar dhe ky
12 përkufizim gjendet në paragrafin 4 të nenit 200 të Kodit
13 Penal, që nuk i referohet, edhe duhet ta bëj të qartë këtë
14 gjë, që nuk ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me këto
15 procedura, por ka të bëjë me nxjerrjen e paautorizuar të
16 informacionit konfidencial. Domethënë kjo nuk është kërkesë e
17 Prokurorisë, megjithatë ky është një përkufizim i cili
18 përkufizon interesin e publikut dhe dua të citoj tani. Ajo
19 thotë që:

20 "Interesi publik është mirëqenia e publikut është më e
21 madhe sesa interesi i të akuzuarit dhe d.m.th. në qoftë se
22 përfshihet plani i përgatitjes ose kryerja e krimeve kundër
23 rendit kushtetues ose integritetit territorial të Republikës
24 së Kosovës ose veprave të tjera penale të cilat shkaktojnë
25 dëmtime të rënda trupore ose vdekje të një personi tjetër".

1 Kështu që pyetja për dy Mbrojtjet dhe për prokurorin,
2 Prokuroria më pas mund t'i përgjigjet kësaj pyetjeje po ashtu
3 në qoftë se e sheh të arsyeshme, por pyetja që kam për
4 mbrojtjet është në qoftë se ky është përkufizimi ku ju
5 mbështeteni sa i takon interesit të publikut për arsye të
6 këtyre procedurave ose sugjeroni që duhet të aplikohet një
7 tjetër përkufizim.

8 Në qoftë se jeni pro pyetjes së fundit, pra n.q.s. i
9 përgjigjeni me "Po" pyetjes së fundit ju lutem na thoni se
10 cili është përkufizimi përkatës?

11 Ndoshta z. Cadman n.q.s. mund të filloni ju.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Ky është njeri prej përkufizimeve
13 që parashikohen në ligjin kosovar sa i takon interesit të
14 publikut. Dhe ky është një përkufizim që duhet të marrë
15 parasysh Trupi Gjykses. Unë nuk kam një kopje me vete,
16 megjithatë jam i sigurt që mund t'ju vë në dispozicion një
17 kopje të një tjetër përkufizimi të kuadrit ligjor të Kosovës
18 që merret shprehimisht me mbrojtjen dhe interesat e publikut,
19 edhe do t'jua vë në dispozicion si dhe thashë deri nga fundi i
20 ditës këtë përkufizim specifik për të cilin e kam fjalën.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit z. Rees juve.

22 Z. REES: [Përkthim] Ju jam shumë mirënjohës për
23 referencën tuaj.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Rees vazhdimisht e keni
25 këtë problem me mikrofonin.

1 Z. REES: [Përkthim] Atëherë edhe njëherë ju jam
2 mirënjohës për referencën ligjore, për këtë nen specifik të
3 Kodit Penal të Kosovës. Nuk e di në qoftë se do të na lejoni
4 kohë për ta shqyrtuar atë dhe për të reflektuar mbi të?
5 Ne e kuptojmë që Trupi Gjykses dëshiron që të marrë
6 parashikime të hollësishme në kohën e duhur sa i takon
7 zbatimit të interesit të publikut.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju ishëm shumë
9 mirënjohës z. Rees në qoftë se mund të jepni komentet tuaja më
10 vonë.

11 Domethënë keni parasysh që këto janë gjëra të cilat juve
12 mund t'i shikoni dhe më pas. Megjithatë më lejoni të them, në
13 drejtimin tuaj z. Cadman, a mendoni juve që interesi publik në
14 kuadrin e këtyre procedurave, d.m.th. interesi publik që
15 klientët tuaj, pra, pretendojnë të kenë mbrojtur që kanë bërë
16 veprime ose sjellje të caktuara, ishte që të ekspozonin
17 bashkëpunimin ndërmjet STF-së apo ZPS-së nga njëra anë dhe
18 autoriteteve serbe nga ana tjetër? Domethënë ky është interesi
19 i vetëm do të thoja unë, publik, që mund të pretendohet,
20 d.m.th. mbi të cilin ju mund të mbështeteni. Nuk e di ky është
21 prezumimi juaj, ky është qëndrimi juaj?

22 Mikrofonin z. Rees. Duket qartë z. Rees që nuk ju është
23 bërë zakon që të ndizni mikrofonin.

24 Z. REES: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë! Shkurtimisht në
25 mënyrë që të jemi konciz dhe në mënyrë që të përfshijmë

1 parimet, pra, a mund të thuhet në përmbledhje që interesi
2 publik ka qenë në zemër të sjelljeve të të akuzuarit dhe mund
3 të thuhet që një pjesë e këtij elementi është bashkëpunimi
4 ndërmjet ZPS-së dhe autoriteteve serbe.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më lejoni që t'ju shtyj
6 pak më tepër lidhur me këtë çështje dhe sërish më lejoni t'ju
7 them që n.q.s. keni nevojë për më tepër kohë për t'ju
8 përgjigjur kësaj pyetjeje, na thoni.

9 Megjithatë, për momentin duke prezumuar që për këtë
10 moment kjo pra përbën interes publik për arsye, qëllime që ju
11 thatë, Prokuroria pretendon se bashkëpunimi midis STF-së dhe
12 ZPS-së ose njëres ose të dyjave bashkë dhe autoriteteve serbe,
13 është në fakt një çështje e cila ka qenë dhe vijon të jetë
14 ende një çështje në fushën publike për goxha kohë dhe
15 materiali që ata kërkojnë që të vendoset në procesverbal për
16 procedurat, kjo ka qenë një prej çështjeve që është propozuar
17 për një mbrojtje ose të dy mbrojtjet.

18 Pra dhe njëherë do të desha t'ju ofroja mundësinë që të
19 na thoni nëse pozicioni juaj është që ka pasur një interes
20 publik, pavarësisht faktit se informacioni d.m.th.
21 bashkëpunimi ndërmjet STF-së, ZPS-së dhe autoriteteve serbe
22 është thënë që ka qenë pjesë e interesit publik edhe në kohën
23 përkatëse.

24 Z. REES: [Përkthim] Ne do të parashtrojmë me
25 domosdoshmëri që informacioni që është në interes të publikut

1 nuk është se e humb rëndësinë e vet për shkak të faktit se
2 është raportuar më parë apo është trajtuar më parë.

3 Informacioni që është në interes të publikut mund të
4 vazhdojë që të raportohet në interes të publikut, d.m.th. nuk
5 është se humb le të themi, statusi i interesit të publikut me
6 kalimin e kohës. Për shembull, informacioni i cili është në
7 interes të publikut nuk e ka këtë në interes të publikut, për
8 aq kohë që është një "scoop", një lajm sensacional.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do vazhdojmë më tej dhe ju
10 lutem më thoni n.q.s. nuk doni që ta shtyjmë më tej, gjithsesi
11 do të doja të pyesja për momentin në qoftë se keni patur
12 mundësi se çfarë përqindje ose cila sasi e informacionit mbi
13 të cilën mbështetet Prokuroria për të përcaktuar akuzat për
14 klientin tuaj, mban informacion që është sensitiv, që shkon në
15 këtë drejtim?

16 Pra ajo çfarë qëndron pas pyetjes time, me fjalë të tjera
17 është sesa prej këtij materiali, d.m.th. se çfarë përqindjeje
18 e këtij materiali shkon në interes të publikut, n.q.s. ne e
19 pranojmë pretendimin tuaj duke e demonstruar d.m.th.
20 demonstrimi, bashkëpunimi që juve thatë është në interes të
21 publikut?

22 Domethënë a je në gjendje që të na thuash se në çfarë
23 përqindje, ose në çfarë sasi, pra, materialet që kanë nxjerrë
24 klientët tuaj shkojnë për përfitim të publikut, dhe do të
25 ndihmonin, pra, për përcaktimin e interesit të publikut?

1 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk mund të ndihmoj dot me këtë,
2 sepse Prokuroria nuk e ka ofruar materialin si provë materiale
3 dhe as nuk e ka nxjerrë këtë informacion, që kështu nuk mund
4 t'jua jap këtë përgjigje.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por në fakt juve keni mbi
6 katërqind prova materiale, d.m.th. ju ka dhënë informacione të
7 shumta Prokuroria. Mbase pyetja ime nuk ishte shumë e drejtë
8 për juve.

9 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të doja, do të
10 dëshiroja fort që të kisha mundësi që t'ju ndihmoja me këtë
11 gjë. Pra, ne do të donim që të merrnim, le të themi, nxjerrjet
12 e materialeve në seancën e parë, të shikojmë pak, le të themi,
13 natyrën e informacionit, n.q.s. informacioni është
14 konfidencial apo jo, në mënyrë që të mund t'ju jap një
15 përgjigje se cilët janë ato dokumente të cilat lidhen në
16 mënyrë të drejtpërdrejtë me interesin e publikut. Kështu që
17 për momentin më vjen keq por nuk mund t'ju përgjigjem dot
18 pyetjes tuaj.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani le t'i kthehemi
20 sërish natyrës së mbrojtjes në kuadrin më të gjerë. E kuptoj
21 pozicionin tuaj sa i takon natyrës ekzakte. Dhe pozicioni
22 është paksa i ndryshëm nga pozicioni i z. Cadman dhe e kuptoj
23 plotësisht këtë gjë. Por gjithsesi do të doja të kuptoja në
24 qoftë se juve nuk jeni në pajtim me faktin, ose kundërshtoni
25 faktin që STF-ja dhe/ose ZPS-ja janë të autorizuar ose e kanë

1 si pjesë të mandatit të tyre që të kërkojnë informacion
2 përkatës nga të gjitha burimet e mundshme të informacionit.
3 Domethënë e kundërshtoni këtë gjë juve apo jo?

4 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni për t'ju
5 përgjigjur kësaj pyetjeje në këtë mënyrë, gjykatësit do të
6 duhet që të shikojnë provat ekzaktësisht, për shembull, të
7 shikohet se çfarë është thënë se çfarë është diskutuar në
8 konferencat për shtyp, do të duhet që të shikohet natyra e
9 materialeve të përdorura në to. Natyra e këtyre materialeve,
10 emrat e vetëm që janë përmendur janë emra të cilët njihen nga
11 publiku, janë persona të cilët kryejnë role publike në Serbi,
12 e secili prej këtyre personave ka një histori të caktuar që e
13 ka bërë nxjerrjen e bashkëpunimit të tyre me ZPS-në relevante
14 dhe në interes të publikut. Neve kemi përshkruar me gjerësi në
15 dosjen paraprake se çfarë do të themi në lidhur me këta emra.
16 Neve do të thërrasim prova materiale, do të përdorim prova
17 materiale lidhur me ta.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Domethonë në qoftë se
19 parafrazojmë, më korrigjoni në qoftë se mendoni se duhet të më
20 korrigjoni, atëherë çështja e z. Gucati për çështje të
21 interesit publik nuk ka të bëjë me bashkëpunimin gjenerik
22 ndërmjet STF-së nga njëra anë dhe STF-së dhe ZPS-së me
23 autoritetet serbe, por nga ana tjetër pozicioni juaj është
24 zbulimi i bashkëpunimit nga këto dy organizata nga njëra anë,
25 d.m.th. STF-së dhe ZPS-së dhe nga ana tjetër disa prej

1 zyrtarëve serbë, të cilët ju i keni identifikuar si pjesë e
2 dosjes tuaj? A e kam kuptuar siç duhet dhe a përbën kjo
3 përmbledhje të duhur të pozicionit tuaj?

4 Z. REES: [Përkthim] Po! Absolutisht po! Megjithatë, për
5 të qenë konciz, pra referenca ndaj bashkëpunimit ndërmjet ZPS-
6 së dhe autoriteteve serbe është një përmbledhje e saktë. Por
7 sigurisht, në procesin gjyqësor provat që do të përdoren do të
8 jenë më specifike dhe ne kemi dhënë në detaje në dosjen
9 paraprake, në një parashtrim prej shtatëqind e ca faqesh
10 dokumentacion dhe shpjegime të detajuara. Pra neve kemi dhënë
11 shpjegimet që neve synojmë që të përdorim prova materiale të
12 cilat mbështesin pozicionin tonë faktik.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.
14 Atëherë e kuptoj që përmbledhja, d.m.th. përgjigjja ishte "po"
15 për sa i takon pyetjes që bëra. Megjithatë, pa diskutim që
16 neve do të marrim në shqyrtim çdo çështje faktike që do të
17 dorëzoni deri në masën sigurisht që ato të jenë relevante për
18 çështje që janë në diskutim dhe këtë po mundohemi që të
19 përcaktojmë sot. Nuk e di z. Cadman n.q.s. keni për të shtuar
20 diçka lidhur me atë çfarë u tha nga kolegu juaj deri tani?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Duke pasur parasysh orarin, i
22 nderuar Gjykatës, nuk besoj se ka ndonjë gjë me vlerë për të
23 shtuar në këtë fazë. Thjesht dua që të mbështes atë çfarë tha
24 z. Rees, pra dua të theksoj edhe njëherë tjetër që do të
25 përdoren prova materiale për këtë qëllim dhe sigurisht, si z.

1 Gucati dhe z. Haradinaj kanë pasur arsye, kanë pasur pra,
2 besimet e tyre, të cilat lidhen me interesin publik, d.m.th.
3 edhe për shkak të pozicionit që ata kanë mbajtur përpara sesa
4 të lindte kjo çështje. Siç e thashë kjo do të jetë pjesë edhe
5 e dëshmime të ekspertëve. Është e rëndësishme që të
6 përcaktohet, -- pra, këto janë informacione të cilat janë vënë
7 në dispozicion të interesit të publikut dhe këto janë të
8 gjitha pjesë e mbrojtjes së sinjalizuesve të drejtësisë, edhe
9 ndërkohë që ne kemi dhënë në parashtrimet tona me shkrim se
10 çfarë parashikohet në kornizën ligjore të Kosovës. Sigurisht
11 që këto mund t'jua parashtrojmë dhe me shkrim, megjithatë
12 pozicioni ynë është ky, që fakti që është në interes të
13 publikut, nuk është se e cenon mbrojtjen, në të kundërtën e
14 forcon pozicionin e mbrojtjes. Faleminderit.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Vetëm një pyetje të fundit
16 nga Gjykatësi Barthe dhe pastaj do të bëjmë pushimin.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit i nderuar
18 Kryetar. Shumë shkurtimisht, në fakt kam një pyetje për
19 Mbrojtjet. Mua më duket, mbase mund ta kem gabim në këtë
20 aspekt, megjithatë, mua më duket sikur juve po argumentoni ose
21 pretendoni që të paktën ka pasur, a ka qenë le të themi e
22 papërshtatshme nëse jo e paligjshme, që ZPS-ja të kërkojë
23 ndihmë ligjore për bashkëpunimin me autoritetet serbe.

24 Domethënë pyetja që kam për juve është kjo: A ka fusha të
25 tjera ligjore, të cilat janë në dispozicion të ZPS-së, që të

1 mbështeturit tek autoritetet vendase sa i takon, le të themi,
2 provave materiale të cilat ndodhen në territoret e tyre,
3 domethënë, a ka ndonjë përkufizim prokuroria që t'i drejtohet
4 autoriteteve të tjera për të mbledhur prova materiale? Nuk e
5 di në qoftë se z. Rees do ta marrësh ti fjalën i pari për
6 pozicionin tuaj?

7 Z. REES: [Përkthim] Është një pyetje për të cilën do të
8 duhet që të mendoj pak para sesa të jap përgjigjen, më duhet
9 të reflektoj dhe pastaj të jap përgjigjen në qoftë se më
10 lejoni.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Cadman, fjala për ju.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe unë mbështetem me qëndrimin e
13 kolegut tim.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirë, faleminderit. Nga
15 prokuroria nuk e di në qoftë se ka ndonjë koment apo jo?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, thjesht shkurtimisht do të
17 thoja që është i dukshëm nga materialet e nxjerra dhe nga
18 provat të cilat i janë dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë
19 Trupit Gjykses, që jo çdo gjë që nxirret bie mbi interesin
20 publik të identifikuar. Sigurisht që ZPS-ja nevojitet që të
21 jetë në gjendje që të hetojë duke përdorur kuadrin
22 bashkëpunues siç parashikohet nga ligji.

23 E vlerësojmë faktin që Mbrojtja do që të reflektojë dhe
24 kërkon kohë të mëtejshme për t'u përgjigjur kësaj pyetjeje dhe
25 pasi të përgjigjet mbrojtja, sigurisht, edhe ne mbase do të

1 kemi dhe përgjigjet tona.

2 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mirë, atëherë, do të marrim
3 pushimin. Pushimi është 90 minuta. Do të fillojmë pas 1 ore e
4 gjysmë. Do të takohemi sërish në sallën e gjyqit në orën 2:30.

5 Të gjithë në këmbë!

6 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.07

7 --- Seanca rifillon në orën 14.29

8 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Vijojmë tani me vëzhgimet e
9 parashtruara me shkrim lidhur me projekt-urdhrin për
10 zhvillimin e procesit.

11 Trupi Gjykses falënderon ZPS-në, mbrojtjen e Haradinajt
12 dhe zyrën administrative për parashtrimin e këtyre.

13 Z. Rees, ju keni treguar se ju dëshironi të mbani
14 parashtrime gojari dhe jo me shkrim. Kjo nuk parashikohej
15 faktikisht nga urdhri. Ka ndonjë arsye të veçantë pse keni
16 vepruar kështu?

17 Z. REES: [Përkthim] Unë nuk e kisha kuptuar që ka një
18 kufizim, pra që duhej të bëja vetëm parashtrime me shkrim.

19 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Jo, nuk është problem po a
20 mundet të bëni parashtrime me shkrim deri të premtën.

21 Z. REES: [Përkthim] Jo, nëse do kjo do ishte më e
22 dobishme mund ta bëjmë këtë gjë.

23 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mbase edhe urdhri unë nuk
24 ishte shumë i qartë. Pra a mund të dorëzoni parashtrim brenda
25 të premtës?

1 Z. REES: [Përkthim] Po.

2 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. REES: [Përkthim] I nderuar gjykatës, sot paradite u bë
4 një pyetje lidhur me faktin nëse kishte ndonjë precedent sa i
5 takon propozimit tonë nëse do të mjaftonte apo jo, që një
6 agjent të vepronte pa urdhër apo kundërshtim nga urdhrat, nëse
7 do të përdornim për shembull pistën e mbrojtjes së nxitjes,
8 inkurajimit pra, për të kryer krimin.

9 Në fakt në çështjen "Ramanuskas" është ky precedent.
10 Qeveria e Lituanisë e kishte shpjeguar se punonjësi i forcave
11 ligj-zbatuese, i cili ishte i afruar personit të tretë dhe i
12 kishte ofruar mitë, kishte negociuar me të, siç thanë ata, me
13 nismën e vetë private dhe nuk i kishte informuar autoritetet
14 për këtë gjë. Gjykata evropiane në fakt u shpreh se
15 autoritetet ndërkombëtare në fakt nuk mund të përjashtojnë
16 veten nga përgjegjësia që rridhte nga veprimi i këtij
17 punonjësi policie, pavarësisht se ai kishte vepruar me
18 cilësinë e një qytetari privat dhe nuk e kishte diskutuar këtë
19 me eprorët.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Krahas parashtimeve me shkrim që kemi marrë, Trupi
22 Gjykues vëren edhe parashtimet e Zyrës Administrative për
23 shërbimet e ofruara nga zyra e mbrojtjes dhe mbështetjes së
24 dëshmitarëve. Pyetja që kemi është kjo: cila është arsyeja për
25 klasifikimin si konfidencial nga ana e Zyrës Administrative të

1 udhëzimeve të punës që i bashkëlidhen parashtimeve të saj dhe
2 përse nuk ka versione publike të redaktuara për këto
3 dokumente?

4 ZYRA ADMINISTRATIVE: [Përkthim] Këto dokumente që
5 bashkëlidhen ndodhen në sistemin e klasifikimit administrativ
6 të shënuara si "limited" ose "limite" dhe kjo është e
7 barasvlershme me konfidenciale në sisteme të klasifikimit në
8 Legal Workflow. Ky nivel klasifikimi përdoret për informacione
9 dhe materiale në mbështetjen gjyqësorë dhe në dokumentacionin
10 administrativ dhe nxjerrja e paautorizuar e të cilave mund të
11 vendosë në pozita jo avantazhuese këtë institucion për shumë
12 arsye.

13 Ka në fakt arsye për këtë, një sërë prej këtyre kanë të
14 bëjnë me metodikën e përdorur nga Zyra e Mbrojtjes së
15 Dëshmitarëve, sa i takon angazhimit apo kontakteve që ata
16 bëjnë me dëshmitarët dhe personat e tjerë.

17 Nëse Trupi Gjygues do të jepte urdhër sigurisht mund të
18 vihet në dispozicion një version i redaktuar publik. Për
19 ndryshe ato janë konfidenciale.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Sigurisht. Pyetja është kjo:
21 ka disa udhëzime pune ku nuk ka – si të thuash – shqetësime
22 për sigurinë apo privatësinë dhe ato mund të trajtohen
23 ndryshe. Për hir të transparencës mbase mund të bënit një
24 shqyrtim dhe të na raportoni më pas në të ardhmen.

25 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar gjykatës.

1 kështu do të veprojmë.

2 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Tani do të jap një urdhër
3 gojarisht sa i takon parashtimeve të Zyrës Administrative për
4 zhvillimin e procesit.

5 Trupi Gjykses i urdhëron palët që t'i bëjnë të ditur
6 Zyrës Administrative drejtpërdrejtë, brenda datës 8 shtator
7 2021 nëse pajtohen apo nëse kanë kundërshtime apo nëse kanë
8 sugjerime lidhur me organizimin logjistik që kanë të bëjnë me
9 kontaktet fillestarë, mbërritjen dhe familjarizimin e
10 dëshmitarëve që janë paragrafët 5 deri në 24 të parashtimeve
11 me gojë të zyrës administrative.

12 I jepet urdhër zyrës administrative që t'i raportojë
13 Grupit Gjykses brenda datës 17 shtator 2021 për rezultatin e
14 këtyre diskutimeve dhe nëse kanë dalë probleme lidhur me to.

15 Do t'i kthehem tani çështjes së përthimit.

16 Në datën 21 korrik urdhri i Grupit Gjykses i udhëzonte
17 palët që të ngrinin brenda datës 3 shtator ndonjë çështje
18 lidhur me përkthimin me shkrim apo me gojë dhe këto shqetësime
19 t'i ngrihen drejtpërdrejtë Zyrës Administrative, për të
20 identifikuar ndonjë pasazh përkatës të dokumenteve për të
21 cilat ato kanë kundërshtim.

22 Trupi Gjykses i dha urdhër ZPS-së që të kërkonte
23 verifikim për një pjesë të transkriptimit të sinjalizuar nga
24 mbrojtja e Gucatit, ku pretendohet se kishte zbardhje të
25 gabuar. Brenda datës 23 gusht 2021.

1 I është dhënë gjithashtu urdhër mbrojtjes së Gucatit që
2 të parashtronte brenda datës 27 gusht 2021 një parashtrim të
3 protokolluar që përmban përkthimin e dokumentit për të cilin
4 ato kanë përdorur poshtëshënimin 47 të dosjes paraprake.

5 Së pari i jap fjalën Zyrës Administrative për të thënë
6 nëse ka ende ndonjë problem me përkthimin, probleme të cilat
7 janë ngritur nga palët.

8 Z. ROCHE: [Përkthim] Falemnderit, do të përgjigjem sipas
9 rendit të pyetjeve dhe shqetësimet që janë ngritur nga palët.
10 Nëse dëshironi mund të jap një prezantim të përgjithshëm të
11 numrit gjithsej të përkthimeve që në fazën paraprake të gjitha
12 parashtrimet e protokolluara dhe shtojcat i janë dorëzuar
13 automatikisht nga njësia përkatëse njësisë së shërbimeve
14 gjyqësorë për përkthim. Kjo përfshin edhe dokumente që
15 kërkohen nga të akuzuarit për përkthim.

16 Janë 859 kërkesa për përkthim që prej fillimit të fazës
17 paraprake dhe nga këto 426 janë përkthim në shqip. Pjesa
18 tjetër janë kërkesa për përkthime në gjuhën serbe. Kemi
19 përfunduar përkthimin e 90 dokumenteve syresh, 68 syresh janë
20 në gjuhën shqipe dhe pjesa tjetër në serbishte.

21 Dhe pas urdhrit të Trupit Gjyqës të datës 27 korrik - më
22 falni - 21 korrik, kemi marrë edhe 122 kërkesa të tjera
23 shtesë, 61 prej të cilave janë kërkesa për përkthim në shqip.
24 Edhe një herë kjo pasqyron faktin që dorëzimi i këtyre
25 dokumenteve për përkthim është një proces automatik.

1 Faleminderit.

2 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit, Z. Roche.

3 Sa i takon verifikimit të transkriptimit, si çështje e
4 ngritur nga mbrojtja e Z. Gucati, vërejmë se ZPS-ja ka nxjerrë
5 në datë 20 gusht rezultatet e këtij shqyrtimi.

6 Z. Rees, çfarë mendimi keni tani lidhur me transkriptimin
7 dhe përkthimin? Nuk ka mikrofon.

8 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Edhe një herë sepse mikrofoni
9 nuk ishte ndezur.

10 Z. REES: [Përkthim] Nuk kemi marrë ende udhëzime nga z.
11 Gucati lidhur me këtë, por do të marrim këto udhëzime do të
12 japim konfirmimin tonë lidhur me qëndrimin tonë. Faleminderit.

13 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Sa i takon përkthimit të dokumentit të përdorur në dosjen
15 paraprake të Gucatit, vërejmë se është dorëzuar një parashtim
16 i protokolluar lidhur me këtë.

17 Z. Prokuror, keni ndonjë gjë për të thënë lidhur me
18 përkthimin?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Ka ndonjë problem tjetër të mbetur të pazgjidhur që vlen
22 të ngrihet nga palët?

23 Z. Cadman?

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo ndonjë gjë konkretisht, e kemi
25 ngritur vazhdimisht në këtë proces dhe sigurisht që e kuptojmë

1 edhe trysninë në të cilën ndodhen shërbimet e përkthimit të
2 Zyrës Administrative. Por gjithsesi kjo i shkakton vështirësi
3 klientëve tanë të cilët nuk flasin anglisht dhe që kanë nevojë
4 që materialet t'i marrin në një gjuhë që t'i kuptojnë. Siç e
5 tha edhe Z. Roche, nga 400 e ca dokumente që duhen përkthyer,
6 90 syresh janë përkthyer. Pra është një përqindje shumë e
7 vogël e materialeve që janë dërguar për përkthim.

8 Ne ndodhemi në një pozicion të tillë që na duhet t'i
9 bëjmë vetë disa përkthime të përafërta në mënyrë që këto të
10 konsultohen nga klientët tanë.

11 Shkurtimisht dua edhe një herë që t'i rikujtoj të
12 gjithëve se është një institucion i Republikës së Kosovës. Pra
13 kemi shtetas të Republikës së Kosovës të cilët po gjykohen. Të
14 gjitha dokumentet duhet të përkthehen në një gjuhë të cilën e
15 kuptojnë këta persona.

16 Ka nevojë që të përshpejtohet ky proces. Unë e kuptoj që
17 për tribunalet përkthimi është gjithmonë një nga problemet më
18 të vështira dhe përdorimi më i madh i burimeve por nuk duhet
19 të harrojmë që z. Gucati dhe z. Haradinaj kanë të drejtë që
20 t'i konsultojnë të gjitha materialet në një gjuhë të cilën ata
21 e kuptojnë.

22 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Rees? Dëshironi që të
23 shtoni diçka?

24 Z. REES: [Përkthim] Jo.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Kolegët nga Trupi Gjykses?

1 Jo.

2 Atëherë Trupi Gjykses do të lëshojë një urdhër gojarisht
3 lidhur me këtë në fund të kësaj konference që me sa duket do
4 të jetë nesër.

5 Kalojmë tani te lista e dëshmitarëve e ZPS-së. Gjykatësi
6 Bartha na ka bërë të ditur se ka disa pyetje lidhur me këtë.
7 Ja kaloj fjalën atij.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kryetar.

9 Së pari lista e dëshmitarëve e ZPS-së. Zoti prokuror, a
10 synoni në të vërtetë që të vijoni me planin tuaj që të
11 përdorni vetëm dy dëshmitarë të cilët janë të punësuar nga
12 zyra juaj si të vetmit dëshmitarë në këtë gjykim?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Jo. ZPS-ja synon që të thërrasë
14 edhe një dëshmitar tjetër.

15 Deklarata e këtij dëshmitari do të nxirret këtë javë, siç
16 do ta shihni në atë moment, kjo deklaratë është një version më
17 formal i informacioneve të cilat i janë vënë në dispozicion
18 mbrojtjes përpara. Mbrojtjen e kemi informuar paraprakisht, pa
19 ç'ka se gjatë pushimit se kush është ky individ. Ne do të
20 kërkojmë që do ta dorëzojmë kërkesën tonë javën tjetër. Nëse
21 dëshironi më shumë informacion për individin në fjalë, duhet
22 të kalojmë në seancë private, por këtë gjë mund ta bëjmë.

23 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Besoj se e keni parë se ne
24 propozojmë që të kemi dhe konferencën e përgatitjes me
25 prokurorinë. Mbase mund të bëni dorëzimin e kësaj kërkeje para

1 kësaj date?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Zoti gjykatës, vijoni.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dua që t'i rikujtoj ZPS-së
5 se sa më vonë që bën të bëjë kërkesa për dëshmitarë shtesë, aq
6 më i lartë është pragu për arsye të forta për t'ju paraqitur
7 Trupit Gjykses për marrjen e vendimit për këto kërkesa. Besoj
8 se isha i qartë.

9 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Tema tjetër ka të bëjë me
10 dëshmitarët e ZPS-së. Ja jap fjalën z. Mettraux që ka disa
11 pyetje për këtë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, zoti
13 Kryetar. Është më shumë kërkesë se sa pyetje. Në paragrafin 19
14 të urdhrit tonë i kemi kërkuar ZPS-së që të na shpjegojë se si
15 synon që të paraqesë dëshminë e dy dëshmitarëve të propozuar
16 pa u hyrë në territor kompetencave të konstatimit të fakteve.

17 Këtu e kemi fjalën për shënime nga një vendimi nga
18 çështja "Milosheviç". Ne shpresojmë që të mos kërkonin që të
19 merrni dëshmi të një dëshmitari e cila do të ndërhynte në
20 kompetencat e Trupit Gjykses. Dua që të dëgjoj nga prokuroria
21 nëse e keni kuptuar apo jo se çfarë pret Trupi Gjykses lidhur
22 me këta dy dëshmitarë.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po, jemi të qartë. Dëshmitarët e
24 ZPS-së do të paraqesin këtu fakte dhe prova, jo analiza dhe
25 përfundime. Pra nuk ka një rrezik se ato mund të hyjnë në

1 kompetencat e Trupit Gjykses. Paketat që kanë dalë në këtë
2 rast përmbajnë informacione konfidenciale të hetimeve të Task-
3 Forcës të Specializuar Hetimore apo të ZPS-së dhe të personave
4 të mbrojtur.

5 Nxjerrja e këtyre informacioneve është objekt i
6 kufizimeve për mosnxjerrje. Prandaj nuk duhej të ishin
7 nxjerrë. Këto paketa nuk duheshin nxjerrë sepse në to
8 përshkruhej shumë qartë se këto informacione i përkisnin ZPS-
9 së dhe ishin të klasifikuara si konfidenciale. Këtë synon që
10 të dëshmojë dëshmitari W04841. Por nuk është e mundshme nëse
11 ky informacion i publikuar nga media, siç e përmbajnë këto
12 paketa, që të tregojnë me qartësi lidhjen midis dëshmitarit të
13 ZPS-së me materialet apo artikujt në media. Pra nuk mund të
14 arrihet në atë përfundim vetëm nga artikujt në media.

15 Dëshmitari W4842 do të dëshmojë këtu lidhur me shkallën e
16 burimeve, nivelin e burimeve që ZPS-ja i është dashur t'i
17 kushtojë trajtimit të shqetësimeve për sigurinë pas
18 shpërndarjes së tre paketave, pas nxjerrjes së këtyre
19 paketave.

20 Kjo është e lidhur drejtpërdrejtë me pikën 6 të aktakuzës
21 e cila kërkon paraqitjen e provave se personat e mbrojtur,
22 informacioni i të cilëve është zbuluar, kanë pasuar pasoja
23 serioze apo kanë sjellë pasoja serioze lidhur me personat që
24 kanë qenë në mbrojtje dhe për hetime penale përkatëse. Këto
25 janë shembuj të dëshmive të cilët ilustrojnë se ndryshe nga

1 vendimi në çështjen "Milosheviç", që ka identifikuar Trupi
2 Gjykues, dëshmitarët 4841 dhe 4842 nuk paraqiten këtu si
3 analistë të informacioneve që përmban dëshmia që i paraqitet
4 Trupit Gjykues.

5 Ata nuk japin mendimet e tyre si dëshmitarë ekspertë, por
6 vijjnë këtu për të dëshmuar lidhur me faktet që kanë të bëjnë
7 me akuzat e ngritura në aktakuzë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I mbajtëm shënim këto
9 parashtime z. Halling. Ajo që do t'ju kërkonim shtesë lidhur
10 me këtë, krahas këtyre që thatë, për të siguruar se nëse u
11 bënë pyetje për fakte në të cilat bazohen rrethanat për të
12 cilat ata kanë dijeni, duhet që të jetë e qartë pra edhe baza
13 për të cilën ata mund të paraqesin një fakt apo një rrethanë,
14 e cila sipas jush ka lidhje me provat apo me çështjen tuaj.

15 Z. HALLING: [Përkthim] E qartë.

16 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Gaynor, kishit pyetje?

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po. Pikë së pari, dëshiroj
18 që të pyes ZPS-në lidhur me parashtimin që sapo bëtë, pra
19 këtë përdorim shtesë të burimeve të ZPS-së, e cila sipas jush
20 ka penguar në mënyrë të rëndë hetimet e ZPS-së. Trupi Gjykues
21 do të kuptojë më mirë argumentet tuaja. Po a nuk është e
22 vërtetë se çdo hetim që bën ZPS-ja në përputhje me mandatin e
23 vet kërkon përdorim të shtuar të burimeve për atë hetim? Pra,
24 si e bën dallim ZPS-ja midis këtyre hetimeve dhe hetimeve që
25 përbëjnë apo që përfshijnë pengim të paligjshëm të punës së

1 saj?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Dallim që bëjmë ne midis hetimeve
3 që kryejmë rregullisht për mandatin tonë dhe hetimeve shtesë
4 të cilat i bëjmë për arsye të mosbindjeje ndaj Gjykatës. Ky
5 është dallimi që bëjmë ne. Në shënimet e kontakteve tona ju
6 besoj e keni vënë re që midis dëshmitarëve dhe kontakteve tona
7 ka lindur një frikë e cila është ekstra, e cila është nxitur
8 nga sjellja e të akuzuarve. Siç mund ta shohim për shembull
9 nga shënimet zyrtare është se kjo frikë ka arritur deri aty sa
10 edhe pse dëshmitarëve u është thënë se nuk i kishin emrat në
11 material, ata gjithsesi kishin frikë për shkak të kësaj. Pra
12 kjo kërkonte një menaxhim nga ZPS-ja dhe sipas parashtrimit
13 tonë, tërësia e gjithë masave që na është dashur të marrim ka
14 përbërë një pengesë shtesë për punën tonë, një pengesë të
15 konsiderueshme shtesë të shkaktuar nga zbulimi i personave të
16 mbuluar, e cila nuk do të kishte ndodhur po të mos kishin
17 vepruar kështu të akuzuarit.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po mirë, po a nuk është tek
19 e fundit detyra e çdo prokurori që të hetojë edhe mosbindjen
20 ndaj Gjykatës? Nuk është se është larg mandatit tuaj.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Varet nga shkalla. Unë e pranoj
22 atë që thotë Trupi Gjykues që sigurisht gjatë rrjedhës normale
23 të operacioneve gjithmonë do të shohim, do të hasim në
24 pengesa, por për pikën 6 të aktakuzës kemi një kualifikues që
25 është pengimi i rëndë i hetimit, i shkaktuar nga zbulimi i

1 këtjre materialeve. Pra nuk është një hetim çfarëdo i
2 mosbindjes ndaj Gjykatës. Është edhe shkalla deri ku ka
3 shkuar.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po të lëmë mënjanë
5 argumentet tuaja sa i takon përdorimit shtesë së burimeve, dua
6 që t'i kthehem i pikës 2 që është pengimi nga një grup. A
7 është argumentimi nga ana e ZPS-së se personat zyrtarë,
8 përfshirë edhe punonjësit e ZPS-së, përfshirë këtu edhe
9 gjykatësit, janë penguar në kryerjen e detyrave të tyre
10 zyrtare apo Prokuroria argumenton se të akuzuarit ishin në
11 dijeni se si rezultat i pjesëmarrjes në grup, do të ndodhte ky
12 pengim dhe kanë qenë dakord, kanë dhënë pëlqimin e tyre për
13 kryerjen e këtij pengimi. Pra cila nga këto dy alternativa
14 është argumenti i prokurorisë?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Ka shumë mënyra se si mund të
16 përshkruhet synimi kriminal, paramendimi kriminal, pra. Në
17 terminologjinë e TPNJ-së është termi që unë do të doja të
18 përmendja, që është synimi i tërthortë. Elementet e pikës 2 që
19 ka identifikuar i nderuar gjykatës, nuk kanë synim specifik në
20 të si element. E vetmja pikë e aktakuzës që ka paramendimin
21 specifik është pika 4, nëse nuk e kam gabim, sa i takon
22 hakmarrjes.

23 Prandaj për t'ju përgjigjur pyetjes suaj, është ky
24 formulim i fundit i synimit që është pranimi i një mundësie
25 mjaftueshmërisht të fortë të rezultatit, është e mjaftueshme

1 për t'i ngarkuar përgjegjësinë personit.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, ju nuk po thoni se
3 ndonjë zyrtar është penguar efektivisht në ushtrimin e
4 detyrave të tyre zyrtare. Kështu?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Mendoj se është e sakte kështu siç
6 e përshkruat ju. Elementi i dytë objektiv siç identifikohet në
7 vendimin e konfirmimit -- elementi i parë njëherë është
8 pjesëmarrja në një grup personash përmes veprimit të
9 përbashkët, ndërsa elementi i dytë është pengimi apo orvatja,
10 pra tentativa për të penguar një person zyrtar. Fakti se
11 synimi është një element -- është i përfshirë brenda këtij
12 elementi, është thjesht një tregues i synimit pra nuk është
13 pjesë e kriterëve që duhet të përmbushë pika 2.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, Prokuroria nuk po
15 pretendon se të akuzuarit kanë nxitur apo janë orvatur që të
16 nxisin dëshmitarë të caktuar, të veçantë që t'i thonë apo që
17 të mos i thonë informacione të caktuara ZPS-së?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Siç e kuptoj unë pyetjen edhe një
19 herë kjo është pyetje që ka të bëjë me synimin e përgjithshëm.
20 Sjellja e të akuzuarve është frikësuese, pra kërkojnë të
21 frikësojnë të tjerët. Të akuzuarit jo medoemos duhet të njohin
22 individët që cilët ata po frikësojnë, apo synimi specifik që
23 ato po frikësojnë X por jo Y. Nëse angazhohen në sjellje e
24 cila është frikësuese, sipas kuptimit të këtyre elementëve,
25 atëherë ata do të duhet të që shpalleshin fajtorë sipas të

1 drejtës përkatëse, siç është përshkruar në vendimin e
2 konfirmimit.

3 Shpresoj që i jam përgjigjur pyetjes suaj lidhur me këtë.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kjo na çon në pyetjen tjetër
5 tani. A mund të konfirmoni nëse ZPS-ja synon që të vërtetojë
6 se ka pasur dëshmitarë të veçantë të cilët janë ndjerë të
7 frikësuar apo kundër të cilëve ka pasur akte hakmarrjeje?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po, si indicie provuese të synimit
9 për frikësim dhe për hakmarrje. Nuk është element i veprës
10 penale për faktin se personat janë ndjerë të frikësuar apo
11 kundër këtyre është marrë hak është një tregues që bie brenda
12 kuptimit të pikës 3 dhe veprim i dëmshëm sipas kuptimit të
13 pikës 4. Ne e kuptojmë se në kryerjen e këtyre krimeve, siç e
14 shpjegojmë edhe në poshtëshënimin ku diskutohet kjo, ne marrim
15 parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare
16 dhe statutin e saj, neni 71(C). Kjo jurisprudencë, siç e
17 shikojmë tek çështja 2Bemba dhe të tjerë", në listën e
18 autoriteteve, personi mund të mos jetë i korruptuar. Është
19 kryerja e krimit me synimin për korrupsion. Këtë përpiqemi të
20 shpjegojmë edhe këtu.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të na shpjegoni
22 shkurtimisht se si synoni që të vërtetoni që ndonjë dëshmitar
23 i caktuar është ndjerë i frikësuar apo nëse ndonjë dëshmitar
24 është ndjerë se ka qenë objekt i akteve të hakmarrjes apo do
25 të ishte objekt i akteve të hakmarrjes? Si do ta vërtetonit

1 këtë?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo ka lidhje drejtpërdrejtë me
3 shënime të kontaktit të cilat ne i kemi parashtruar si prova
4 jashtë dëshmimeve të dëshmitarëve. Gjithashtu kjo ka lidhje edhe
5 me alternativën tjetër pra i kemi mbledhur këto prova siç e
6 shpjegojmë në kërkesën tonë për të paraqitur prova jo përmes
7 dëshmitarëve. Ato nuk janë prova të drejtpërdrejta për asnjë
8 nga pikat e akuzë por kanë lidhje me to.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do t'i kthehem çështjes së
10 shënimeve të kontaktit më pas, por më për më nuk kam më pyetje
11 për këtë. Faleminderit.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Pika me radhë
13 ka të bëjë me listën e provave materiale të ZPS-së. Në urdhrin
14 e vet të 21 korrikut Trupi Gjykses bëri të ditur që do t'i
15 kërkojë ZPS-së parashtrimin në qoftë se ka ndërmend të
16 propozojë prova të reja për përfshirjen në listën e vet të
17 provave materiale apo të ndryshojë listën e vet. Urdhëroni
18 zoti prokuror.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar
20 gjykatës.

21 Sikur kemi thënë në mocionin tonë për përfshirjen e
22 provave drejtpërdrejtë Trupit Gjykses, pas rishikimit të
23 transkriptimeve ne kemi ndryshuar disa, apo i kemi rishikuar
24 disa nga transkriptimet dhe kemi ndërmend që të bëjmë kërkesë
25 për përfshirjen e tyre në listën e provave materiale.

1 Dhe gjithashtu përmenda këtë dëshmitarin shtesë,
2 nxjerrjen e deklaratës së këtij dëshmitari, duhet të kërkojmë
3 edhe përfshirjen e kësaj deklarate në listën e provave.

4 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] A mund që këto kërkesa t'i
5 bëni deri me 6 shtator në mënyrë që ne të mund t'i rishikojmë
6 ato përpara seancës me ju?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

8 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Paneli do të nxjerrë vendim
9 në lidhje me këto çështje në fund të kësaj konference. A kanë
10 kolegët e mi pyetje?

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit, gjykatës
12 Smith.

13 Shkurtimisht, i drejtoj pyetjen përsëri ZPS-së. A e keni
14 parasysh se disa nga provat e përfshira në listën e provave të
15 ZPS-së momentalisht nuk janë paraqitur si prova të propozuara
16 dhe a mund të na thoni në qoftë se ato i keni ndërmend t'i
17 paraqisni gjatë gjykimit?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Ju faleminderit. Sa më përkujtoi
19 një koleg një gjë që e kisha harruar. Në shtojcën e mocionit
20 tonë për përfshirjen e provave drejtpërdrejtë Trupit Gjykses,
21 ne kemi përmendur edhe një video nga lista jonë e provave por
22 përkthimi i atij videoincizimi nuk ishte i përfshirë në listën
23 e provave dhe këtë kërkesë duhet ta përfshijmë në kërkesën për
24 përfshirjen në këtë listë të materialeve që përmenda më herët.

25 Për sa i përket pyetjes suaj ne presim vendimin e Trupit

1 Gjykues në lidhje me mocionin për paraqitjen e provave
2 nëpërmjet Trupit Gjykues -- drejtpërdrejtë te Trupi Gjykues,
3 se posa ta marrim këtë do ta kemi më të qartë se çfarë do të
4 pranohet dhe çfarë jo nga këto prova dhe do të jemi në gjendje
5 t'ju tregojmë më saktësisht në lidhje me provat që i përmenda.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit. Atëherë
7 edhe një herë ju ceki që keni një farë indikacioni se nuk do
8 të paraqitni si prova disa prej provave të përfshira në listën
9 aktuale të provave materiale, atëherë këtë duhet t'ja bëni të
10 ditur Trupit Gjykues sa më shpejtë që të jetë e mundur.

11 Kam edhe disa pyetje në lidhje me disa nga dokumentet që
12 i kemi në listën tuaj të provave, konkretisht nga numri 370
13 deri në numrin 372 dhe 476 dhe 480. Këto në fakt janë vendime
14 të gjykatave në Kosovë. Janë vendime gjyqësorë apo gjykime të
15 EULEX-it dhe UNMIK-ut. Pyetja ime është në qoftë se këto
16 dokumente do t'i përdorni si prova. Faktikisht cili është
17 qëllimi i përfshirjes së këtyre dokumenteve në listën e
18 provave materiale.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar gjykatës. Për të
20 përcaktuar statusin e personave të mbrojtur në lidhje me pikën
21 6 veçanërisht se çfarë masash mbrojtëse duhet t'ju jepen
22 këtyre njerëzve të përmendur në këto grupe dokumentesh,
23 dëshmitari 4841 do të dëshmojë pikërisht rreth kësaj pike.

24 Në këto dëshmi të këtyre dëshmitarëve që do t'i thërrasë
25 prokuroria, do të përmenden d.m.th. aspekte që përfshihen në

1 këto akt gjykime të gjykatave të Kosovës dhe për atë arsye
2 edhe janë përfshirë në listën e provave materiale të
3 prokurorisë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa për ta pasur të qartë,
5 në lidhje me procesin që ju propozoni është se dëshmitari në
6 fjalë do të vijë në gjykatë dhe do të pohojë se ky person,
7 emri i të cilit ka qenë i përfshirë në informacionin e
8 nxjerrë, është i njëjti person si personi të cilit i janë
9 miratuar masat mbrojtëse. A e kam kuptuar qartë këtë aspekt?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari W04841 do të flasë si
11 një person i përmendur në paketat e dokumenteve. Ka masa
12 mbrojtëse, në këtë apo në ndonjë çështje tjetër. I takon
13 Trupit Gjykses për ta vlerësuar këtë dëshmi në qoftë se do të
14 duhet paraqitja e provave shtesë për vërtetimin e identitetit
15 të atij dëshmitari dhe faktit që atij i janë caktuar masa
16 mbrojtëse.

17 Ne nuk themi që gjykatësit duhet të marrin ashtu siç e
18 themi fjalën tonë, por çdo herë i takon atyre që të marrin
19 vendimin e fundit në lidhje me vlerën e atyre provave.

20 Ka edhe një grup tjetër dokumentesh të gjykatësit që janë
21 pjesë e një liste provash dhe këto janë dokumentet që nuk kanë
22 të bëjnë me sjelljen apo veprimin e të akuzuarve apo me
23 deklaratat që u atribuohen z. Haradinajt apo z. Gucati, por
24 janë dokumente që kanë të bëjnë me dy individë të tjerë. Njëri
25 prej tyre është anëtar i Shoqatës së Veteranëve të Luftës

1 kurse një tjetër është jurist, të cilët përmenden në
2 parashtrimet e ndryshme.

3 Tani, cili është qëllimi i kërkesës suaj drejtuar
4 Panelit, pra çfarë rëndësie sipas jush Paneli duhet t'i japë
5 këtyre dokumenteve.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmia e këtyre e dy personave të
7 tjerë shpesh i përngjan asaj sikur ata flasin në emër të të
8 akuzuarve. Ka shembuj, kur juristi flet në një intervistë me
9 njërin apo me të dy të akuzuarit. Keni edhe shembuj ku një
10 person tjetër që e keni përmendur jep një intervistë ku ngre
11 pikërisht çështjet e njëjta si të akuzuarit në këtë çështje
12 dhe e uron z. Haradinaj në Facebook. Pra ka disa deklaratat të
13 këtyre personave të tjerë që nxjerrin në pah synimin e të
14 akuzuarve.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit për
16 përgjigjen, ju me siguri e keni parasysh faktin se ka disa të
17 drejta njerëzore që lidhen -- dhe kufizime që lidhen me
18 përfundimin që mund të nxjerrë një trup gjykues dhe të cilat
19 shkojnë në dëm të mbrojtjes.

20 Thjesht po ua them këtë që ta keni parasysh gjatë mënyrës
21 së parashtrimit të paraqitjes së provave që do të bëni gjatë
22 gjykimit.

23 Së fundi, prova 33 mendoj që kjo ishte në listën tuaj, që
24 është një dokument në lidhje me të cilin kemi diskutuar pak më
25 përpara, ku një transkriptim i ri, apo përkthim i ri duhet të

1 shtohet. A e keni ndërmend që të bëni kërkesë për përfshirjen
2 në listë të versionit të ri të këtij transkriptimi dhe
3 përkthimi?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar gjykatës dhe siç
5 thuhet në poshtëshënimin e kërkesës tonë, kjo e konfirmon që
6 kjo provë materiale e paraqitur për pranim është faktikisht
7 një transkriptim i rishikuar një transkriptimi të mëparshëm.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fund, redaktimet e disa
9 nga dokumenteve të përfshira në listën e provave materiale,
10 ndonjëherë janë redakte të shumta. Ai e keni ndërmend që t'i
11 paraqitni si prova këto versione të redaktuara të dokumenteve?
12 Pra ato që janë paraqitur gjatë procesit të nxjerrjes së
13 nxjerrjes së materialit të mbrojtjes. Apo keni ndërmend që të
14 jepni një farë versioni më pak të redaktuar apo ndryshe të
15 redaktuar të këtyre dokumenteve.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Për sa i përket nivelit të
17 redaktimeve dhe në qoftë se ky nivel i redaktimeve mund të
18 rishikohet dhe prej këtyre të nxirren versione më pak të
19 redaktuara, ZPS-ja duhet ta bëjë këtë gjatë gjithë kohës së
20 gjykimit. Në qoftë se ne jemi në gjendje të dorëzojmë një
21 version më pak të redaktuar atëherë padyshim që do ta bëjmë
22 këtë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ka ndonjë koment nga
24 Mbrojtja në lidhje me parashtimet e prokurorit? Keni fjalën
25 Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Në këtë fazë jo i nderuar gjykatës,
2 ka disa aspekte që ka parashtruar ZPS-ja dhe të cilat kërkojnë
3 nga ne një rishqyrtim më të plotë dhe ne rezervojmë të drejtën
4 tonë për t'ju përgjigjur këtyre me shkrim.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit.

6 Z. Rees?

7 Z. REES: [Përkthim] Ne do ta rishikojmë edhe njëherë
8 kërkesën e prokurorisë për paraqitjen e provave drejtpërdrejtë
9 Trupit Gjykses dhe do t'i përgjigjemi me shkrim asaj kërkesë
10 në kohën që vjen.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se kolegët e
13 mi kanë pyetje të tjera. Gjykatësi Barthe do ta marrë
14 diskutimin prej kësaj pike e më tej.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju faleminderit.

16 Në urdhrin e 21 korrikut Trupi Gjykses bëri të ditur se
17 do të kërkojë parashtrime gojore për mënyrën se si ZPS-ja ka
18 ndërmend të garantojë efikasitetin e të drejtës së
19 konfrontimit sikurse parashikohet me nenin 6(3)(d) të
20 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe sikurse
21 pasqyrohet në nenin 31(4) të Kushtetutës së Kosovës, neni
22 24(4)(f) të ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe
23 rregullës 153 deri në 155 të Rregullores së Procedurës së
24 Provave në lidhje me provat e propozuara, përkatësisht: a) në
25 qoftë se autori i provës së propozuar i është i njohur

1 Mbrojtjes, por nuk ftohet për të dhënë dëshmi dhe
2 identifikohet informacion që është i redaktuar dhe në qoftë se
3 prova e propozuar është një procesverbal i diçkaje që ka thënë
4 një palë e tretë dhe ajo palë e tretë nuk është ftuar për të
5 dhënë dëshmi. Për më tepër, parashtimet ju kërkuar palëve për
6 atë nëse ZPS-ja mund të konfirmojë identitetin e autorëve të
7 provave të propozuara apo të palëve të treta, deklaratat e të
8 cilëve janë paraqitur si prova por të cilat nuk do të
9 dëshmojnë.

10 Ndërkohë ZPS-ja ka dorëzuar një kërkesë për pranimin
11 drejtpërdrejtë përmes Trupit Gjykses të disa provave të
12 këtilla. Tani ju jap fjalën juve zoti prokuror për sqarim.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Ju faleminderit. Për ta diskutuar
14 këtë pyetje dhe nënpyetjet që ajo përfshin është me rëndësi që
15 të theksohet që nga fillimi se thelbi i provave në këtë
16 çështje dihet publikisht dhe pasqyrohet në videoincizimet që
17 janë publikisht të disponueshme dhe në deklaratat që
18 publikisht i kanë dhënë vetë të akuzuarit. Konfrontimi apo
19 ballafaqimi i shënimeve zyrtare të ZPS-së me dëshmi të palës
20 tjetër mund të interpretohet nën dritën e kësaj që thashë. Atë
21 që thuhet në këto shënime që do të paraqiten është si vijon.

22 Kategoritë të cilat janë të identifikuar nga Trupi
23 Gjykses janë të gjitha variacione të të njëjtave pyetjeve të
24 cilat të gjitha kanë të bëjnë me provueshmërinë e materialeve
25 pa një dëshmitar përkues. Në qoftë se ka një dallim ndërmjet

1 kërkesës për respektimin e të drejtave të njeriut dhe
2 pranueshmërisë ligjore sipas rregullës 153 deri në 155, një
3 tjetër dallim do të duhet që të bëhet sa i takon mënyrës se si
4 do të bëhet pranueshmëria e provave. Dhe sa i takon kërkesës
5 për ofrimin e provave drejtpërsëdrejti për Trupin Gjykses të
6 drejtat e njeriut lejojnë mbështetjen në dëshmitarët anonimë
7 ose që nuk janë të pranishëm në sallën e gjyqit. Aspekti
8 kryesor sa i takon këtij testi është që kemi të bëjmë
9 pikërisht me një testim, le të themi peshimi dhe jo
10 pranueshmërie dhe për këtë arsye Trupi Gjykses do të duhet që
11 të jetë i vetëdijshëm për sa i takon peshës së këtyre provave.
12 Megjithatë do të doja të thosha që nuk ka kufizime për
13 pranueshmërinë që është dhënë nga Gjykata Evropiane e të
14 Drejtave të Njeriut sa i takon këtyre materialeve.

15 Lidhur me pranueshmërinë dhe skemën ligjore të DHSK-së,
16 Trupi Gjykses ka diskrecion material në këtë aspekt. Rregulli
17 153 deri 155 kërkojnë që provat të jenë dëshmuese, ndërkohë që
18 asnjë prej provave, të cilat ne i kemi ofruar për t'u pranuar,
19 nuk kanë implikime të tilla.

20 Për këtë arsye nuk ka arsye për të menduar që Mbrojtja
21 nuk do të ketë të drejtat e përshtatshme për përballjen në
22 këtë proces gjyqësor. Ndërkohë, do të doja të theksoja edhe
23 njëherë që thelbi i provave të prokurorisë janë video dhe
24 deklaratat të cilat janë publike. Dhe për këtë arsye,
25 kundërshtimi i Mbrojtjes për përballimin e një -- le të themi

1 konfrontimin me një çështje anonime të cilat mbështeten në një
2 nëngrup-provash të cilat nuk janë menduar fare si me vlerë
3 provuese për asnjë prej elementëve të aktakuzës.

4 Kishte edhe një tjetër pjesë të pyetjes tuaj e cila ka të
5 bëjë me rregullin 155. Dëshironi që t'i përgjigjem asaj tani?

6 Asnjë nga provat të cilat do të ofrohen pa një dëshmitar,
7 nuk bien nën këto rregulla dhe këtu përfshihet edhe rregulla
8 155. Në këtë aspekt mund të shikoni kërkesën për provat e
9 drejtuara drejtpërdrejtë tek Trupi Gjykses dhe gjithashtu edhe
10 nevojën për interpretim dhe për pasojë rregulli 155 nuk është
11 se zbatohet në parashtrimet tona, në veçanti sa i takon
12 shënimeve të prokurorëve.

13 Në qoftë se prezumohet për çështje argumenti që do të
14 ishte e zbatueshme rregulla 155 për këto shënime kontakti, unë
15 do të doja të thosha që kriteret janë përmbushur. Duhet
16 shënuar që rregulli 155 është më i gjerë se sa rregullat e
17 krahasueshme të tribunaleve të tjera, si për shembull rregulli
18 68(2)(c) i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, rregulli 155 po
19 gjithashtu i afrohet një personi i cili nuk është më ndërmjet
20 nesh, pra është i vdekur ose ka arsye të tjera që janë listuar
21 në këtë rregull për të mos qenë i pranishëm në seancën e
22 gjyqit.

23 Gjykatësi i procedurës paraprake është shprehur që
24 mosnxjerrja e këtyre personave është rreptësisht e kërkuar.
25 Kjo mbështetet nga informacioni i nxjerrë veçanërisht për ata

1 persona të cilët kanë vuajtur pasoja psikologjike dhe të tjera
2 të rënda dhe për këtë arsye do të ishte absolutisht që të
3 pranoheshin këto prova nën rregullën 155, në qoftë se rregulla
4 do të ishte e zbatueshme. Faleminderit.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë zoti
6 prokuror.

7 Dhe nuk e di Mbrojta dëshiron të komentojë parashtimet
8 tuaja?

9 Z. Reese

10 Z. REES: [Përkthim] Ne do të ngremë kundërshtimet tona në
11 parashtimet me shkrim, në përgjigje të mocionit për
12 parashtimet e drejtpërdrejta të dëshmimeve para Trupit Gjykses.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe unë kam të njëjtin qëndrim, të
14 nderuar.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Gjyqtari Mettraux, keni
16 pyetje të tjera?

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po në fakt, kam disa
18 pyetje të tjera.

19 Z. Halling, do të doja që të shtyja pak më tej dhe do t'i
20 kthehem për pak minuta rregullës 155 që ju cituat në
21 ndërhyrjen tuaj. Megjithatë le të mendojmë për një moment që
22 ju e sillni dëshmitarin në gjykatë dhe ju e pyesni atë që të
23 komentojë disa prej shënimeve që do të paraqisni dhe që keni
24 kërkuar që të jenë të pranueshme nga Trupi Gjykses. A është
25 rasti që ata dhe për rrjedhojë edhe ne, do të vendosemi në një

1 pozicion që ata to të duhet të presupozojnë që informacioni që
2 përmbahet në shënime të tilla është i plotë, është i saktë dhe
3 që përkthimi gjithashtu që mund të jetë zhvilluar në këtë
4 kuadër, është i besueshëm. Pra me fjalë të tjera, dëshmitari
5 do të kërkohet që të presupozohet që çfarëdo lloj gjëje që
6 përfshihet në këto shënime është i saktë dhe një reflektim
7 korrekt, i saktë, i plotë i asaj çfarë mund të ketë ndodhur në
8 ndërveprimin ndërmjet stafit tuaj dhe një prej dëshmitarëve.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar, kjo është pjesa e
10 fushë-veprimit të dëshmisë së dëshmitarit me numër W04842.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, si mendoni ju që
12 mbrojtja do të jetë në pozicionin që në mënyrë efektive, pra
13 dhe po përdor këtu terma teknikë, domethënë që të ketë mundësi
14 që të përballet në mënyrë efektive dhe që të kundërshtojë
15 saktësinë e shënimeve të tilla në goftë se juve veçanërisht
16 mbështeteni tek ajo që do të thonë dëshmitarët, "dëshmitarët
17 do të mbështeten tek shënimet".

18 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari në fjalë, pra ka qenë i
19 përfshirë në shkrimin e këtyre shënimeve dhe mbrojtës i është
20 dhënë e gjithë përmbajtja e këtyre shënimeve dhe mbrojtja mund
21 të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre shënimeve. Dhe në fakt
22 këtë gjë e kanë bërë që në fillim fare. Për shembull datën e
23 informacionit, mënyrën se si ofrohet informacioni, domethënë
24 mbrojtja ka të drejtë ta bëjë këtë gjë dhe sërish ne presim që
25 mbrojtja ta bëjë këtë gjë në parashtime që do të vijë si

1 rezultat i parashtrimit të listës së dëshmimeve që do t'i jepen
2 drejtpërsëdrejti Trupit Gjykues.

3 Sipas GJEDNJ-së nuk ka asgjë që e pengon një procedurë të
4 tillë në veçanti sa i takon pranueshmërisë dhe në qoftë se do
5 të ketë mundësi, domethënë që ato të pyeten, të gjithë
6 dëshmitarët të mund të pyeten sa i takon përmbajtjes.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju po sugjeroni që ka
8 mundësi që mbrojtja t'i bëjë pyetje dëshmitarëve sa i takon
9 procedurës së përgjithshme ose mënyrës se si janë marrë këto
10 shënime. Por personalisht do të isha më shumë i interesuar që
11 të dija pak procesin në të cilin janë përgatitur këto shënime
12 dhe në qoftë se mbrojtja do të ketë mundësi që të mund të
13 kundërshtojë saktësinë e këtyre shënimeve. Domethënë si
14 sugjeroni juve që mbrojtja do të ketë mundësi ta bëjë këtë në
15 mënyrë efektive në lidhje jo me procedurën e përgjithshme që
16 është ndjekur nga zyra juaj, sepse e kuptojmë por, lidhur me
17 shënimet specifike që ju do të parashtroni.

18 Do të doja t'ju kujtoja që edhe në parashtrimin tani,
19 juve thatë që do të mbështeteni për shembull tek pjesa e
20 natyrës frikësuese të sjelljes së të pandehurve.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari me kodin W04842 në fakt
22 ka hartuar disa, është autori i disa prej këtyre shënimeve. Ka
23 shënime të tjera të cilat pak a shumë kanë të njëjtën
24 procedurë ose le të themi ndjekin të njëjtin proces dhe besoj
25 që besueshmëria mbështetet tek fakti që dëshmitari do të

1 përshkruajë shënimet e veta. Ne nuk është se do të marrim, do
2 të thërrasim secilin prej personave të cilët janë kontaktuar
3 me dëshmitarët dhe nuk e kemi të nevojshme që të shkarkohemi
4 nga barra e provës për ta bërë këtë gjë, por është çështje
5 peshimi. Pra Trupi Gjykses do të duhet të peshojë -- pra në
6 qoftë se Trupi Gjykses është i shqetësuar për besueshmërinë e
7 provave për atë që mund të shkojë përtej dëshmisë së
8 dëshmitarëve, atëherë besoj se kjo do të reflektohet në
9 gjykim, por nuk është çështje pranueshmërie dhe nuk është
10 çështje në fakt e konfrontimit ose përballimit, por çështja që
11 shtrohet është peshimi ose përdormi i drejtë i provave të
12 cilat do të parashtrohen në gjykatë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po t'i kthehem rregullës
14 155 dhe ju e keni përmendur atë dhe sugjeruat po ashtu që
15 rregullat ku mbështeteni nuk ofrojnë një bazë, por rregulla
16 155 ja u jep këtë mbështetje. Mënyra se si e lexoj unë
17 rregullën 155 është kjo: kur për arsye të qenësishme,
18 dëshmitari nuk mund të japë dëshmi gojore, pra së pari është e
19 rëndësishme që të identifikohet paaftësia, pamundësia e
20 personit për të dhënë dëshminë fizikisht. Pyetja për ju është
21 kjo: a i keni pyetur personat në fjalë në qoftë se ata janë
22 autorët e këtyre shënimeve apo jo, apo me individët, personat
23 me të cilët ata kanë diskutuar, nga të cilët kanë marrë
24 dëshmitë, në qoftë se ata janë të përgatitur që të japin
25 dëshmi, në qoftë se do të marrin le të themi një kërkesë për

1 të ardhur dhe për të dhënë dëshmi.

2 Pra me fjalë të tjera, a e keni marrë, le të themi
3 gatishmërinë ose refuzimin e tyre për të dhënë dëshminë këtu
4 apo thjesht e mbështesni këtë te gjykimi juaj dhe ju
5 presupozoni që nuk do të keni kundërshtim nga personat për të
6 ardhur dhe për të dhënë versionin e tyre.

7 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptoj pyetjen tuaj që juve -- e
8 keni pyetjen sa i takon personave të kontaktuar apo jo?

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt kemi të bëjmë me
10 një shumëzim të barrave me të cilën ata përballen. Domethënë
11 së pari kemi barrën në mendjen e tyre sa i takon masave
12 mbrojtëse që ju keni kërkuar dhe mbi këtë shtohet edhe pengesa
13 e publicitetit dhe e mundësisë për t'u përballur në mënyrë të
14 tillë që personi i cili ka hartuar shënime, nuk
15 identifikohet. Dhe ju, për shembull, përjashtimet e vetme që
16 dhatë janë tre ose katër shënime të cilat janë hartuar prej
17 njërit prej dëshmitarëve të propozuar. Por ndërkohë personi
18 nga ana tjetër e telefonatës nuk identifikohet kështu që
19 pyetja për juve është kjo: në qoftë se ju keni ndërmarrë
20 ndonjë hap nga zyra juaj në mënyrë që t'i pyesni këta persona
21 lidhur me këto shënime ose mbase t'i kërkonit personave të
22 cilët kanë qenë nga ana tjetër e telefonatës, pra dëshmitarët
23 -- pra duam të në qoftë se ata janë kërkuar që të japin dëshmi
24 dhe ata kanë kundërshtuar ta bëjnë këtë gjë.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Sa i takon stafit të ZPS-së,

1 rregulla 155 nuk zbatohet mbi ta. Deklaratat në shënime të
2 cilat janë me interes nuk janë ata, domethënë ata janë mënyra,
3 mjeti se si vijjnë dëshmitë e personave të tjerë dhe mbi këtë
4 mbështetet parashikimi i rregullës 155. Pra kjo është mënyra
5 sesi e shikojmë neve zbatueshmërinë e rregullës 155.

6 Vështirësitë që kanë dëshmitarët për të ardhur këtu për
7 të dëshmuar dhe arsyet për pengimin jepen vetëm në shënime. Sa
8 i takon të mbështeturit tek fjala apo te deklarata e ZPS-së
9 dhe stafit të tij, kjo nuk është vetëm thjeshtë fjala jonë. Ne
10 kemi bërë kërkesën për Gjykatësin e procedurës paraprake që të
11 kërkonim për redaktimet, që të mos jepet nxjerrja e plotë e
12 informacionit.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më lejoni t'ju ndaloj z.
14 Halling. Kemi dy çështje të ndryshme. Pra në rastin më të
15 mirë, shënimet të cilat ju kërkonin që të ofroni, reflektojnë
16 shprehjen e shqetësimit të disa prej këtyre individëve.

17 Megjithatë nuk po të pyesja për këtë. Pyetja ime është
18 kjo dhe do të doja që ta përsërisja edhe një herë: a i keni
19 kërkuar personave - pra zyra juaj a i ka kërkuar personave që
20 të vijjnë e të japin dëshmi dhe ata a kanë kundërshtuar dhënien
21 e dëshmimeve? Dhe do të doja që të presupozoja në qoftë se keni
22 marrë masat e nevojshme, për shembull për të kërkuar për masa
23 mbrojtëse në qoftë se personat që keni kontaktuar e kanë
24 kundërshtuar kërkesën tuaj për të dhënë dëshmi.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Në momentin kur ne morëm vendimin

1 e Gjykatësit të procedurës paraprake që ne nuk na duhet që të
2 nxirrnim emrat e tyre, atëherë nuk ka pasur diskutime të tjera
3 sa i takon në qoftë se ata duhet të ishin në listën e
4 dëshmitarëve apo jo sepse pozicioni ynë ishte i qartë.
5 Megjithatë do të doja të thosha edhe një herë që pozicioni ynë
6 është që rregulli -- pra është në qoftë se a zbatohet apo jo
7 rregulli 155 në rastin në fjalë.

8 Ne nuk i mendojmë këto persona si dëshmitarë që duhet të
9 japin deklaratat e tyre të dëshmitarëve këtu në sallën e
10 gjyqit. Ky është pozicioni i prokurorisë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të doja që t'i
13 drejtohesha kryetarit të Trupit Gjykses.

14 Z. Halling, a prisni që për arsye të rregullës 153 deri
15 në 155 deklarata me shkrim përfshin çdo regjistrim të
16 përgatitur për qëllime të proceseve ligjore ndaj pyetjeve dhe
17 përgjigjeve të cilat janë dhënë ndaj pyetjeve që janë
18 parashtruar? A e kuptoni kështu atë çka parashikohet nga
19 rregulla 153 deri në 155?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Jo të gjitha, sepse ka situata të
21 caktuara të cilat mund të identifikohen gjithashtu edhe në
22 shënime. Në qoftë se bëhen pyetje sa i takon sigurisë së
23 personit, sigurisht që ka pyetje dhe përgjigje për të
24 përcaktuar në qoftë se ekzistojnë këto shqetësime sigurie. Në
25 qoftë se do shikohet nga autoritetet që ne ofrojmë përmes

1 dëshmime të drejtpërdrejta, kjo jo domosdoshmërisht është pjesë
2 e qëllimit dhe kontekstit të proceseve gjyqësore.

3 Për shembull një rast mund të jetë deklarata e dhënë nga
4 një gazetar. Pra këto nuk janë persona të cilat janë pjesë e
5 listës së dëshmitarëve që synojmë që t'i thërrasim. Nuk është
6 se kanë informacion ekspert për një çështje të caktuar, por
7 thjesht atyre ju kërkohet që të japin mendimin e tyre se çfarë
8 informacioni kanë si rezultat i këtyre nxjerrjeve.

9 Pra do të jetë një lloj intervistimi, domethënë nuk është
10 se është - jo domosdoshmërisht kemi të bëjmë me fushëveprimin e
11 rregullës.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në listën tuaj të provave
13 për t'u ofruar drejtpërdrejtë për Trupin Gjyqësor ju thoni që
14 "doni që të përcaktoni pasojat e rënda të dëshmitarëve si
15 rezultat i akteve, sjelljeve dhe veprimeve të të akuzuarit".
16 Ky ishte citim. Më parë ju thatë që ju do të ofroni këto prova
17 në mënyrë që të vërtetoni ndjesinë e frikësimit ose të masave
18 dhe veprimeve hakmarrëse ndaj personave. A prisni ju që ndonjë
19 prej shënime që përcaktonte informacion të tillë është
20 deklarata e dëshmitarit për arsyet e parashikimeve të
21 rregullës 153, 154, 155?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk e mendoj kështu. Proceset
23 ligjore neve i diskutojmë si një term arti. Ndërkohë që gjithë
24 konteksti i këtij diskutimi varet në qoftë se - domethënë
25 çfarë kuptohet me "proces ligjor". Pra në qoftë se kuptimi i

1 procesit ligjor përfshihet vetëm me atë çfarë ofrohet në
2 prova, atëherë kjo do të ishte përtej asaj. Domethënë kemi të
3 bëjmë thjeshtë me përmbajtjen e deklaratës që është
4 karakteristike për mënyrën se pse e kemi marrë këtë
5 informacion dhe mbi këtë ne përqendrohemi. Për shembull, në
6 qoftë se do shikojmë, për shembull, të gjitha provat që i
7 japim në mënyrë të drejtpërdrejtë, ne po ashtu përcaktojmë më
8 qartë se çfarë bie brenda rregullës 155 dhe rregullës analoge
9 të GJPN-së. Por nga ana tjetër edhe vetë raporti i hetuesit
10 nga i njëjti dëshmitar dhe referencimi i të njëjtit
11 informacion nuk është konstatuar që të bjerë brenda
12 fushëveprimit të rregullave dhe një prej shembujve më
13 specifikë është çështja e "Lubanga" ku mbrojtja po ofronte
14 informacion sigurimi dhe prokuroria kundërshtoi për arsye të
15 procesit të brendshëm të punës së prokurorisë dhe nuk ishin në
16 gjendje që të mund ta ofronin këtë provë përmes referencimit
17 të drejtpërdrejtë. Dhe do të doja të thosha që jo çdo element
18 i kësaj ka të bëjë me procesin gjyqësor. Për shkak të
19 ngjashmërisë së tyre të rregullores tonë me rregullore të
20 tjera të gjykatave, tribunalëve të tjerë ndërkombëtarë, mendoj
21 që duhet të shkohet në të njëjtin linjë si vendimet e
22 gjykatave të tjera.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Atëherë vendimi për çështjen
24 "Lubanga" është marrë shumë më përpara se sa janë hartuar
25 rregullat e procedurës dhe provave të TPNJ-së.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Po është absolutisht kështu dhe ne
2 e bëjmë këtë edhe më të aplikueshme sepse në kohën e vendimit
3 të "Lubangës" kishte një rregull që ishte rregulli 66. Ne e
4 kishim rregullin 68(2)(a) dhe kishim gjithashtu edhe rregullin
5 68(3) të rregullave moderne. Çfarë do të thotë që gjërat që do
6 të duhej që të prezantoheshin për dëshmitarin ishin më të
7 ngushta dhe parimet e oralitetit ose të parashtrimeve me gojë,
8 me fjalë të tjera, ishte më i fortë në atë kohë të çështjes
9 "Lubanga" se sa është aktualisht. Megjithatë ne mendojmë që i
10 njëjti shpjegim është i kuptimtë edhe në kuadrin në fjalë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam disa pyetje të cilat
12 kanë të bëjmë me dallimin midis telefonimit të një dëshmitari
13 dhe krijimit të kontaktit përmes bisedës që është e reflektuar
14 në shënimet që pretendoni ju. Për shembull të akuzuarit në
15 çështje janë arrestuar më 25 shtator të vitit 2020 dhe
16 ndërkohë disa prej këtyre shënimeve të kontaktit të
17 prokurorisë janë hartuar goxha më përpara. Janë hartuar në
18 janar, në shkurt të vitit 2021, ndërkohë që prokuroria ka
19 kërkuar pranimin e këtyre provave vetëm dje, domethënë thuajse
20 gjashtë muaj pas hartimit të shënimeve nga stafi i saj. Juve
21 duket sikur keni deklaruar në parashtrimet tua se këto
22 shënime, pra diskutimet me dëshmitarët, nuk janë bërë për
23 arsye të proceseve gjyqësore. Megjithatë, pyetja ime është në
24 qoftë se shënimet e hartuara të përgatitura nga stafi juaj në
25 janar dhe në shkurt të vitit 2021, a nuk janë përgatitur ato

1 për arsye të proceseve gjyqësore?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë më lejoni një moment sa të
3 gjej vendimin që ka të bëjë me përgjigjen e pyetjes që sa u bë
4 me vendimi që lidhet me përgjigjen e pyetjes suaj.

5 Pra mund të shikoni vetë nga shënime, që këto janë
6 shënime -- shumë prej shënimeve që kanë datat e janarit janë
7 marrë shumë herët. Pra ato zakonisht, domethënë reflektojnë
8 edhe diskutimet e 22 shtatorit. Megjithatë, duke filluar nga
9 shtatori i vitit 2020, pjesa me e madhe e këtyre shënimeve ose
10 pjesa me e madhe e shënimeve të mbajtura nga W04842 domethënë
11 nuk synonim që t'i përdornim ato për proceset gjyqësore. Për
12 shembull, mund të shikoni që në parashtimet e mëparshme nuk
13 është se jemi mbështetur në këto shënime.

14 Në momentin kur ato janë nxjerrë, ato janë nxjerrë
15 kryesisht si rezultat i masave kundërbalancuese që janë
16 urdhëruar nga gjykatësi i procedurës paraprake, i cili ka
17 dhënë këtë vendim me 22 shkurt të vitit 2021. Domethënë ky
18 vendim për neve ishte treguesi i parë që ne na duhej që të
19 nxirrnim këto materiale shtesë. Siç ka ndodhur po ashtu edhe
20 me masa të tjera kundërbalancuese të urdhëruara nga gjykatësi
21 i procedurës paraprake.

22 Pra pasi është kaluar, le të themi, pengesa ose ura për
23 të nxjerrë materialet, atëherë ne kemi vijuar me pjesën tjetër
24 të kërkesave. Pra ajo çfarë kemi thënë përpara është ajo çfarë
25 po themi tani, domethënë nuk është se i kemi krijuar këto

1 shënime për proceset gjyqësore. Thjeshtë më vonë kemi vendosur
2 që të mbështetemi mbi to për proceset gjyqësore.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra juve po kërkonim që të
4 mbështeteni te këto shënime pjesërisht për të vërtetuar
5 pasojat e rënda që kanë vuajtur dëshmitarët si rezultat i
6 veprimeve dhe sjelljeve të të akuzuarit.

7 Megjithatë, a nuk ndodh, apo a nuk është rasti që duke i
8 kërkuar Trupit Gjyqësor që të pranojë shënime të tilla, pra a
9 nuk po i kërkonim përmes kësaj gjëje Trupit Gjyqësor që të
10 pranoni vërtetësinë e këtij informacioni që ofrohet nga këta
11 dëshmitarë për ZPS-në?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po, kështu është por elementët që
13 neve përshkruajmë dhe ku vendosen ato në çështjen tonë, do të
14 doja që këto të theksoja në ndërhyrjen time. Pra është një
15 element i zgjerimit të dënimit nën pikën 6. Dhe dënimi në
16 skemën ligjore të DhSK-së ka një kornizë të ndryshme
17 procedurale dhe po ashtu edhe të drejta të ndryshme përballimi
18 sesa provat në gjykim.

19 Pra, mund të jetë një situatë ku Trupi Gjyqësor mund t'i
20 përdorë këto shënime vetëm kur mbështeten nga faktorë të tjerë
21 dhe mund t'i përdorë më tepër për dënimet në një mënyrë që
22 është plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor të DhSK-së.

23 Mbrojtja nuk ka të njëjtat të drejta për të ekzaminuar
24 dënimin e dëshmitarëve në qoftë se ata nuk bëjnë pyetje, nuk
25 marrin në pyetje dëshmitarët gjatë gjyimit. Dhe kjo në fakt

1 lidhet me atë çfarë thash në fillim fare të ndërhyrjes sime,
2 domethënë ka një dallim ndërmjet, le të themi, pranueshmërisë
3 edhe peshës dhe në qoftë se Trupi Gjykses ka rezerva lidhur me
4 përdorimin e fazës së dënimit përkundrejt fazës së dëgjimit të
5 tyre, atëherë pa diskutim që është në të drejtë të Trupit
6 Gjykses që të vendosë që të bëjë diçka tjetër.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, këto ishin të
8 gjitha pyetjet që unë kisha lidhur me këtë temë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit zoti kryetar.
10 Në fakt unë kam një pyetje shumë shkurt për prokurorinë.

11 Përsëri, zoti prokuror, ju sapo thatë para dy minutash
12 por edhe në mocionin tuaj të pranimit të provave jo përmes
13 dëshmitarëve që rregullat 153 deri në 155 nuk janë të
14 zbatueshme për këtë çështje dhe jepni arsyet për këtë qëndrim.
15 Nëse Trupi Gjykses nuk pajtohet me arsyetimin tuaj, cila nga
16 këto tre rregullat të lartpërmendura do të ishin të zbatueshme
17 në këtë rastin tonë, duke pasur parasysh se shënimet mbi
18 kontaktet me dëshmitarët përmbajnë informacione, ndër të tjera
19 me pasoja të mundshme mbi sjelljen e pretenduar të të
20 akuzuarve? A do t'i referohej kjo veprimeve dhe sjelljes së të
21 akuzuarve sipas rregullës 154 apo do të zbatohet rregulla 153.
22 Faleminderit.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po, faleminderit, e kuptoj pyetjen
24 të nderuar gjykatës, kjo në fakt lidhe edhe me përdorimin
25 hipotetik të 155-ës.

1 Rregulla 154 në fakt nuk është një ndalim për prezantimin
2 e provave përmes rregullës. Sigurisht ne nuk synojmë, pra nuk
3 mendojmë se do të thërrasim pra -- do të kemi një përdorim të
4 rregullës 153.

5 Veprimet dhe sjelljet e të akuzuarve kuptohet në fakt
6 sipas kuptimit të natyrshëm të këtyre termave dhe kushteve,
7 pra janë veprimet dhe sjelljet e këtyre të akuzuarve.
8 Dëshmitarët nuk kanë njohuri në fakt ose dijeni për veprime
9 dhe sjellje të të akuzuarve. Thjesht do të shpjegojmë ndikimin
10 që kanë pasur tek ata këto veprime dhe sjellje. Pra nëse
11 zbatohet rregulla 153 do të thoshim që të paktën që kjo pjesë
12 e rregullës nuk do të ishte problem. Në fakt kjo lidhet me atë
13 pyetjen tjetër nëse bën pjesë tek rregullorja apo jo dhe e
14 kemi shpjeguar qëndrimin tonë por jemi në dispozicionin tuaj
15 që t'ua shpjegoj përsëri.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit zoti prokuror.
17 Nuk e di mbrojtja a ka një koment.

18 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Kam unë një pyetje
19 fillimisht.

20 Zoti Halling, nuk e di a më kujtohet saktë apo jo, ju
21 thatë që deklaratat -- pra thatë që në fillim që deklaratat
22 publike janë ato të cilat -- me të cilat përbëhen provat
23 tuaja.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është e saktë.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Pra këto prova për të cilat

1 ne kemi 45 minuta për të cilat flasim, në një farë mënyre
2 sikur nuk kanë lidhje me këtë çështje apo jo?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Shpresoj që nuk e kam thënë këtë.

4 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Po kështu më duket mua.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Ne nuk parashtrojmë se këto prova
6 nuk kanë lidhje, parashtrimi ynë është që këto prova kanë
7 lidhje dhe janë provuese, por nuk pritet që të jenë të vetmet
8 faktorë dhe faktori provues në vërtetimin e elementeve të
9 veprës.

10 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mua më duket se ju thatë se
11 mund të jetë e mundshme që të përdorni këto vetëm në fazën e
12 shqyrtimit të dënimit po të këtë dënim.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Ne e përdorim si tregues -- do ta
14 përdornim si tregues të frikësimit dhe të sjelljes hakmarrëse.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Pra nuk planifikoni t'i
16 përdorni që në fillim të procesit?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, jo. Mund të shihet pra që në
18 fillim të procesit. Paraprakisht ne planifikonim që të
19 mbështeteshim te dëshmitari W04842 dhe është Trupi Gjykses
20 pastaj me vendimin e tij që na ka nxitur që ta shtojmë këtë
21 material.

22 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Në rregull, por ne nuk jemi
23 të detyruar nga kjo gjë që thoni ju dhe nëse ndjekim
24 sugjerimin e kolegëve që kam në të majtë, nuk mund që t'i
25 hedhim këto prova, apo jo? Me përjashtim të fazës së

1 shqiptimin të dënimit apo jo?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Unë shpresoj që varet se si do të
3 jetë rezultati dhe kështu shpresojmë ne që në fakt Trupi
4 Gjykues do të vendosë për rëndësinë e këtyre provave në fund
5 të procesit.

6 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Jo, unë po përpiqem që të
7 kuptoj përse mendoni se qenka kaq e rëndësishme, duke qenë se
8 ju mendoni se çështja juaj është e provuar tërësisht nga
9 deklarata publike. Domethënë çfarë lloji provash të tjera janë
10 këto.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ajo çka lidhje apo jo ka të bëjë
12 me faktin për të cilin ne po diskutojmë. Janë elementët e
13 veprave për të cilat ne po flasim dhe të cilat janë ngritur
14 akuzat. Pastaj a përfundon apo jo vetëm me deklaratat publike
15 është një çështje që do të gjykohet nga trupi gjykues.

16 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] E vlerësoj këtë argument të
17 thënë kështu, e kuptoj, por jo me doemos duhet të biem dakord.
18 I drejtohem mbrojtjes tani.

19 Z. REES: [Përkthim] Do ta trajtojmë këtë temë në
20 parashtrimet -- në kundërpërgjigjen tonë me shkrim për
21 mocionin e prokurorisë. Trupi Gjykues duhet të jetë në
22 dijenisë se në konferencën e parë për ecurinë e çështjes në
23 janar ZPS-ja e ka informuar Gjykatën se në varësi të hapave që
24 do të merren, ata synonin që të merrnin në intervistë dhe të
25 thërrisnin për dëshmi edhe dhjetë dëshmitarë të tjerë shtesë.

1 Sigurisht aso kohe të gjitha palët edhe gjykatat e kanë
2 kuptuar se kjo kishte të bënte me ata persona të cilët ZPS-ja
3 pretendonte se kishin vuajtur nga sjellja e përfshirë në
4 aktakuzë. Më duket se bëhet fjalë për konferencën e zhvilluar
5 më datë 8 janar. Është konferenca e parë mbi ecurinë e
6 çështjes.

7 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Nuk e di kolegët e tjerë kanë
8 diçka tjetër për të shtuar? Jo?

9 Na kanë mbetur dhe rreth 13 minuta, do të fillojmë me
10 temën tjetër. Të shpresojmë që ta përfundojmë.

11 Gjykatësi Gaynor ka kërkuar që të bëjë pyetje në lidhje
12 me autenticitetin e provave materiale të ZPS-së. Fjala është
13 për ju.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Në urdhrin e
15 datës 21 korrik Trupi Gjykues vërente vështirësitë që haste
16 mbrojtja e Gucatit siç parashtrohej në dosjen paraprake lidhur
17 me autenticitetin e dokumenteve që i janë dorëzuar Organizatës
18 së Veteranëve të Luftës së UÇK-së më datë 7 dhe 16 shtator të
19 vitit 2020.

20 Në të njëjtin urdher Trupi Gjykues i kërkonte mbrojtjes
21 së Gucatit që të shpjegonte nëse parashtrohet se materiali që
22 pretendohet se është i nxjerrë nga të akuzuarit, nuk bënte
23 pjesë në dokumentacionin e ZPS-së apo Task-Forcës, nëse ishte
24 i fabrikuar apo nëse nuk ishte siguruar kujdestaria e duhur
25 nga ZPS-ja apo nëse autenticiteti i materialit është ai që

1 kundërshtohet.

2 Z, Rees fjala është për ju.

3 Z. REES: [Përkthim] Autenticiteti i dokumentacioneve që
4 ne e ngremë si çështje nuk ka të bëjë vetëm me dokumentet e
5 datës 7 dhe 16 shtator por mbulon si problematikë edhe
6 dokumentet e dorëzuara në datë në 22 shtator, siç është
7 shpjeguar në paragrafin 278 dhe 300 të dosjes paraprase të
8 Mbrojtjes.

9 Qëndrimi që mban Mbrojta në këtë dosje paraprase është se
10 të akuzuarit nuk e dinë se dokumentet dhe shënimet që
11 pretendojnë **konfidencialitet** apo përdorim të brendshëm, ishin
12 apo jo autentike, se nuk e dinin nëse ishin origjinale këto.

13 Prandaj duhet kuptuar qëndrimi i të akuzuarve se ata
14 kërkojnë që prokuroria të vërtetojë autenticitetin e
15 materialit të dorëzuar më datë 7, 16 dhe 22 shtator. Unë në
16 emër të zotit Gucati i mbështes të tre qëndrimet e mbajtura në
17 paragrafin 23 të urdhrit.

18 Pikë së pari, nuk është e pranueshme që materiali që
19 pretendohet se është nxjerrë nga të akuzuarit, pjesërisht apo
20 tërësisht, bënte pjesë në dokumentacionin e Task-Forcës së
21 ZPS-së; b) ne nuk pranojmë se nuk ishte tërësisht apo
22 pjesërisht i fabrikuar; dhe c) ne nuk pranojmë se është
23 siguruar nga ZPS-ja zinxhiri i përshtatshëm i kujdestarisë. Në
24 fakt ne i mbështesim të treja këto qëndrime, veçmas apo
25 bashkërisht, sepse siç kemi shprehur në dosjen paraprase, z.

1 Gucati, i akuzuari, nuk e ka ditur nëse këto dokumente dhe
2 nëse shënimet e këtyre dokumenteve që tregonin se ishin
3 konfidenciale, ishin apo jo, autentike apo të rreme.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Cadman, fjalë është për ju.

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit. Kemi të njëjtin
7 qëndrim. Ne e kemi thënë që prej fillimit të këtij procesi se
8 ne nuk jemi në gjendje që të vërtetojmë autenticitetin e këtij
9 materiali, si për të vërtetuar nëse janë apo jo dokumente të
10 vërteta të ZPS-së apo Task-Forcës dhe as nuk jemi në gjendje
11 për të thënë nëse materiali për të cilin tani mbështetet ZPS-
12 ja është vërtetë materiali që është sekuestruar nga mjediset e
13 klientëve tanë. Nuk kemi pasur mundësi që ta shqyrtojmë këtë
14 material. As gjykatësi i procedurës paraprake nuk ka pasur
15 mundësinë që ta shqyrtoj këtë material dhe siç jam në dijeni,
16 as Trupi Gjykses nuk është në gjendje që ta shqyrtojë këtë
17 material. Asnjë dëshmitar pra nuk po thirret, të cilët do të
18 mund të vërtetonin që këto dokumente kanë qenë autentike dhe
19 se janë të njëjtat dokumente që janë sekuestruar --
20 pretendohet që janë sekuestruar në të treja rastet. Prandaj,
21 mbajmë qëndrimin se Prokuroria është ajo që ka barrën e provës
22 për ta vërtetuar këtë gjë.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. I jap fjalën
24 Prokurorisë për t'u përgjigjur.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Prokuroria ka barrën

1 për të vërtetuar - barrën e provës për të vërtetuar se
2 dokumentet e shpërndara kanë të bëjnë me hetime të ZPS-së dhe
3 janë konfidenciale. Ne synojmë ta bëjmë këtë pikë së pari duke
4 thirrur hetuesin që ka bërë krahasimin e këtyre materialeve.
5 Së dyti, duke dhënë prova prej të cilave hetuesi ka
6 identifikuar se cilat dokumente janë autentike apo jo. Dhe së
7 treti, do të paraqesim edhe artikujt e mediave që zbulojnë ato
8 faqe nga këto paketa të cilat mund të shihen dhe të shqyrtohen
9 nga Trupi Gjykses. Së fundi, është edhe sjellja e të
10 akuzuarve, çdo fjalë dhe veprim i të cilëve përputhet me
11 dijeninë -- pra që ata e dinin që këto dokumente ishin sekrete
12 dhe kishin të bënin me hetime të ZPS-së.

13 Sa i takon dokumenteve të 16 shtatorit, sidomos për këto
14 dokumente që njihen si paketa 2, ZPS-ja po kështu e kishte
15 nxjerrë këtë paketë me redaktime, pra e ka nxjerrë këtë paketë
16 me redaktime dhe do të paraqitet këtu përmes dëshmitarit
17 W04841. Mbrojtja mund ta kundërshtojë autenticitetin e këtyre
18 materialeve nëse dëshiron.

19 Mbrojtja e Gucatit, po t'i kthehem medias tani, e vë
20 shumë theksin te fakti se faqet e publikuara në media mund të
21 kenë ardhur edhe nga një burim tjetër dhe përsëri, siç është
22 thënë më herët, ne jemi të angazhuar për të paraqitur prova
23 lidhur me veprat penale të kryera.

24 Të akuzuarit i kanë kryer -- kanë pasur sjelljen e tyre
25 dhe është vetëm çështje e deduktimit të se nga e kanë marrë

1 mediat por të paktën hë për hë e dimë që një media -- të
2 paktën një media, e konfirmon se i kanë marrë këto materiale
3 nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe se mediat
4 ishin të grumbulluara në këto deklarata për shtyp dhe këto
5 konferenca për shtyp ku janë përhapur materialet dhe se nuk --
6 e thënë shkurt, i nderuar gjykatës, do të them se si Prokurori
7 jemi në dijeni se barra e provës qëndron me ne dhe do të
8 paraqesim prova për këtë.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa i takon paketës së tretë,
10 e cila nuk do t'i vihet në dispozicion Trupit Gjykses, a do të
11 jetë kjo pjesë e provave tuaja në një farë mënyre?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po, është një prej 3
13 shpërndarjeve, pra tre nxjerrjeve dhe siç e përmenda më
14 përpara, dëshmitari W04841 do të flasë edhe për këtë paketë,
15 për ta analizuar atë. Ka pjesë me fshirje të informacionit,
16 pra me mbulim të informacionit konfidencial, si edhe artikujt
17 e medias.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Por, Trupi Gjykses nuk do të
19 jetë në gjendje që të kontrollojë përmbajtjen e paketës 3 në
20 vetvete?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Kjo ka lidhje me parashtrimin
22 që kemi bërë, ne nuk mund t'i nxjerrim këto paketa sepse janë
23 produkt i brendshëm i punës sonë të cilat ne na lejohet që t'i
24 mbajmë dhe jo t'ja vëmë në dispozicion qoftë edhe Trupit
25 Gjykses. Por ne mendojmë se nuk na duhet paketa për të

1 vërtetuar akuzat. Ne i kemi përgatitur provat e mjaftueshme në
2 bazë të të cilave ne mendojmë Trupi Gjykses do të vendosë
3 "pro" shpalljes së fajësisë që kërkojmë ne.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, nuk kam pyetje
5 të tjera lidhur me këtë temë.

6 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mendoj se është më mirë ta
7 mbylлим seancën për sot dhe të mos hapim temë tjetër. Një
8 moment.

9 [Trupi Gjykses dhe Administrata e Gjykatës
10 këshillohen]

11 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do të ritakohemi nesër në
12 orën nesër në orën 09:30 siç e kam thënë më përpara por dua që
13 t'ju informoj se Trupi Gjykses nesër do të dëshirojë që të
14 dëgjojë edhe argumente e ZPS-së lidhur me redaktimet e
15 njoftimit të hollësishëm sipas rregullës 102(3).

16 Ne mendojmë që kjo do të jetë një seancë *ex-parte*. Nëse
17 do të vendoset kështu përpara kësaj seance ZPS-ja pritët që
18 t'i japë njoftim paraprak Mbrojtjes lidhur me natyrën e
19 kundërshtimeve të tyre, sa i takon nxjerrjes.

20 Këtu mbyllet seanca për sot. Dëshiroj të falënderoj palët
21 dhe Zyrën Administrative. Dëshiroj të falënderoj përkthyesit,
22 stenografët, teknikët audiovizivë dhe personelin e sigurisë
23 për asistencën. Do të ritakohemi nesër në orën 09:30. Këtu
24 mbyllet seanca për sot.

25 Të gjithë në këmbë.

1 --- Seanca mbyllet në orën 15.59

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25